



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti Vjetor 2017

P R I S H T I N Ě , Q E R S H O R 2 0 1 8



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti Vjetor 2017



## PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit të Bordit .....	11
Fjala hyrëse e Guvernatorit .....	13
Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv .....	15
Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2017 .....	19
<b>1. Përmbledhje ekzekutive .....</b>	<b>21</b>
<b>2. Mjedisi i jashtëm ekonomik .....</b>	<b>25</b>
2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor .....	25
<b>3. Ekonomia e Kosovës.....</b>	<b>28</b>
3.1. Sektori real .....	28
3.2. Sektori Fiskal.....	30
3.3. Tregu i letrave me vlerë .....	30
3.4. Sektori i Jashtëm.....	31
3.5. Sektori financiar .....	33
3.6. Projektionet makroekonomike për vitin 2018 .....	43
<b>4. Mbikëqyrja, rregullimi dhe licencimi i institucioneve financiare .....</b>	<b>45</b>
4.1. Adaptimi i Kornizës së Bazel për Kapital .....	45
4.2. Mbështetja e Qeverisë së Kosovës në përmirësimin e infrastrukturës ligjore për sistemin financiar .....	46
4.3. Korniza rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme .....	47
4.4. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare .....	47
4.5. Korniza rregullative .....	48
4.6. Licencimi .....	51
4.7. Ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare .....	59
4.8. Mbikëqyrja bankare.....	61
4.9. Mbikëqyrja në vend e sigurimeve .....	62
4.10. Mbikëqyrja e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare.....	63
4.11. Mbikëqyrja e pensioneve dhe tregut të letrave me vlerë .....	64
4.12. Parandalimi i pastrimit të parasë.....	69
<b>5. Shërbimet e siguruarra për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun .....</b>	<b>72</b>
5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme .....	72
5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive.....	75
5.3. Sistemi i Pagesave.....	78
5.4. Menaxhimi i Mjeteve .....	85
5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës .....	89
5.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar .....	91

5.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2017.....	93
5.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare .....	95
<b>6. Zhvillimet e Brendshme .....</b>	<b>96</b>
6.1. Auditimi i Brendshëm .....	96
6.2. Burimet njerëzore.....	97
6.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së.....	98
6.4. Teknologjia Informativë .....	98
6.5. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut .....	99
<b>7. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.....</b>	<b>100</b>
7.1. Marrëdhëniet ndërkombëtare.....	100
7.2. Edukimi Financiar.....	101
7.3. Asistenca teknike .....	102
7.4. Integrimet Evropiane .....	103
<b>8. Pasqyrat financiare të BQK-së .....</b>	<b>105</b>
<b>9. Shtojca Statistikore.....</b>	<b>153</b>
<b>10. Referencat.....</b>	<b>174</b>

## LISTA E SHKURTESAVE

AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Gjithëpërfshirëse Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambientit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
BQE	Banka Qendrore Evropiane
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeastern Europe)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	Drejtorati Gjeneral për Statistika Evropiane
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBP	Great Britain Pound
ICAAP	Procesi i Brendshëm i Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. the Internal Capital Adequacy Assessment Process)
IHH	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
IOPS	Organizata Ndërkombëtare për Mbikëqyrje të Pensioneve (angl. International Organisation of Pension Supervisors)
IHD	Investimet e Huaja Direkte

IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IÇI	Indeksi i Çmimeve të Importit
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës SH.A
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMB	Komercijalna Banka
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i Autopërgjegjësishë
NLB	Nova Ljubljanska Banka
KJP	Kreditë Joperformuese
IJSHEF	Institucione Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
BPV	Bruto Produkti Vendor
PCB	Procredit Bank
PNI	Pozicioni Ndërkombëtare i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përçindje
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
NREK	Norma Reale Efektive e Këmbimit
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
APR	Asetet e Peshuara ndaj Riskut
SEBQ	Sistemi Evropian i Bankave Qendrore
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SEPA	Zona e Përdorimit të Euros si Njësi e Vetme Pageese (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Swiss Franc
SRK	Sistemi i Regjistrimit të Kontabilitetit
SWIFT	Society for Worldwide International Financial Telecommunication
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (angl. United Nations Mission in Kosovo)
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale



## LISTA E FIGURAVE

1.	Shkalla e inflacionit në Eurozonë -----	26
2.	Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së -----	26
3.	Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor -----	27
4.	Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor -----	28
5.	Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë -----	28
6.	Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit -----	29
7.	Regjistrimi i bizneseve, -----	29
8.	Struktura e ndërmarrjeve të reja -----	29
9.	Eksportet, importet dhe bilanci tregtar -----	31
10.	Struktura e eksporteve sipas kategorive -----	31
11.	Struktura e importeve sipas kategorive -----	31
12.	Remitencat -----	32
13.	Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve -----	32
14.	Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës -----	33
15.	Asetet e bankave komerciale -----	33
16.	Trendi i rritjes së kredive -----	34
17.	Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	34
18.	Kreditë sipas sektorëve ekonomikë -----	34
19.	Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomikë -----	34
20.	Struktura e depozitave -----	35
21.	Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	36
22.	Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	36
23.	Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	36
24.	Norma mesatare e interesit në depozita -----	37
25.	Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje -----	37
26.	Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare -----	37
27.	Profiti neto i sektorit bankar -----	37
28.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	37
29.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	38
30.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	38
31.	Asetet e sektorit pensional -----	38
32.	Investimet e FKPK-së -----	39
33.	Asetet e sektorit të sigurimeve -----	39
34.	Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	40
35.	Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	41
36.	Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	41
37.	Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve -----	41

38.	Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	41
39.	Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar -----	42
40.	Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë -----	42
41.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	42
42.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	42
43.	Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	43
44.	Struktura e sistemit financiar në Kosovë -----	53
45.	Struktura e kapitalit në sektorin bankar sipas origjinës -----	54
46.	Struktura e kapitalit në sektorin e sigurimeve -----	55
47.	Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave -----	55
48.	Shpërndarja e popullësisë në Kosovë sipas regjioneve -----	56
49.	Rrjeti i siguruesve -----	56
50.	Numri i ankesave sipas viteve -----	61
51.	Mjetet nën menaxhim të FKPK-së -----	65
52.	Çmimi dhe mesatarja e çmimeve për aksion të FKPK-së -----	65
53.	Mjetet nën menaxhim të FSKP-së -----	65
54.	Çmimi dhe mesatarja e çmimeve për aksion të FSKP-së -----	66
55.	Pjesëmarrja e kontribuuesve sipas moshës -----	66
56.	Struktura e investimit të mjeteve pensionale -----	67
57.	Alokimi i mjeteve sipas aset menaxherëve -----	67
58.	Furnizimi me para të gatshme -----	72
59.	Pranimi i parave të gatshme -----	72
60.	Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve -----	73
61.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve -----	73
62.	Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve -----	73
63.	Monedha euro të pranuar sipas denominimeve -----	73
64.	Eksporti i parave të gatshme -----	74
65.	Importi i parave të gatshme -----	74
66.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi -----	74
67.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar -----	74
68.	Furnizimi me kartëmonedha të reja -----	75
69.	Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara -----	75
70.	Paratë euro të falsifikuara në nivel të Kosovës -----	75
71.	Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse -----	76
72.	Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse -----	76
73.	Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse -----	77
74.	Vlera e transaksioneve vendore ardhëse -----	77
75.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	77
76.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	77

77.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse -----	77
78.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse -----	77
79.	Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së -----	78
80.	Numri i transaksioneve në SPN-----	79
81.	Vlera e transaksioneve në SPN-----	79
82.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SPN-----	79
83.	Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SPN -----	79
84.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre -----	80
85.	Vlera vjetore e transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre -----	80
86.	Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SPN-----	80
87.	Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SPN-----	80
88.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit -----	82
89.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit -----	82
90.	Numri i terminaleve ATM-----	83
91.	Numri i terminaleve POS-----	83
92.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	83
93.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave-----	83
94.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së -----	86
95.	Saldoja përfundimtare e mjeteve të investuara nga ana e BQK-së sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse -----	86
96.	Shpërndarja e portofolios investuese në çdo fundvit -----	86
97.	Norma e kthimit të investimeve në portofolio nga depozitat në EUR dhe USD -----	87
98.	Horizonti kohor mesatar i shprehur në ditë deri në maturim për dy kategoritë e plasmaneve -----	87
99.	Struktura e Letrave me Vlerë sipas afatit të maturimit -----	88
100.	Struktura e pjesmarrësve në ankande -----	88
101.	Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2016 dhe 2017 -----	89
102.	Ankandet e bonove të thesarit dhe obligacioneve qeveritare në vitin 2017-----	89
103.	Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së -----	89
104.	Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së -----	90
105.	Numri i kërkesave për raportet kreditore-----	90
106.	Rangimi i Kosovës në raportin “Doing Business 2018” -----	91
107.	Struktura sipas edukimit-----	97

## LISTA E TABELAVE

1.	Rritja reale vjetore e BPV-së-----	25
2.	Numri i institucioneve financiare -----	33
3.	Struktura e aseteve të sektorit bankar-----	34
4.	Struktura e detyrimeve të sektorit bankar-----	35
5.	Struktura e mjeteve të institucioneve financiare -----	54
6.	Struktura e tregut të sigurimeve-----	54
7.	Struktura e sektorit pensional-----	55
8.	Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave -----	56
9.	Rrjeti i siguruesve sipas shpërndarjes gjeografike -----	57
10.	Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike -----	57
11.	Rrjeti i IFJB-ve sipas shpërndarjes gjeografike -----	57
12.	Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratura/refuzuara nga BQK -----	58
13.	Numri i ankesave sipas institucioneve -----	60
14.	Numri i ankesave sipas statusit të zgjidhjes -----	61
15.	Kufijtë e alokimit të mjeteve pensionale të FKPK-së -----	67
16.	Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave -----	76
17.	Niveli i depozitave të klientëve kryesor-----	78
18.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SPN-----	81
19.	Numri i llogarive -----	84
20.	Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave -----	84

## Fjala e Kryetarit të Bordit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) gjatë vitit 2017 me sukses ka përmbushur objektivat dhe detyrat e saj të përcaktuara me Ligjin e Bankës Qendrore, duke kontribuar kështu në mbështetjen e zhvillimit dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit.

BQK-ja edhe gjatë vitit 2017 është qeverisur nga parimet bashkëkohore të qeverisjes korporative, gjë që drejtpërsëdrejti ka ndikuar në përmbushjen e agjendës së saj ligjore dhe sfidave eventuale gjatë kësaj periudhe. Qeverisja e bazuar në tri nivele të organeve vendimmarrëse, pra Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori ka siguruar një sistem efektiv të vendimmarrjes dhe të llogaridhënies.

Bordi i Bankës Qendrore gjatë vitit 2017 ka shqyrtuar dhe aprovuar buxhetin e BQK-së për vitin 2018, si dhe ka aprovuar rregullore të ndryshme të cilat kanë avancuar infrastrukturën rregullative të sistemit financiar të vendit. Avancimi i infrastrukturës rregullative paraqet njërin ndër kontributet kryesore sa i përket përmbushjes së zotimeve të dhëna në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit lidhur me lëvizjen e lirë të kapitalit dhe pagesave. Duke ushtruar rolin e tij prej mbikëqyrësi, Bordi i BQK-së ka siguruar funksionimin efikas të organeve tjera vendimmarrëse të BQK-së, si dhe ka siguruar funksionim adekuat të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm në BQK.

Raporti Vjetor i BQK-së për vitin 2017 paraqet zhvillimet kryesore në ekonominë globale, si dhe në formë të detajuar paraqet zhvillimet në ekonominë dhe sistemin financiar të vendit. Po ashtu, raporti ofron një pasqyrë të detajuar lidhur me aktivitetin e BQK-së në përmbushjen e objektivave dhe detyrave të saj gjatë kësaj periudhe.

Sinqerisht i Juaji,

**Flamur MRASORI**



**Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore  
të Republikës së Kosovës**



## Fjala hyrëse e Guvernatorit

Kushtet ekonomike në nivel global u përmirësuan gjatë vitit 2017. Ekonomia e Eurozonës shënoi përsheptim të ritmit të rritjes, duke u bazuar kryesisht në rritjen e konsumit dhe investimeve private, si dhe në rritjen e kërkesës së jashtme. Norma e inflacionit megjithëse iu afrua objektivit të Bankës Qendrore Evropiane, ende mbetet nën objektivin e kërkuar. Zhvillime të ngjashme kishte edhe në ekonominë e Ballkanit Perëndimor, të cilat shënuan rritje të aktivitetit ekonomik si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme dhe të jashtme. Po ashtu, aktiviteti i shtuar ekonomik dhe rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare rezultuan në rritje të normës së inflacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Aktiviteti ndërmjetësues financiar përsheptoi ritmin e rritjes, përderisa u shënuar përmirësim në cilësinë e portofolit kreditor. Megjithatë, me përjashtim të Kosovës, pjesëmarrja e kredive joperformuese vazhdon të konsiderohet e lartë në shumicën e vendeve të rajonit.

Kosova vazhdoi të regjistrojë rritje ekonomike edhe gjatë vitit 2017. Rritja e shpenzimeve qeveritare, së bashku me rritjen e qëndrueshme të aktivitetit kredhëdhënës dhe rrjedhën e qëndrueshme të remitencave ishin faktorët kryesorë që kontribuan në rritjen ekonomike gjatë këtij viti. Deficiti tregtar në llogarinë e mallrave vazhdoi të kontribuojë negativisht në rritjen ekonomike, përderisa kategoritë tjera të llogarisë rrjedhëse siç janë shërbimet, të ardhurat primare dhe të ardhurat sekondare u karakterizuan me zhvillime të favorshme duke rritur bilancet e tyre pozitive. Zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare u reflektuan edhe në Kosovë, duke u manifestuar me rritje të normës së inflacionit e cila megjithatë mbetet në nivel të moderuar.

Sistemi financiar i Kosovës shënoi rritje të aktivitetit dhe përmirësim të mëtejshëm të treguesve të shëndetit financiar. Përmirësimi i kushteve të ofertës kreditore, së bashku me rritjen e kërkesës për kredi, bënë që kreditimi bankar të përsheptojë ritmin e rritjes. Rritja e depozitave, kryesisht të mbledhura mbrenda vendit, vazhdon të shërbejë si burim i qëndrueshëm financimi për aktivitetin e sektorit bankar. Normat e interesit në kredi vazhduan të zvogëlohen, duke reflektuar përmirësimet në ambientin e përgjithshëm afarist në vend, rritjen e konkurrencës dhe përmirësimin e efikasitetit të bankave. Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhdojnë të shfaqin shkallën e lartë të qëndrueshmërisë që ka ky sektor. Përderisa treguesit e shkallës së kapitalizimit dhe likuiditetit vazhdojnë të qëndrojnë mjaft mbi normat minimale të kërkuara me rregulloret përkatëse, si dhe norma e kredive joperformuese shënoi rënie të mëtutjeshme.

Sektori pensional shënoi rritje të aseteve dhe kthim pozitiv nga investimet, duke shtuar kështu vlerën e kontributeve pensionale të kontribuesve. Sektori i sigurimeve shënoi rritje të aktivitetit dhe përmirësim shumë të rëndësishëm të performancës financiare. Për herë të parë që nga fillimi i funksionimit të tij, sektori i sigurimeve përfundoi vitin me nivel pozitiv të profitit neto. Ky përmirësim i performancës në masë të madhe reflekton masat rregullatore dhe mbikëqyrëse të ndërmarrja nga ana e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për sanimin e gjendjes së këtij sektori. Institucionet mikrofinanciare dhe ato financiare jobankare vazhduan të përsheptojnë aktivitetin kredhëdhënës, përderisa treguesit e qëndrueshmërisë së tyre shënuan përmirësim të mëtutjeshëm.

Gjatë vitit 2017, BQK-ja vazhdoi avancimin e të gjitha funksioneve të saj duke arritur t'i sigurojë vendit një sistem financiar stabil dhe në fuksion të zhvillimit ekonomik, si dhe shërbime efikase për autoritetet dhe publikun. Korniza rregullative për sektorin financiar dhe kapacitetet mbikëqyrëse të BQK-së vazhduan të avancohen edhe më tutje, duke kontribuar kështu në zhvillimin dhe stabilitetin e sistemit financiar. Vëmendje e veçantë gjatë këtij viti i është dhënë edhe aktiviteteve të lidhura me edukimin financiar, të cilat kanë për qëllim rritjen e njohurive të

publikut rreth sistemit finaciar. Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare paraqet një tjetër fushë të rëndësishme të aktivitetit të BQK-së, ku përmes një divizioni të veçantë trajtohen në mënyrë efektive ankesat e klientëve të institucioneve financiare. Aktivitetet e vazhdueshme të edukimit financiar kanë bërë që numri i ankesave të pranuar të rritet, gjë që kryesisht i atribuohet shkallës më të lartë të vetëdijësisimit të klientëve rreth të drejtave të tyre. Avancimi i vazhdueshëm i infrastrukturës financiare dhe shërbimeve që BQK-ja i ofron institucioneve dhe publikut vazhduan të jenë prioritet i rëndësishëm i BQK-së edhe gjatë vitit 2017. Në fushën e bashkëpunimit të jashtëm, BQK-ja ka vazhduar të rrisë bashkëpunimin me të gjithë partnerët e saj vendorë e ndërkombëtarë, si dhe ka organizuar disa konferenca dhe seminare ndërkombëtare me qëllim të shkëmbimit të përvojave rreth aspekteve të ndryshme të fushëveprimit të bankave qendrore.

Në vijim, Raporti Vjetor i BQK-së për vitin 2017 do t'ju paraqesë një pasqyrë të detajuar të zhvillimeve ekonomike dhe financiare në nivel global dhe në Kosovë, si dhe një raport të detajuar rreth aktiviteteve të BQK-së gjatë këtij viti.

Fehmi MEHMETI



Guvernator i Bankës Qendrore

të Republikës së Kosovës



## Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv

### Bordi i Bankës Qendrore

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe është diskutuar lidhur me ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë. Gjatë vitit 2017, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje.

Bordi i Bankës Qendrore, si një nga organet vendimmarrëse të BQK-së, ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar bazuar në rekomandimet e Bordit Ekzekutiv, si në vazhdim:

1. Rregullorja për llogaritjen e kufirit minimal të aftësisë paguese, adekuatshmerisë së kapitalit dhe fondit garantues për siguruesit jojetë;
2. Rregullorja mbi investimin e mjeteve pensionale;
3. Rregullorja për procedurat e Tribunalit të Arbitrazhit;
4. Ndryshimi i Rregullores për raportim të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;
5. Rregullorja për vlerën e kontributeve të pensionit;
6. Rregullorja për Mjetet e pensioneve dhe vlerësimin e mjeteve pensionale;
7. Rregullorja për kontrollet e brendshme dhe Auditimin e Brendshëm;
8. Rregulloren për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm;
9. Rregullorja për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime;
10. Rregullorja për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të siguruesve;
11. Rregullorja për raportim të statistikave të instrumenteve të pagesave;
12. Rregullorja për instrumentet e pagesave elektronike;
13. Rregullorja për lëshimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare;
14. Rregullorja për procedurat e shqiptimit të ndëshkimeve administrative;
15. Rregullorja për mbikëqyrje të konsoliduar të grupeve të siguruesve;
16. Rregullorja për financimin dhe llogaritjen e Fondit të Kompensimit.

Bordi i Bankës Qendrore ka miratuar gjithashtu:

- Raportin vjetor të BQK-së për vitin 2016;
- Pasqyrat Financiare të BQK-së për vitin 2016 dhe Raportin e Auditorit të Pavarur;
- Buxhetin të BQK-së për vitin 2018;
- Planin vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2018;
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së.

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me ligj, Bordi i Bankës Qendrore me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin e BQK-së;
- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të përmbushjes së stabilitetit financiar; po ashtu Bordi ka ushtruar edhe detyra tjera të cilat kanë qenë në harmoni me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Më 31 dhjetor 2017, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Bedri Peci, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore;

Fehmi Mehmeti, Ushtrues i Detyrës së Guvernatorit;

Behxhet Brajshori, Anëtar;

Nuhi Ahmeti, Anëtar; dhe

1 (një) pozitë vakante e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore.

#### *Komiteti i Auditimit*

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Statutin e Komitetit të Auditimit, vepron edhe Komiteti i Auditimit.

Objektivat e Komitetit të Auditimit janë që të ndihmojë Bordin e Bankës Qendrore në lidhje me përmbushjen e përgjegjësisë në relacion me veprimin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, kontrolleve të brendshme, etikën afariste dhe qeverisjen transparente, si dhe për raportin financiar të BQK-së.

Komiteti i Auditimit emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore dhe përbëhet prej tre anëtarëve (dy anëtarë joekzekutiv të zgjedhur nga radhët e Bordit të Bankës Qendrore dhe një anëtar – ekspert i jashtëm nga fusha e kontabilitetit dhe auditimit).

Më 31 dhjetor të vitit 2017, Komiteti i Auditimit përbëhej nga këta anëtarë:

Prof. Dr. Bedri Peci, Kryetar i Komitetit të Auditimit;

Prof. Dr. Arben Dermaku, Anëtar i Jashtëm; dhe

Nuhi Ahmeti, Anëtar.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2017 ka mbajtur gjithsej 8 takime. Në takimet e Komitetit janë trajtuar çështje të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me fusha të cilat gjenden nën fushëveprimin e tij në kontekst të rishikimit. Komiteti i Auditimit, gjatë vitit 2017 ka zhvilluar një numër aktivitete, ndër të cilat:

- Ka shqyrtuar rezultatet e auditimit të prezantuara në raportet tremujore dhe vjetor të auditimit të brendshëm;
- Ka shqyrtuar Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2018 të propozuar për aprovim në Bord të BQK-së;
- Ka shqyrtuar rezultatet e Auditimit të Jashtëm për periudhën 2016;
- Ka vazhduar të kontribuoj në procesin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga vlerësues të jashtëm të pavarur dhe ka ndihmuar menaxhmentin në këtë drejtim; si dhe

Ka zhvilluar aktivitete të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me fushëveprimin e tij.

### **Bordi Ekzekutiv**

Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 34, paragrafi 3, Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori, që është kryesues i Bordit Ekzekutiv, dhe zëvendësguvernatorët. Më 31 dhjetor 2017, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Fehmi Mehmeti, U.D. Guvernator dhe Lulzim Ismajli, Zëvendësguvernator për Operacione Bankare. Bordi Ekzekutiv është i ngarkuar me administrimin dhe ushtrimin e operacioneve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Kompetencat e Bordit Ekzekutiv janë të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe ligjet e tjera relevante.


Gjatë vitit 2017, Bordi Ekzekutiv ka mbajtur 25 mbledhje. Në kuadër të kompetencave të tij, Bordi Ekzekutiv gjatë vitit 2017 ka shqyrtuar dhe rekomanduar për miratim në Bordin e Bankës Qendrore 16 rregullore të aplikueshme për sistemin financiar të vendit, strukturën e re organizative të BQK-së, raportin vjetor të BQK-së për vitin 2016, pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016, pasqyrat financiare tremujore, si dhe buxhetin e BQK-së për vitin 2018. Po ashtu gjatë vitit 2017, Bordi i Bankës Qendrore është njoftuar rregullisht mbi ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të Bordit Ekzekutiv.

Bordi Ekzekutiv në pajtim me legjislacionin në fuqi gjatë vitit 2017 ka miratuar dy udhëzime dhe katër manuale udhëzuese të aplikueshme për sistemin financiar të vendit. Në të njëjtën sferë të kompetencave, Bordi Ekzekutiv ka miratuar regjistrimin e 6 institucioneve financiare jobankare dhe institucioneve mikrofinanciare, si dhe lëshimin e 3 licencave për ndërmjetësime në sigurime. Në fushën mbikëqyrjes financiare, Bordi Ekzekutiv ka miratuar edhe revokimin e regjistrimit të dy institucioneve financiare jobankare dhe të licencës së një ndërmjetësuasi në sigurime. Po ashtu është miratuar administrimi i përkohshëm i një kompanie të sigurimit. Në të njëjtën periudhë, në funksion të arritjes së objektivave dhe duke u bazuar në detyrat mbikëqyrëse të realizuara nga njësitë organizative përgjegjëse, në 13 raste janë miratuar masa ndëshkimore-administrative ndaj institucioneve financiare dhe palëve të lidhura.

Gjatë vitit 2017, Bordi Ekzekutiv ka miratuar nxjerrjen/ndryshimin dhe plotësimin e 17 akteve juridike të brendshme ku përfshihen politika dhe rregulla të brendshme, manuale, procedura dhe të ngjashme. Po ashtu ka miratuar raportimin periodik lidhur me implementimin e Planit Strategjik të BQK-së 2015-2019 për vitin 2016, si dhe ka mbikëqyrur raportimet e organeve të brendshme relevante për ushtrimin e kompetencave të tij. Bordi Ekzekutiv ka ushtruar edhe detyra të tjera në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.



Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2017





## 1. Përmbledhje ekzekutive

Aktiviteti ekonomik global ka vazhduar të përforcohet gjatë vitit 2017, mbështetur kryesisht nga rritja në Evropë dhe Azi. Ekonomia e Eurozonës ka vazhduar rritjen e qëndrueshme, ndërsa inflacioni vazhdoi të jetë nën objektivin e BQE-së në 1.5 përqind, përkundër rritjes së theksuar që pësoi krahasuar me vitet paraprake. Shkalla vjetore e rritjes së BPV-së për vitin 2017 vlerësohet të jetë 2.4 përqind sipas Eurostat-it, mbështetur kryesisht nga konsumi privat dhe investimet, si dhe përmirësimi i pozicionit neto të eksporteve si rezultat i rikuperimit ekonomik në nivel global. Rritja e konsumit dhe investimeve ishte kryesisht rezultat i kushteve të favorshme të financimit të mbështetura nga politikat stimuluese monetare të BQE-së, pritjeve optimiste të agjentëve ekonomik dhe të tregjeve financiare, si dhe i rënies së pasigurisë politike në vendet e eurozonës.

Përforcimi i kërkesës së brendshme në Eurozonë gjatë vitit 2017 është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti ekonomik në këtë rajon u karakterizua me rritje, mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme dhe përforcimi i kërkesës së jashtme.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2017, sipas statistikave preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shënoi rritje vjetore prej rreth 3.7 përqind, rritje e gjeneruar kryesisht nga rritja e investimeve, si dhe përmirësimi i pozicionit të neto eksporteve si rezultat i rritjes së eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Sipas qasjes së prodhimit, rritja ekonomike gjatë vitit 2017 ishte kryesisht rezultat i rritjes së vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin financiar, sektorin e ndërtimitarisë, tregtisë, etj. Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek administrimi publik dhe shërbimet tjera. Për vitin 2018, parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes së BPV-së që pritet të luhatet në një interval prej 4.2 deri në 4.4 përqind.

Në vitin 2017, rritja e çmimeve të metaleve, naftës dhe energjisë në tregjet ndërkombtare u reflektua në ngritje të nivelit të çmimeve në ekonominë e Kosovës. Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit, arriti në 1.5 përqind në vitin 2017 (0.3 përqind në vitin 2016).

Sektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe të shpenzimeve buxhetore krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat buxhetore<sup>1</sup> arritën vlerën neto prej 1.68 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.3 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore<sup>2</sup> arritën vlerën prej 1.74 miliard euro që paraqet një rritje vjetore prej 5.0 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 59.0 milionë euro krahasuar me deficitin prej 61.1 milionë euro në vitin 2016. Borxhi publik, në vitin 2017, ka arritur në 996.4 milionë euro që është për 16.8 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2016. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.6 përqind nga 14.6 përqind sa ishte në vitin 2016.

Sektori i jashtëm i Kosovës u karakterizua me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në 425.1 milionë euro, një rënie vjetore prej 9.0 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, llogarisë së të ardhurave parësore dhe dytësore. Në anën tjetër, përkundër përshpejtimit të rritjes së eksporteve të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2017, rritja e vlerës së importit u përkthye në rritje vjetore të deficitit në mallra për 7.6 përqind në 2.7 miliard në vitin 2017. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, arritën vlerën prej 759.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.9 përqind. Në kuadër të llogarisë financiare, Investimet e Huaja

<sup>1</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>2</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

Direkte (IHD) në Kosovë shënuan rritje vjetore prej 30.8 përqind dhe arritën vlerën prej 287.8 milionë euro.

Në vitin 2017, sistemi financiar u karakterizua me rritje të aktivitetit, në të gjithë sektorët. Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 5.91 miliardë euro në vitin 2017, që përkon me një rritje vjetore prej 9.7 përqind. Gjatë vitit 2017, asetet e sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 6.4 përqind, duke arritur në 3.87 miliardë euro. Në kuadër të asetëve të sektorit bankar, vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga bankat komerciale shënoi një rritje vjetore prej 11.5 përqind, duke arritur në 2.49 miliardë euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 3.09 miliardë euro, që përbën një rritje vjetore prej 6.8 përqind.

Treguesit e performancës dhe shëndetit financiar të sektorit bankar vazhdojnë të reflektojnë shkallë të lartë të stabilitetit. Profiti i realizuar gjatë vitit 2017 arriti në 85.4 milionë euro, që përkon të jetë për 13.1 përqind më i lartë se në vitin paraprak. Treguesit e shëndetit të sektorit bankar tregojnë për një përforsim të mëtejshëm të pozitës së kapitalizimit të sektorit bankar, ku Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit arriti në 18.1 përqind në dhjetor 2017 nga 17.8 përqind sa ishte në vitin paraprak. Gjithashtu, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor u zvogëluar edhe më tutje si rezultat i rënies së pjesëmarrjes së kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në 3.1 përqind, një nivel dukshëm më i ulët edhe krahasuar me vendet në Ballkanin Perëndimor. Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në këtë periudhë shënoi rritje në 149.7 përqind në vitin 2017, kryesisht si rezultat i rënies më të theksuar të kredive joperformuese. Pozita e likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë në nivel të qëndrueshëm, përkundër një rënie të evidentuar në treguesin e likuiditetit si pasojë e rritjes së përshpejtuar të kreditimit. Në vitin 2017, raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 37.9 përqind, që është mjaft mbi minimumin rregullator prej 25 përqind.

Në vitin 2017, gjithsej asetet e kompanive të sigurimit që operojnë në vend arritën në 176.8 milionë euro, një rritje vjetore prej 9.2 përqind. Gjatë vitit 2017, vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve arriti në 86.7 milionë euro, një rritje vjetore prej 3.9 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, gjithsej dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) shënuan një rritje të theksuar vjetore prej 17.8 përqind dhe arritën vlerën prej 46 milionë euro. Si rezultat i rritjes së të hyrave kundrejt rënies së theksuar të shpenzimeve dhe dëmeve të ndodhura, sektori i sigurimeve regjistroi fitim prej 6.4 milionë euro në vitin 2017.

Sektori mikrofinanciar në vitin 2017 shënoi rritje të aktivitetit kredidhënës. Vlera e gjithsej asetëve të IMF-ve arriti në 192.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore të theksuar prej 28.6 përqind. Në vitin 2017, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 7.4 milionë euro, që përbën një rritje të konsiderueshme vjetore krahasuar me profitin prej 4.0 milionë të realizuar në vitin 2016.

Fondet pensionale u karakterizuan me një performancë pozitive në vitin 2017. Vlera e përgjithshme e asetëve të sektorit pensional arriti në 1.65 miliardë euro, një rritje e theksuar e asetëve prej 16.0 përqind në vitin 2017 kryesisht si rezultat i rritjes së realizuar nga kontributet e reja dhe rritja e kthimit në investime. Sektori pensional pothuajse e dyfishoi kthimin në investime duke arritur në 103.1 milionë euro në vitin 2017, për dallim nga kthimi prej 65.3 milionë euro në vitin 2016.

Në kuadër të aktivitetit të licencimit të institucioneve financiare gjatë vitit 2017, BQK-ja aprovoi regjistrimin e 1 Institucioni Mikrofinanciar të ri dhe miratimin e regjistrimit të 6 institucioneve financiare jobankare. Gjithashtu, gjatë këtij viti, BQK-ja ka miratuar lincencimin e 11 ndërmjetësuesve në sigurime. Në vitin 2017, janë miratuar edhe dy kërkesa për shitblerjen e aksioneve, si dhe janë aprovuar 8 kërkesa për ndryshimin e statutit, nga të cilat 4 kanë qenë nga



radhët e bankave, 2 nga institucionet mikrofinanciare si dhe 2 nga institucionet financiare jobankare.

Në funksion të një sistemi bankar stabil, gjatë vitit 2017 janë bërë ekzaminimet e bankave komerciale konform planit të paraparë. Në përputhje me praktikat ndërkombëtare në fushën përkatëse, vëmendje e veçantë i është kushtuar rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit, rrezikut të tregut dhe rreziqeve tjera, duke u bazuar në qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Në përputhje me objektivat e BQK-së, respektivisht sigurimit të qëndrueshmërisë së tregut të sigurimeve dhe mbrojtjes së policëmbajtësve, BQK-ja edhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar aktivitetin e saj duke realizuar në vazhdimësi ekzaminime në vend të siguruesve si ekzaminime të plota dhe të fokusuara, si dhe ekzaminime ad-hoc për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve. Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar, gjatë vitit 2017, BQK-ka ka vazhduar me ekzaminimet e rregullta edhe të fondeve pensionale dhe institucioneve tjera financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, gjegjësisht mbikëqyrja financiare, luan rol kyç në mbrojtjen e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në Kosovë. Në këtë kontekst, në kuadër të procesit të brendshëm të trajtimit të ankesave, në BQK janë shqyrtuar 602 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizikë e juridikë), ku 335 ankesa kanë qenë të deponuara për banka, IMF, IFJB dhe fonde pensionale, përderisa 267 ankesa kanë qenë të deponuara për kompanitë e sigurimeve.

Gjatë vitit 2017, BQK-ja ka aprovuar një numër të akteve të reja rregullative për mbikëqyrjen bankare dhe mbikëqyrjen e Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare, me qëllim të fuqizimit të mëtejshëm të kornizës së përgjithshme rregullative dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, në janar të vitit 2016, ka hyrë në fuqi Ligji për Sigurimet, përderisa gjatë vitit 2017 ka vazhduar nxjerrja e rregulloreve të reja në zbatim të këtij ligji.

Ngjashëm me vitet paraprake edhe gjatë vitit 2017, BQK-ja siguroi një ofertë kualitative dhe kuantitative të parave të gatshme për sektorin bankar për të mundësuar kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Që nga mesi i vitit 2016, Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar në BQK është zëvendësuar me një sistem të ri, implementimi i të cilit përbën një ndër hapat kryesor që BQK-ja ka ndërmarrë për forcimin e stabilitetit dhe rritjen e efikasitetit të sistemit financiar dhe atij bankar në veçanti. Sistemi i ri është karakterizuar me qëndrueshmëri, siguri dhe efikasitet të lartë, i cili ka mundësuar kliringun dhe shlyerjen me kohë të gjitha transaksioneve.

Edhe Regjistri i Kredive të Kosovës (RKK) ka shënuar progres gjatë vitit 2017, ku janë regjistruar 371 përdorues të ri, si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare, përderisa hulumtimi mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditor arriti në 658,672 hulumtime.

Në vitin 2017, të gjitha mjetet nën menaxhimin e BQK-së janë investuar në instrumente financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta dhe likuide. Gjatë kësaj periudhe, BQK-ja realizoi kthime pozitive nga investimet në instrumentet financiare. Shpërndarja e instrumenteve financiare të portfolios së BQK-së në vitin 2017 është ndikuar nga normat negative në Eurosystem, të cilat kanë ngushtuar gamën e instrumenteve adekuate për investimin e fondeve. Karakteristikë kryesore e vitit 2017 është plasmani i mjeteve me afat më të gjatë kohor, respektivisht periudha tri deri në pesë vjeçare, kryesisht si pasojë e normave të pavaforshme dhe negative në tregun e parasë së Eurozonës.

Në funksion të realizimit të objektivave të saj, BQK-ja ka vazhduar t'i kushtojë vëmendje të veçantë analizave rreth zhvillimeve të përgjithshme ekonomike në vend, si dhe analizave që kanë

të bëjnë me vlerësimin e stabilitetit financiar dhe me aktivitetin e sistemit financiar të vendit. Gjatë vitit 2017, është ndërtuar Modeli Makroekonomik për Ekonominë e Kosovës, model që do të përdoret si një mjet suplementar nga BQK-ja në analizimin e zhvillimeve në vend, parashikimin e treguesve kryesorë makroekonomikë, si dhe në simulimin e goditjeve apo skenarëve të ndryshëm që mund të përjetojë ekonomia e Kosovës. Gjithashtu, në vitin 2017 është arritur të publikohet materiali diskutues “Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistematike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë”, qëllimi i të cilit është adresimi i dimensionit strukturor dhe ndërsektorial të rrezikut sistematik që ndërlikohet me bankat me rëndësi sistematike.

Në kuadër të përgjegjësisë së përpilimit dhe publikimit të statistikave të sektorit monetar e financiar dhe statistikave të sektorit të jashtëm, gjatë vitit 2017, BQK-ja ka bërë përparim në shpërndarjen e statistikave të sektorit të jashtëm në përputhje me kërkesat e Eurostat-it, ka implementuar Sistemin e Avancuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), ka zgjeruar gamën e statistikave të reja, ka rritur mbulueshmërinë, përmirësuar më tej cilësinë e vlerësimeve, si dhe ka bërë progres në krijimin e kornizës për hartimin e statistikave të llogarisë financiare.

BQK-ja ka vazhduar të përfitojë nga asistencat teknike gjatë vitit 2017, e ofruar nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët e ndryshëm si me projektet ekzistuese, po ashtu edhe me iniciativat e reja. Mbështetje është ofruar kryesisht nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Thesari Amerikan, USAID, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, GIZ-i dhe Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE).

## 2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

### 2.1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e Eurozonës ka vazhduar rritjen e qëndrueshme gjatë vitit 2017, ndërsa inflacioni vazhdon të jetë nën objektivin e BQE-së përkundër rritjes së theksuar që pësoi krahasuar me vitet paraprake. Shkalla vjetore e rritjes së BPV-së për vitin 2017 ishte 2.4 përqind, krahasuar me rritjen 1.8 përqind në vitin paraprak. Rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga konsumi privat dhe investimet, si dhe përmirësimi i pozicionit neto të eksporteve si rezultat i rikuperimit ekonomik në nivel global.

Kushtet e favorshme të financimit të mbështetura nga politikat stimuluese monetare të BQE-së, optimizmi për prospektet e agjentëve ekonomikë dhe tregjeve financiare, si dhe rënia e pasigurisë politike ishin faktorët kryesorë mbështetës të konsumit dhe investimeve. Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës dhe tregjeve të patundshmërive, që u reflektuan në rritje të pagave dhe pasurisë neto të ekonomive familjare, ndikuan në rritjen e konsumit dhe investimeve private. Në vitin 2017, mesatarja vjetore e papunësisë zbriti në 9.1 përqind, që paraqet shkallën më të ulët që nga viti 2009, ndërsa tregjet e patundshmërive u karakterizuan me rritje të investimeve dhe rënie të ngarkesës me borxh të ekonomive shtëpiake. Prospektet për gjendjen ekonomike të ekonomive shtëpiake dhe ndërmarrjeve arritën rekorde historike. Besueshmëria e konsumatorëve në dhjetor 2017 arriti në nivelin më të lartë që nga viti 2001. Investimet e bizneseve u rritën falë rritjes së vazhdueshme të shfrytëzimit të kapaciteteve të cilat qëndruan mbi nivelet e parakrizës globale, si dhe falë kushteve të favorshme të financimit. Kërkesa e jashtme, e cila filloi rikuperimin në vitin 2016, vazhdoi rritjen duke u reflektuar në rritje të qëndrueshme të eksporteve përkundër rrezikut nga vlerësimi i euros në gjysmën e dytë të vitit 2017.

Rritja ekonomike në eurozonë në vitin 2017 ishte më gjithëpërfshirëse - e shpërndarë ndërmjet shteteve dhe sektorëve ekonomikë, krahasuar me koncentrimin më të madh të rritjes në disa shtete qendrore në vitin paraprak. Shkalla e rritjes në disa nga ekonomitë më të mëdha të eurozonës është paraqitur në tabelën 1. Pritjet e BQE-së janë që rritja e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike të vazhdojë edhe në vitin 2018, e mbështetur nga efektet pozitive në ekonomi të masave lehtësuese monetare, dinamikat pozitive në tregun e punës, si dhe rikuperimit ekonomik në nivel global.

**Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së**

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Eurozona	-0.3	1.3	2.1	1.8	2.4
Gjermania	0.5	1.9	1.7	1.9	2.2
Franca	0.6	1.0	1.1	1.2p	2.2p
Italia	-1.7	0.1	1.0	0.9	1.5
Austria	0.0	0.8	1.1	1.5	3.0
Spanja	-1.7	1.4	3.4p	3.3p	3.1p
Greqia	-3.2p	0.7p	-0.3p	-0.2p	1.4p

p - të dhëna preliminare  
Burimi: Eurostat (2018)

Norma mesatare e inflacionit në vitin 2017 ishte 1.5 përqind, krahasuar me 0.2 përqind në vitin 2016 (figura 1). Rritja e inflacionit reflekton kryesisht rritjen e çmimeve të energjisë të ndikuar nga rritja e çmimeve të naftës, përderisa inflacioni bazë<sup>3</sup> mbetet i moderuar dhe ende nuk ka

<sup>3</sup> Inflacioni duke përjashtuar energjinë dhe ushqimet, të cilat tentojnë të lëvizin më shumë.

dëshmuar shenja të rritjes së qëndrueshme. Andaj, BQE ka vlerësuar se vazhdimi i masave të konsiderueshme të lehtësimit monetar është i nevojshëm për të rikthyer inflacionin në objektivin prej afër, por nën nivelin 2 përqind.


Parashikimi për shkallën vjetore të inflacionit për vitin 2018 është rreth 1.5 përqind, ndërsa prospektet e rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse kanë rritur besimin e BQE-së që inflacioni të vazhdojë rritjen në mënyrë graduale dhe të arrijë nivelin e përcaktuar me objektivat monetare në periudhë afatmesme.

Masat monetare stimuluese të BQE-së do të përfshijnë vazhdimin e programit të neto blerjes së aseteve<sup>4</sup>, riinvestimin në stokun e aseteve të cilat matorojnë, si dhe udhëzimin paraprak mbi nivelin e normave të interesit. Në këtë kontekst, BQE-ja ka vazhduar të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit në zero përqind, atë të depozitave në -0.40 përqind dhe të kreditimit në 0.25 përqind, si dhe sugjeron që do të mbeten të tilla edhe përtej përfundimit të programit të lehtësimit sasiorë apo blerjes së aseteve. Normat e interesit të kreditimit ndërbankar Euribor 1 mujor dhe 12 mujor vazhduan të qëndrojnë në territor negativ (figura 2).

Aktiviteti kreditues në Eurozonë vazhdoi rimëkëmbjen graduale të filluar në vitin 2014, si rezultat i mbështetjes si nga faktorët e kërkesës ashtu edhe të ofertës. Në përgjithësi, standardet e kreditimit u lehtësuan për të gjitha kategoritë e kreditimit, të nxitura nga presionet konkurruese dhe prospektet pozitive për ekonominë dhe rreziqet. Kërkesa për kredi u mbështet nga normat e interesit të cilat qëndrojnë në nivelet më të ulëta historike për të gjitha kategoritë e kreditimit dhe periudhat e maturimit. Për më tepër, bankat kanë vazhduar progresin në konsolidimin e bilanceve të gjendjes dhe kanë bërë progres në zvogëlimin e kredive joperformuese, të cilat megjithatë mbesin të larta në disa shtete dhe mund të paraqesin pengesë në rritjen e kreditimit.


Rritja vjetore e kreditimit ndaj sektorit privat në Eurozonë në dhjetor të vitit 2017 ishte 2.8 përqind, një rritje e përsheptuar krahasuar me rritjen prej 2.3 përqind në vitin paraprak.<sup>5</sup> Ekonomitë familjare përsheptuan normën e rritjes vjetore në 2.8 përqind nga 2.0 përqind në vitin 2016, ndërsa ndërmarrjet shënuan rritje vjetore të kreditimit prej 2.9 përqind nga 2.3 përqind në vitin 2016. Depozitat vazhduan trendin e rritjes së qëndrueshme të filluar nga mesi i vitit 2015, kryesisht si rezultat i masave stimuluese monetare të BQE-së dhe kostos së ulët oportune të

Figura 1. Shkalla e inflacionit në eurozonë, në përqindje



Burimi: Eurostat (2018)

Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së



Burimi: Euribor dhe BQE (2018)


<sup>4</sup> Më 27 tetor 2017, BQE ka marrë vendim që neto shuma e aseteve që do të blehen në kuadër të programit të lehtësimit sasior nga muaji janar 2018 deri në shtator 2018, apo edhe më tutje në rast të nevojës, të përgjysmohet në 30 miliardë euro në muaj.

<sup>5</sup> Të dhënat për normat e kreditimit përfshijnë "normat e rregulluara" për të pasqyruar më mirë kreditimin ndaj sektorit real <http://www.ecb.europa.eu/press/pr/stats/md/shared/pdf/explanatorynoteadjustedloans.en.pdf>.

investimit në një ambient me norma të ulëta të interesit. Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 3.4 përqind në vitin 2017 (4.1 përqind rritje në vitin 2016), ndërsa depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje më të lartë prej 7.7 përqind (6.2 përqind në vitin 2016).

Aktiviteti ekonomik në Ballkanin Perëndimor vazhdoi rimëkëmbjen gjatë vitit 2017. Konsumi privat dhe investimet ishin mbështetësit kryesorë të rritjes, krahas përmirësimit të neto pozicionit të eksporteve që u ndikua nga rritja e kërkesës në eurozonë. Rritja mesatare e BPV-së vjetore në vendet e rajonit në vitin 2017 ishte 2.8 përqind (figura 3), që në raport me vitin 2016 paraqet rënie prej 0.3 pikë përqindje. Shqipëria dhe Mali i Zi u karakterizuan me përshpejtim të rritjes ekonomike, ndërsa vendet tjera ngadalësuan aktivitetin. Maqedonia ishte vendi i vetëm që shënoi rënie të aktivitetit ekonomik.

Figura 3. Rritja vjetore e BPV-së në vendet e rajonit



Burimi: Agjencionet statistikore të vendeve përkatëse

Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik si dhe ngritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare kanë shtuar presionet inflacioniste në rajon, të cilat u reflektuan me ngritje të nivelit mesatarë vjetor të inflacionit në të gjitha ekonomitë përbërëse. Në vitin 2017, shkalla mesatare vjetore e inflacionit në rajon ishte rreth 1.9 përqind krahasuar me 0.3 përqind një vit më parë. Kreditimi bankar vazhdoi të jetë kontribuues i rëndësishëm i rritjes së ekonomive të rajonit. Kreditë shënuan përshpejtim të rritjes vjetore në shumicën e vendeve, me ç'rast norma mesatare e rritjes së kreditimit pothuajse u dyfishua në 6.1 përqind në vitin 2017 nga 3.8 përqind një vit më parë. Mali i Zi dhe Kosova shënuan rritjen më të lartë me normë dyshifrore të rritjes. Cilësia e portfolios kreditore ka vazhduar përmirësimin, por ende mbetet e lartë në shumicën e vendeve me përjashtim të Kosovës që ka normën më të ulët. Vendet e rajonit raportuan edhe për rritje të depozitave, por me shkallë mesatare lehtësisht më të ulët se vitin paraprak si rezultat i ngadalësimit të shkallës së rritjes në Shqipëri dhe Serbi. Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina shpejtuan rritjen në normë dyshifrore të rritjes, përderisa mesatarja vjetore e rritjes së depozitave për rajonin në tërësi ishte 6.8 përqind në 2017 (7.8 përqind një vit më parë).

Valuta euro ka shënuar vlerësim kundrejt dollarit amerikan, sterlinës britanike dhe frankut zviceran në vitin 2017, me ç'rast vlerësimi ishte më i shprehur në gjysmën e dytë të vitit. Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan dhe frankut zviceran është vlerësuar për 2.0 përqind, ndërsa ndaj sterlinës britanike është vlerësuar për 7.0 përqind. Forcimi i ekonomisë së eurozonës, bilanci pozitiv tregtar, si dhe sinjalizimi i BQE-së për ngadalësimin e mundshëm të programit të blerjes së aseteve, ndër tjera, kanë ndikuar në forcimin e monedhës së euros kundrejt këtyre valutave kryesore. Ndërsa, kundrejt monedhave të rajonit si leku shqiptar, dinari serb dhe denari maqedonas, euro është zhvlerësuar me 2.3, përkatësisht 1.5 përqind dhe 0.01 përqind.

### 3. Ekonomia e Kosovës


#### 3.1. Sektori real

##### 3.1.1 Bruto prodhimi vendor

Sipas vlerësimeve preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2017, vlera nominale e BPV-së arriti në 6.3 miliardë euro. Në terma real, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej rreth 3.7 përqind. Në kuadër të kërkesës së brendshme, aktiviteti i përgjithshëm në vend u mbështet nga përforsimi i pozicionit të investimeve, përderisa sipas ASK-së, konsumi i përgjithshëm u karakterizua me rënie. Kontribut pozitiv në rritjen reale të BPV-së kishte edhe pozicioni i neto eksporteve, që rezultoi nga rritja e theksuar vjetore me të cilën u karakterizua komponenta e eksportit të mallrave dhe shërbimeve.

Rritja e aktivitetit ekonomik është gjeneruar kryesisht nga rritja e investimeve prej 10.7 përqind (kryesisht rritjes së IHD-ve dhe kredive investive), si dhe rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve prej 23.8 përqind kundrejt rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve prej 5.5 përqind. Në vitin 2017, rritja e kërkesës së jashtme, si dhe rritja e çmimeve të metaleve në tregjet ndërkombtare është përkthyer në rritje të vlerës së gjithsej eksporteve të vendit në vitin 2017. Megjithatë, në të njëjtën periudhë, rritja e aktivitetit ekonomik në vend, gjegjësisht, rritja e investimeve private është shoqëruar me rritje të vlerës së importeve të mallrave të ndërmjetme dhe mallrave kapitale. Konsumi është vlerësuar të ketë shënuar rënie vjetore prej 1.6 përqind. Sipas qasjes së prodhimit, aktiviteti ekonomik vlerësohet të jetë mbështetur kryesisht nga sektori i shërbimeve dhe ndërtimit, konkretisht, rritja e vlerës së shtuar nga sektori financiar (22.6 përqind), sektori i ndërtimit (12.4 përqind), dhe tregtisë (6.2 përqind). Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek administrimi publik (1.6 përqind) dhe shërbimet tjera (18.4 përqind).

Figura 4. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2018)

##### 3.1.2 Çmimet

Niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit, është karakterizuar me rritje mesatare prej 1.5 përqind në vitin 2017 (figura 4). Sa i përket komponentëve të IÇK-së, me rritje u karakterizuan çmimet rrymës, gazit e lëndëve tjera djegëse (4.5 përqind), pasuar nga çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (3.3 përqind) si dhe çmimet e transportit (2.7 përqind). Me rritje prej 1.5 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, që përfaqësojnë rreth 39.2 përqind

Figura 5. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2018)

të shportës së konsumatorit kosovar. Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar kryesisht të rekreacioni dhe kultura (1.4 përqind), si dhe mjetet e komunikimit (0.9 përqind) (figura 5).

Lëvizja e çmimeve në Kosovë vazhdon të përcaktohet kryesisht nga lëvizja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Në vitin 2017, indeksi i çmimeve të importit shënoi rritje mesatare prej 3.9 përqind (figura 6). Çmimet e produkteve minerale, të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (12.8 përqind), ndërsa çmimet e letrës dhe artikujve të saj shënuan rënie më të lartë (5.9 përqind). Indeksi i çmimeve të prodhimit u karakterizua me rritje të lehtë prej 0.6 përqind. Me rritje të çmimeve u karakterizuan nxjerrja dhe prodhimi i xehes së metalit, prodhimi i pajisjeve elektrike, energjia elektrike, etj. Ndërsa, me rënie u karakterizuan kryesisht çmimet e prodhimit të pijeve, përpunimit të produkteve ushqimore, etj.

### 3.1.3 Regjistri i bizneseve

Në vitin 2017 është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara dhe po ashtu numër më i vogël i ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 9,223 apo 1,201 ndërmarrje më pak se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 1,623 ndërmarrje apo 753 ndërmarrje më pak se sa në vitin paraprak (figura 7).

Numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 2,462 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i hotelerisë me 930 ndërmarrje, prodhimtarisë me 890 ndërmarrje dhe bujqësisë me 822 ndërmarrje (figura 8).

Krahasuar me vitin 2016, në shumicën e sektorëve është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e prodhimit janë regjistruar 291 ndërmarrje më pak, në sektorin e tregtisë 276 ndërmarrje më pak, në sektorin e bujqësisë 268 ndërmarrje më pak, etj. Sektorët që shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i aktiviteteve profesionale (80 ndërmarrje më shumë), informacionit dhe komunikimit (18 ndërmarrje më shumë), si dhe sektori i ndërtimitarisë (12 ndërmarrje më shumë).

Figura 6. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Figura 7. Regjistri i bizneseve, jo kumulative





Figura 8. Struktura e ndërmarrjeve të reja





### 3.2. Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore<sup>6</sup> në vitin 2017 arritën vlerën neto prej 1.68 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.3 përqind. Shpenzimet buxhetore<sup>7</sup> arritën vlerën prej 1.74 miliard euro që paraqet një rritje vjetore prej 5.0 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 59.0 milionë euro krahasuar me deficitin prej 61.1 milionë euro në vitin 2016, përderisa si përqindje e BPV-së, deficitin primar ka shënuar rënie nga 1.0 përqind në 0.9 përqind.

Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore indirekte të cilat arritën vlerën prej 1.3 miliardë euro (7.2 përqind rritje), ndërsa të hyrat tatimore direkte shënuan rritje prej 2.5 përqind dhe arritën vlerën prej 238.0 milionë euro. Të hyrat jotatimore shënuan rritje prej 6.0 përqind dhe arritën vlerën prej 185.8 milionë euro.

Në vitin 2017, të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje të lehtë prej 1.2 përqind dhe arritën vlerën prej 550.0 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 6.7 përqind dhe arritën vlerën prej 506.4 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 26.9 përqind të gjithë shpenzimeve buxhetore, shënuan rritje prej 5.4 përqind dhe arritën vlerën 467.5 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje për 11.4 përqind dhe arritën vlerën prej 226.0 milionë euro.

Borxhi publik, në vitin 2017, ka arritur në 996.4 milionë euro që është për 16.8 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2016. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.6 përqind nga 14.6 përqind sa ishte në vitin 2016. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 19.9 përqind (i cili ka arritur në 574.3 milionë euro), si dhe borxhit të jashtëm publik i cili ka shënuar rritje prej 12.9 përqind duke arritur në 422.2 milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithë borxhin publik është zvogëluar në 42.4 përqind nga 43.8 përqind sa ishte në vitin 2016.

### 3.3. Tregu i letrave me vlerë

Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave në vitin 2017, numri i ankandëve për emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte 19 sosh, përderisa vlera e shpallur në ankande ishte 405.0 milionë euro.

Gjatë vitit 2017, Qeveria e Kosovës ka shpallur numër dhe vlerë më të vogël të bonove të thesarit krahasuar me vitin paraprak. Përderisa numri i fletë-obligacioneve ishte më i lartë krahasuar me vitin paraprak e poashtu edhe vlera e tyre ishte më e lartë. Sa i përket shumës së pranuar, ajo mbeti e njëjtë me vlerën e shpallur si për bono të thesarit, ashtu edhe për fletë-obligacione. Sipas afatit të maturimit, struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të tregon tendencë të zhvendosjes nga letrat me vlerë me maturitet afatshkurtër në letra me vlerë me maturitet afatgjatë.

Kategoria kryesore në strukturën e letrave me vlerë vazhdon të mbetet ajo e bonove të thesarit me afat maturimi 364 ditë me një pjesëmarrje prej 33.3 përqind në gjithë shumën e emetuar, pasuar nga fletëobligacionet me afat maturimi dy vite që kishin një pjesëmarrje prej 23.5 përqind. Vlen të theksohet se në vitin 2017 janë emetuar për herë të parë fletëobligacione me afat maturimi prej 7 vitesh, që kishin një pjesëmarrje prej 4.9 përqind në gjithë shumën e emetuar. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2017 është vënë re një rritje e emetimit të fletëobligacioneve krahas rënies së emetimit të bonove të thesarit. Përderisa vitin 2016 ishin emetuar 38.1 përqind fletëobligacione

<sup>6</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>7</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.



dhe 61.9 përqind bono thesari, në vitin 2017 kjo pjesëmarrje qëndroi në raport prej 53.1 përkatësisht 46.9 përqind.


### 3.4. Sektori i Jashtëm

Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në vitin 2017 ka shënuar vlerën prej 425.1 milionë euro, që është për 9.0 përqind më i ulët krahasuar me vitin 2016. Ky zvogëlim i deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, llogarisë së të ardhurave parësore dhe dytësore. Në anën tjetër, bilanci i llogarisë së mallrave është përkeqësuar.

Eksporti i mallrave shënoi rritje të konsiderueshme në vitin 2017. Vlera e eksportit të mallrave arriti vlerën prej 378.0 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 22.1 përqind (rënie prej 4.8 përqind në vitin 2016) (figura 9).<sup>8</sup> Rritja e vlerës së eksportit të mallrave gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së eksportit të metaleve bazë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit (rreth 35.8 përqind) (figura 10). Rritja e çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2017, rezultoi në rritjen e vlerës së gjithsej eksporteve të metaleve bazë. Me rritje u karakterizua edhe eksporti i ushqimeve të përgatitura, produkteve të plastikës dhe gomës, eksporti i mineraleve, etj. Rritja e eksportit të mallrave rezultoi në rritjen e shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte nga 11.1 përqind sa ishte në dhjetor 2016 në 12.4 përqind në dhjetor 2017.


Rritje e konsiderueshme është shënuar edhe tek importi i mallrave, i cili ka arritur nivelin prej 3.0 miliardë euro apo 9.2 përqind më shumë krahasuar me vitin paraprak. Në kuadër të importit të mallrave, me rritje u karakterizua importi i produkteve minerale, mjeteve të transportit, metaleve bazë, ushqimeve të përgatitura, etj. (figura 11). Niveli

Figura 9. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro




Burimi: ASK (2018)

Figura 10. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2018)

Figura 11. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2018)

<sup>8</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

shumë më i lartë i importit të mallrave krahasuar me eksportin ka ndikuar që deficitin në tregtinë e mallrave të shënoi rritje prej 7.6 përqind dhe të arrijë në 2.7 miliardë euro.


Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 804.2 milionë euro, një rritje kundrejt vitit paraprak prej 25.9 përqind. Vlera e eksportit të shërbimeve shënoi rritje vjetore prej 17.7 përqind, duke arritur në 1,330.9 milionë euro. Në anën tjetër, vlera e importit të shërbimeve shënoi rritje prej 7.1 përqind dhe arriti në 526.8 milionë euro. Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet kompjuterike u karakterizuan me rritje vjetore prej 19.5 përkatësisht 33.5 përqind, përderisa kategoria e shërbimeve të ndërtimit dhe shërbimet e prodhimit shënuan rënie prej 28.1 përkatësisht 14.6 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit shënuan rritje prej 2.7 përqind ndërsa shërbimet e transportit shënuan rënie prej 4.7 përqind.

Llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rritje prej 14.0 përqind. Të ardhurave nga kompensimi i punëtorëve<sup>9</sup> shënuan rritje për 11.4 përqind. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 6.0 përqind, që i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, shënuan vlerën prej 759.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.9 përqind (figura 12). Remitencat në

Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 39.3 përqind përkatësisht 22.5 përqind të gjithëj remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.0 përqind e gjithëj remitencave.


Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë, në vitin 2017, arritën vlerën prej 287.8 milionë euro, që paraqet një rritje prej 30.8 përqind krahasuar me vitin 2016. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje të vlerës u karakterizua kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, ndërsa investimet në instrumentet e borxhit shënuan rënie (figura 13).

Figura 12. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Figura 13. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

<sup>9</sup> Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshin punëtorët sezonalë apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitarë të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 91.9 përqind të gjithëj IHD-ve, shënoi vlerën prej 264.5 milionë euro që është për 44.9 përqind më shumë krahasuar me vitin paraprak. IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 23.2 milionë euro, apo 37.9 përqind më pak krahasuar me vitin paraprak. Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht tek sektori i shërbimeve financiare, patundshmëritë dhe tek sektori i ndërtimitarisë ndërsa sektori i tregtisë dhe ai i industrisë shënuan rënie.


### 3.5. Sektori financiar

#### 3.5.1 Karakteristikat e përgjithshme

Vlera e gjithëj asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 5.91

miliardë euro në vitin 2017, që përkon me një rritje vjetore prej 9.7 përqind (figura 14). Sektori bankar dhe sektori pensional vazhdojnë ta kenë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend.

Figura 14. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK (2018)

Tabela 2. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2014	2015	2016	2017
Bankat komerciale	10	10	10	10
Kompanitë e sigurimeve	14	15	15	15
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndhmësit financiar	42	44	48	52
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare	18	18	16	18

Burimi: BQK (2018)


Numri i bankave komerciale, kompanive të sigurimeve, dhe fondeve pensionale ka mbetur i njejtë me vitin paraprak, për dallim nga institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar që kanë shënuar rritje (tabela 2).

#### 3.5.2 Sektori Bankar

##### Asetet

Asetet e sektorit bankar në vitin 2017 shënuan rritje vjetore prej 6.4 përqind, duke arritur vlerën në 3.87 miliardë euro (figura 15). Zgjerimi i portofolios së kredive vazhdoi të mbetet kontribuuesi më i madh në rritjen e asetëve të sektorit bankar. Në vitin 2017, stoku i letrave me vlerë të sektorit bankar u karakterizua me rënie vjetore prej 4.7 përqind, për herë të parë në nëntë vitet e fundit. Rënia e investimeve në letrat me vlerë ndër tjerash u ndikua nga fokusimi i bankave në kreditimin e ekonomisë vendore. Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënuan rritje vjetore prej 9.2 përqind, krahasuar me rënie vjetore prej 6.9 përqind në vitin paraprak. Kurse, mjetet e mbajtura

Figura 15. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënuan rritje vjetore prej 9.2 përqind, krahasuar me rënie vjetore prej 6.9 përqind në vitin paraprak. Kurse, mjetet e mbajtura

në bankat komercial shënuan rënie vjetore prej 13.3 përqind (rritje prej 8.2 përqind në vitin paraprak.

**Tabela 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar**


Përshkrimi	2014		2015		2016		2017	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	447.1	14.0%	491.0	14.5%	457.3	12.6%	499.4	12.9%
Bilanci me bankat komerciale	390.8	12.3%	316.0	9.3%	342.0	9.4%	296.6	7.7%
Letrat me vlerë	383.8	12.0%	473.3	14.0%	510.3	14.0%	486.4	12.6%
Kreditë bruto	1,882.3	59.1%	2,019.5	59.7%	2,230.0	61.3%	2,485.5	64.2%
Asetet Fikse	53.7	1.7%	57.0	1.7%	58.5	1.6%	60.1	1.6%
Asetet Tjera	28.8	0.9%	28.5	0.8%	39.0	1.1%	41.8	1.1%
<b>Gjithsej</b>	<b>3,186.6</b>	<b>100%</b>	<b>3,385.3</b>	<b>100%</b>	<b>3,637.1</b>	<b>100%</b>	<b>3,869.8</b>	<b>100%</b>

Burimi: BQK (2018)

## Kreditë


Kreditë e sektorit bankar përshpejtuan rritjen vjetore në 11.5 përqind (figura 16). Deri në dhjetor 2017, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.49 miliardë euro. Faktorët që ndikuan në rritjen e kreditimit në vitin 2017 ishin rritja e kërkesës për kredi dhe përmirësimi i ofertës kreditore nga bankat kryesisht përmes uljes së normës mesatare të interesit në kredi dhe zgjatjes së maturitetit të kredive.

Figura 16. Trendi i rritjes së kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2018)


Figura 17. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2018)


Deri në dhjetor 2017, rritje të kreditimit shënuan të gjithë sektorët ekonomikë. Sektorët që shënuan rritje më të theksuar të kreditimit gjatë vitit 2017 ishin sektori i ndërtimit, bujqësisë dhe prodhimit (26.1 përqind, 13.4 përqind dhe 9.3 përqind) (figura 19).

Figura 18. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (dhjetor 2017)



Burimi: BQK (2018)

Figura 19. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2018)

Kreditë ndaj ekonomive familjare ishin kategoria që shënuan normën më të lartë të rritjes vjetore prej 12.7 përqind (figura 17). Gjithashtu edhe kreditë e reja ndaj ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 15.0 përqind në vitin 2017. Ngjashëm me kreditë për ekonomitë familjare edhe kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore dyshifrore prej 10.7 përqind në vitin 2017 (figura 16). Po ashtu, kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve në vitin 2017 shënuan rritje vjetore të theksuar prej 34.7 përqind. Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të mbetet e dominuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, pasuar nga ato për prodhimtari dhe ndërtimtari (figura 18).

### Detyrimet dhe Burimet Vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë 80.0 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake, duke përfaqësuar kështu burimin kryesor të financimit të aktivitetit të sektori bankar. Pjesë përbërëse shumë të rëndësishme të kategorisë së detyrimeve vazhdojnë të mbesin edhe kategoria e "detyrimeve tjera" dhe "bilanci me bankat komerciale".

**Tabela 4. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar**

Përshkrimi	2014		2015		2016		2017	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	32.2	1.0%	43.4	1.3%	59.1	1.6%	67.2	1.7%
Depozitat	2,537.5	79.6%	2,702.9	79.8%	2,897.8	79.7%	3,094.6	80.0%
Huatë tjera	14.1	0.4%	17.6	0.5%	17.8	0.5%	16.0	0.4%
Detyrimet tjera	232.8	7.3%	191.8	5.7%	203.4	5.6%	184.0	4.8%
Borxhi i ndërvarur	47.3	1.5%	36.9	1.1%	38.4	1.1%	37.4	1.0%
Mjetet vetanake	323.1	10.1%	392.7	11.6%	420.6	11.6%	470.8	12.2%
<b>Gjithsej detyrimet dhe burimeve vetanake</b>	<b>3,186.6</b>	<b>100%</b>	<b>3,385.3</b>	<b>100%</b>	<b>3,637.0</b>	<b>100%</b>	<b>3,869.8</b>	<b>100%</b>

Burimi: BQK (2018)

Kategoria e burimeve vetanake të sektorit bankar u karakterizua me rritje vjetore prej 11.9 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së theksuar të vlerës së fitimit të mbajtur në 103.2 milionë euro në vitin 2017 (68.7 milionë në vitin 2016).


### Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 6.8 përqind në vitin 2017, krahasuar me rritjen prej 7.2 përqind në vitin 2016. Deri në dhjetor 2017, depozitat arritën vlerën në 3.09 miliardë euro (figura 20).

Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, kategori që dominon strukturën e gjithsej depozitave në sektorin bankar, të cilat shënuan rritje vjetore prej 2.3 përqind (figura 20).

Në të njëjtën periudhë, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 13.8 përqind. Kjo rritje mund të ketë rezultuar nga rritja e normës mesatare të interesit në depozitat për ndërmarrjet në 1.7 përqind (1.6 përqind në dhjetor 2016).

**Figura 20. Struktura e depozitave, në përqindje**



Burimi: BQK (2018)

Vlen të theksohet se normat kryesisht të ulëta të interesit në depozita që mbizotëruan gjatë vitit 2017 mund të ketë rezultuar në rritjen e pjesëmarrjes së kategorisë së depozitave të transferueshme në gjithsej depozitat në 60.5 përqind, nga 58.0 përqind sa ishte në dhjetor 2016.

## Normat e Interesit


Dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe asaj në depozita u ngushtua në 5.5 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (6.0 përqind në 2016). Norma mesatare e interesit në kredi në dhjetor 2017 u zvogëluua në 6.8 përqind përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.3 përqind (figura 21).

### Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëluua në 6.5 përqind nga 6.8 përqind sa ishte në dhjetor 2016 (figura 22). Në kuadër të kësaj kategorie, normat e interesit në kreditë investuese dhe jointestuese vazhdojnë të përcjellin trend rënës.


Në dhjetor 2017, vërehet rënie më e lehtë e normave të interesit në kreditë për ndërmarrjet në krahasim me periudhat paraprake. Normat e interesit në të gjithë sektorët ekonomikë shënuan rënie, përjashtuar sektorin e "shërbimeve tjera" (figura 23).

Figura 21. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2018)

Figura 22. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2018)

Figura 23. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2018)


Kreditë për ekonomitë familjare gjithashtu shënuan rënie të normës mesatare të interesit në 7.3 përqind (7.9 përqind në dhjetor 2016). Në kuadër të kësaj kategorie, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese dhe për ato hipotekare vazhduan të ndjekin trend rënës.

### Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në gjithsej depozitat shënoi rritje të lehtë krahasuar me periudhën paraprake, në 1.3 përqind në dhjetor 2017 (figura 24).


Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve arriti në 1.7 përqind, një rritje e lehtë vjetore prej 0.1 pikë përqindje. Më saktësisht, rritje prej 0.2 pikë përqindje shënuan normat e interesit në depozitat e kursimit, përderisa prej 0.1 pikë përqindje ato të afatizuara të ndërmarrjeve (figura 25).

Figura 24. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2018)


Figura 25. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive



Burimi: BQK (2018)

Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare mbeti e ngjashme me vitin e kaluar, në 1.0 përqind, përfshirë këtu edhe të tri kategoritë e depozitave (të transferueshme, të afatizuara dhe të kursimeve) të cilat po ashtu patën ndryshime marginale (figura 26).

Figura 26. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2018)

## Performanca e sektorit bankar<sup>10</sup>


Sektori bankar gjatë vitit 2017 vazhdoi të karakterizohet me performancë të mirë financiare, duke mbajtur nivel të lartë të profitabilitetit. Vlera e profitit të realizuar gjatë vitit 2017 ishte 85.4 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 13.1 përqind (figura 27). Rritja e profitit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së të hyrave nga jointerisi në formë të tarifave dhe komisioneve dhe të hyrave tjera operative. Të hyrat e sektorit bankar arritën vlerën prej 241.2 milionë euro dhe u karakterizuan me rritje vjetore prej 4.4 përqind, për dallim nga viti paraprak kur shënuan rënie (figura 28). Rritja u ndikua kryesisht nga rritja e të hyrave nga jo-interesi, përdërisa të hyrat nga interesi vazhduan rënien, kryesisht si pasojë e rënies e normës së interesit në kredi gjatë viteve të fundit.

Figura 27. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Figura 28. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)

Në anën tjetër, shpenzimet e sektorit bankar shënuan vlerën prej 155.8 milionë euro dhe u karakterizuan me rritje të lehtë vjetore prej 0.1 përqind (figura 28). Rritja e shpenzimeve në vitin

<sup>10</sup> Bazuar në të dhënat e paaudituar.



2017 kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve administrative, pasi që shpenzimet e financimit u zvogëluan për 6.3 përqind.

Gjithashtu, edhe shpenzimet e jointeresit në formën e provizioneve për humbje të mundshme nga kreditë u zvogëluan ndjeshëm, që përkon me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së portofolit kreditor.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit është përmirësuar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si rezultat i rritjes së të hyrave në këtë periudhë (figura 28).

Treguesit e profitabilitetit vazhdojnë të qëndrojnë në nivel të lartë. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) u rritën në 2.6 përkatësisht 21.3 përqind, nga 2.3 përkatësisht 19.7 përqind sa ishin në vitin paraprak (figura 29).

### Treguesit e shëndetit financiar

Deri në dhjetor 2017, sektori bankar raportoi rënie të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione.


Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive shënoi rënie në 3.1 përqind nga 4.9 përqind, një nivel i ulët krahasuar edhe me vendet në Ballkanin Perëndimor (figura 30). Për më tepër, raporti i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione shënoi rritje në 149.7 përqind, si rezultat i rënies më të theksuar të kredive joperformuese.

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit, ku treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në 18.1 përqind në dhjetor 2017. Pozita e likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë në nivel të qëndrueshëm, përkundër rritjes së përshpejtuar të kreditimit. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 37.9 përqind, që është mjaft mbi minimumin rregullator prej 25 përqind.

### 3.5.3 Sektori pensional


Sektori pensional në vitin 2017 u karakterizua me rritje të aseteve prej 16.0 përqind. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional arriti në 1.65 miliard euro, që e bën sektorin e dytë më të madh në sistemin financiar me 27.9 përqind të aseteve (figura 31). Në këtë rritje kontribut

Figura 29. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK (2018)

Figura 30. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Burimi: BQK (2018)

Figura 31. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)



dhanë rritja e kontributeve të arkëtuara nga të dy fondet dhe kthimi në investime nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

Vlera e kontributëve të arkëtuara nga sektori pensional arriti në 160.3 milionë euro (152.0 milionë euro në 2016), që paraqet rritje vjetore prej 5.4 përqind. Vlera e arkëtimeve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-së) arriti në 159.8 milionë euro, ndërsa ajo e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensionave (FSKP-së) arriti në 502.4 mijë euro.

Sektori pensional pothuajse e dyfishoi kthimin në investime duke arritur në 103.1 milionë euro, për dallim nga kthimi prej 65.3 milionë euro në vitin paraprak. FKPK-ja realizoi kthim pozitiv në investime prej 102.6 milionë euro, ndërsa FSKP 528.5 mijë euro.

FKPK, e cila konsiston me 99.5 përqind të aseteve të sektorit pensional, shënoi rritje të investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës në nivelin prej 20.8 përqind, ndërsa investimi në fondet e përbashkëta investive, të cilat janë jashtë vendit, regjistroi rritje prej 13.4 përqind (figura 32). Tregjet financiare në SHBA u karakterizuan me luhatje pozitive si rezultat i lehtësirave fiskale dhe rritjes së BPV-së përtej parashikimeve. Tregu i obligacioneve qeveritare në Eurozonë gjatë tremujorit të katërt u karakterizua me rënie të normave të interesit. Ky zhvillim u ndikua nga vendimi i BQE-së për të vazhduar programin e lehtësimit sasior edhe gjatë vitit 2018 por në vlerë të reduktuar, përkundër që Eurozona përjetoi rritjen më të shpejtë ekonomike në dekadën e fundit. Megjithatë, zhvillimet pozitive në SHBA dhe strategjia investuese ndikuan në performancë të mirë të sektorit pensional, duke siguruar rritje të vlerës së kthimit në investime.


### 3.5.4 Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve, që përfaqëson rreth 3.0 përqind të gjithëj aseteve të sistemit financiar, në dhjetor 2017 shënoi rritje vjetore të aseteve prej 9.2 përqind dhe arriti në 176.8 milionë euro (figura 33). Një ndër kontribuesit kryesorë në rritjen e aseteve ishte rritja e mjeteve likuide, respektivisht parave të gatshme të mbajtura në bankat komerciale, që ka dhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e aseteve të kompanive të sigurimit.

Sigurimet jojetë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithëj asetet


e sektorit (87.8 përqind) shënuan rritje vjetore prej 6.7 përqind në vitin 2017. Ndërsa, sigurimet "jetë", që përbëjnë pjesën e mbetur të aseteve, shënuan rritje vjetore prej 31.5 përqind.

Figura 32. Investimet e FKPK-së



Burimi: FKPK (2018)


Figura 33. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2018)

Gjatë vitit 2017, vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve arriti në 86.7 milionë euro, një rritje vjetore prej 3.9 përqind. Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jojetë të cilat përfaqësojnë 97.1 përqind të gjithë primeve të shkruara. Vlera e tyre gjatë kësaj periudhe prej 84.2 milionë euro është për 4.1 përqind më e lartë se në vitin 2016. Ndërsa, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi jetë ishte 2.5 milionë euro që paraqet vlerë më të ulët për 3.4 përqind.

Figura 34. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e kompanive të sigurimit dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan një rritje të theksuar vjetore prej 17.8 përqind në vitin 2017 (rritje prej 4.9 përqind në vitin 2016).

Rritja më e lartë e dëmeve të paguara gjatë kësaj periudhe krahas rritjes më të vogël të primeve të shkruara, rezultoi në rritje të raportit të gjithëj dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara (figura 34).

### Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar për dallim nga viti i kaluar. Të hyrat neto nga primet e sektorit të sigurimeve në vitin 2017 shënuan rritje vjetore prej 4.7 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, shpenzimet u karakterizuan me një rënie vjetore prej 7.1 përqind si dhe dëmet e ndodhura shënuan rënie të konsiderueshme vjetore prej 47.1 përqind. Si pasojë e rritjes së të hyrave kundrejt rënies së theksuar të shpenzimeve dhe dëmeve të ndodhura, sektori i sigurimeve regjistroi fitim prej 6.4 milionë euro.

Masat e ndërmarra nga ana e BQK-së përmes hyrjes në fuqi të Rregullores për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe menaxhimin e shpenzimeve të siguruesve në fillim të vitit 2017, ka rezultuar të jenë efektive në zvogëlimin dhe kufizimin e shpenzimeve duke marrë parasysh rënien e konsiderueshme të shpenzimeve të të gjithë sektorit të sigurimeve gjatë këtij viti. Po ashtu, rezultati pozitiv financiar i realizuar gjatë vitit 2017 u ndikua edhe nga rritja e pagesës së dëmeve nga disa kompani të sigurimit jojetë, si dhe ndryshimit të legjislacionit sekondar të BQK-së në përputhje me kërkesat ligjore, sa i përket Rregullores së Fondit të Kompensimit. Këto hapa kanë ndikuar në zvogëlimin e rezervave teknike, duke rezultuar në zvogëlimin e shpenzimeve dhe rrjedhimisht në realizimin e profitit.

Rritja vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 8.3 përqind, krahas rënies prej 5.7 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve ndikuan në përmirësimin e nivelit të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave u rrit në 104.3 përqind në vitin 2017 nga 90.7 përqind sa ishte në vitin 2016, gjithashtu raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithëj detyrimeve u rrit në 91.3 përqind (83.1 përqind në vitin 2016).

### 3.5.5 Sektori mikrofinanciar

#### Asetet

Gjatë vitit 2017, asetet e sektorit mikrofinanciar arritën në 192.4 milionë euro duke shënuar rritje vjetore të theksuar prej 28.6 përqind (figura 35).

Rritja e asetëve të sektorit mikrofinanciar në vitin 2017 kryesisht i atribuohet rritjes së kredive bruto, aktivitet që kryesisht financohet nga huamarrjet në sektorin e jashtëm. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar vazhdon të dominohet nga kreditë bruto (74.8 përqind), pasuar nga lizingjet (13.8 përqind).

### Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar gjatë vitit 2017 shënoi përmirësim të theksuar, ku vlera e kredive arriti në 143.9 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 32.1 përqind (figura 36).

Figura 36. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive






Figura 35. Asetet e sektorit mikrofinanciar (milionë euro)



Burimi: BQK (2018)

Burimi: BQK (2018)

Figura 37. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik




Kontributin më të madh në rritjen e kredive e kishte kategoria e kredive ndaj ekonomive familjare (64.0 përqind të gjithsej kredive të sektorit), kategori vlera e të cilave arriti në 92.1 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 26.2 përqind. Kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 36.0 përqind të gjithsej kredive të sektorit, po ashtu kontribuuan dukshëm në rritjen e gjithsej kredive duke arritur vlerën prej 51.8 milionë e që paraqet një rritje vjetore prej 44.1 përqind.

Sa i përket kredive të lëshuara ndaj sektorëve ekonomikë, të gjithë sektorët u karakterizuan me rritje. Rritjen më të lartë e kishin kreditë e dedikuara për 'Sektorët tjerë' pasuar nga kreditë për sektorin e industrisë dhe atë të ndërtimitarisë. Kreditë për tregti të cilat vitin e kaluar shënuan rënie, këtë vit u karakterizuan me rritje (figura 37).

### Lizingjet

Lizingjet, si kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e asetëve të sektorit mikrofinanciar, shënuan rritje vjetore prej 10.2 përqind në vitin 2017 dhe arritën vlerën prej 26.6 milionë euro (figura 38).

Figura 38. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar (në përqindje)



Në rritjen e lizingjeve kontribuoi rritja e "lizingjeve tjera" dhe lizingjeve hipotekare, të cilat regjistruan rritje vjetore prej 17.9 përkatësisht 7.1 përqind.

### Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2017 ndërroi kahje dhe ndërpreu trendin rënës të dy viteve të kaluara, duke shënuar rritje në 22.6 përqind nga 21.3 përqind sa ishte në dhjetor 2016. Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare regjistroi rritje prej 1.6 pikë përqindje, ndërsa norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve regjistroi rritje prej 1.3 pikë përqindje (figura 39).

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve rezultoi të ketë normën më të ulët të interesit në kredi. Ndërsa, sektori i industrisë vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit në kredi (figura 40).

Figura 39. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar





Figura 40. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



### Performanca e sektorit mikrofinanciar

Gjatë vitit 2017, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 7.4 milionë euro, që përbën një rritje të konsiderueshme vjetore krahasuar me profitin e realizuar në vitin 2016 prej 4.0 milionë euro.

Figura 41. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar





Figura 42. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Kontribuues kryesor në këtë rritje ishte rritja më e lartë e të hyrave (kryesisht e atyre nga interesi) prej 28.8 përqind, krahas rritjes së shpenzimeve prej 17.9 përqind (figura 41). Si rrjedhojë e rezultatit financiar pozitiv gjatë vitit 2017, treguesit e profitabilitetit shënuan përmirësim (figura 42).

Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë në vitin 2017 u zvogëlua për 0.3 pikë përqindje, nivel ky më i ulët në vitet e fundit dhe zbriti në 2.5 përqind.

Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione vazhdoi të jetë i lartë me raport prej 190.3 përqind (figura 43).

### 3.6. Projektionet makroekonomike për vitin 2018

Projektionet e BQK-së për vitin 2018 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me rritje reale që pritet të luhatet në një interval prej 4.2 deri në 4.4 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto

eksportet parashihet të kenë ndikim negativ në BPV. Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 3.5 përqind, bazuar në pritjet që konsumi privat do të rritet me 3.3 përqind dhe konsumi publik me 4.5 përqind. Faktorët që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit privat, ndër të tjera, janë edhe rritja e remitencave dhe rritja e kredive. Deri në fund të vitit 2018, remitencat pritet të shënojnë rritje vjetore prej rreth 8.0 përqind. Gjithashtu, kreditë për ekonomitë familjare, të cilat në vitet e fundit kanë shënuar rritje të konsiderueshme (12.7 përqind në vitin 2017 dhe 14.7 përqind në vitin 2016), pritet të vazhdojnë këtë trend të rritjes edhe në vitin 2018.


Investimet në vitin 2018 parashihet të shënojnë rritje reale prej 10.1 përqind, bazuar në parashikimet për rritje të konsiderueshme të investimeve publike (25.8 përqind) por edhe të investimeve private (5.0 përqind). Kontribut të rëndësishëm në rritjen e investimeve private pritet të vazhdojë të ketë kreditimi bankar, i cili po karakterizohet me ritëm më të shpejtë të rritjes dhe me norma më të ulëta të interesit. Po ashtu, ndryshimet në politikën tatimore gjatë viteve të kaluara, pritet të nxisin investimet private. Rritjes së pozicionit të përgjithshëm të investimeve pritet t'i kontribuojë edhe rritja e IHD-ve.

Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2018 pritet të kenë kontribut më të lartë negative në BPV krahasuar me vitin e kaluar, një supozim i mbështetur kryesisht në parashikimet për stabilizim të çmimeve të metaleve që priten të ndikojnë në një rritje më të ngadalësuar të eksporteve. Në kuadër të mallrave, pritet që eksporti të rritet për rreth 6.9 përqind në terma real, ndërsa importet pritet të rriten për rreth 6.5 përqind. Rrjedhimisht, deficitit tregtar i mallrave pritet të shënoi rritje prej 6.4 përqind në terma real. Në anën tjetër, pozicioni tregtar pozitiv në kuadër të shërbimeve pritet të rritet për rreth 6.1 përqind në terma real.

Trendi i çmimeve në Kosovë është kryesisht në linjë me lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht çmimet e ushqimit dhe të naftës. Këto dy kategori të produkteve, të cilat përbëjnë rreth 50 përqind të shportës së konsumatorit kosovar, janë karakterizuar me rritje të çmimeve në vitin 2017 dhe pritet të stabilizohen në vitin 2018. Rrjedhimisht, ekonomia e Kosovës e cila ishte karakterizuar me inflacion prej 1.5 përqind në vitin e kaluar, pritet të karakterizohet me një nivel pothuajse të ngjashëm të shkallës së inflacionit (rreth 1.6 përqind në vitin 2018).

Norma vjetore e rritjes së kreditimit bankar në vitin 2018 pritet të shënojë rritje prej rreth 9.3 përqind. Parashikimet e BQK-së për rritje të kreditimit janë gjithashtu në linjë me raportimet e bankave në kuadër të anketës së kreditimit bankar, rezultatet e së cilës sugjerojnë se do të ketë përshtetshmëri të aktivitetit kreditor gjatë periudhave në vazhdim. Konkretisht, bankat presin përmirësim të ofertës kreditore përmes lehtësimit të standardeve të kreditimit, rënies së normave të interesit në kredi dhe përmirësimit të kushteve kreditore. Po ashtu, aktiviteti kreditor do të

Figura 43. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK (2018)

ndikohet pozitivisht edhe nga ana e kërkesës kreditore. Edhe depozitat pritet të vazhdojnë trendin e rritjes që i ka karakterizuar në vitet e fundit. Rritja e depozitave gjatë vitit 2018 pritet të jetë rreth 8.4 përqind. Rrjedha e pritur e depozitave është e lidhur me të ardhurat kombëtare të disponueshme të cilat pritet të rriten për 6.5 përqind në vitin 2018.

## 4. Mbikëqyrja, rregullimi dhe licencimi i institucioneve financiare

### 4.1. Adaptimi i Kornizës së Bazelit për Kapital

Mbikëqyrja financiare ka zgjedhur një qasje graduale dhe të sigurt drejt përafrimit me standardet ndërkombëtare me fokus të veçantë në direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian për mbikëqyrjen e bankave, të cilat rregullojnë veprimtaritë e institucioneve kreditore dhe përcaktojnë kërkesat për kapitalin e tyre. Ky është një proces i analizuar mirë në mënyrë që të vlerësohet aplikueshmëria dhe ndikimi i çdo ndryshimi në përmirësimin e mëtejshëm të kushteve për sektorin financiar dhe shfrytëzuesit e tij. Sidomos gjatë kësaj periudhe janë paraparë ndryshime dhe plotësime të reja duke marrë në konsideratë se pas krizës së fundit financiare të vitit 2008, standardet ndërkombëtare të njohura si Korniza e Bazelit për Kapital, kanë pësuar ndryshime të shumta, dhe janë adresuar çështjet të cilat janë konsideruar si faktor nxitës të krizës financiare, si dhe marrë parasysh nivelin e zhvillimit dhe nevojat e sistemit bankar të Kosovës.

Në këtë drejtim, nga shtatori i vitit 2014, BQK-ja ka filluar me projektin specifik për adaptimin dhe implementimin e kornizës rregullative të njohur si Korniza e Bazelit për Kapitalin (eng. Basel Capital Framework). Si një objektivat afatgjatë i Kosovës për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe si një ndër qëllimet kryesore strategjike, BQK-ja ka filluar këtë projekt me mbështetjen e institucionit Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar-GIZ. Në kuadër të këtij projekti, BQK-ja edhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar me amandamentimin e rregulloreve ekzistuese dhe adaptimin e disa rregulloreve të reja për të adresuar një numër të kërkesave për bankat në pajtim me Kornizën e Bazelit për Kapital, megjithatë, harmonizimi i plotë i rregullativës ekzistuese për mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave me Kornizën e Bazelit për Kapital dhe direktivat evropiane është një projekt më i gjatë, i cili me strategjinë e BQK-së është paraparë të finalizohet përgjatë periudhës 2015 – 2019.

Gjatë vitit 2017, në funksion të adaptimit të standardeve të Kornizës së Bazelit për Kapital është vazhduar me përgatitjen e ndryshimeve të Rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave, me anë të së cilës përcaktohen kërkesat për kapital për të adresuar kërkesat e kapitalit ndaj rrezikut kreditor përmes harmonizimit të peshimeve të caktuar me rrezik për kategoritë e ndryshme të mjeteve, për adaptimin e teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor, kërkesave për kapital për rrezikun e tregut si dhe rrezikun operacional. Korniza e Bazelit për Kapital është adaptuar edhe nga BE-ja me anë të Rregullores nr. 575/2013 mbi kërkesat prudenciale për institucionet kredihënëse dhe shoqëritë investuese si dhe Direktivës nr. 2013/36 , e njohur si Direktiva për kërkesat e kapitalit (ang. CRD IV) të njohura me emrin “The Single Rule Book”. Këto ndryshime kryesisht përfshijnë rishikimin e kërkesave për kapital dhe elementeve përbërëse të kapitalit me qëllim të ngritjes së cilësisë, vendosjen e kërkesave për qëllime të monitorimit të rrezikut të likuiditetit, raportit të leverazhit etj.

Sipas planit të BQK-së për harmonizimin e rregullativës me Kornizën e Bazelit për Kapital dhe Rregulloren e BE-së është paraparë, që gjatë vitit 2017 dhe gjysmës së parë të vitit 2018 të vazhdohet me plotësimin e kornizës rregullative për të adaptuar kërkesat e nevojshme të nxjerra nga këto standarde me fokus të veçantë në adaptimin e plotë të Shtyllës së Parë dhe avancimin e mëtejshëm të adaptimit të Shtyllës së dytë të Kornizës. Me këto ndryshime parashihet një adaptim i plotë i qasjes së standardizuar për peshimin me rrezik të ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor, duke zgjeruar numrin e klasave të ekspozimit për të reflektuar në ndryshimet e tregut bankar në Kosovë, si dhe duke adaptuar parimet dhe rregullat më të sofistikuara për përllogaritjen e ekspozimeve të peshuara me rrezik, për secilën klasë ekspozimi, si dhe parimet dhe metodat e njohjes së teknikave të zbutjes ndaj rrezikut kreditor.



Gjatë vitit 2017 është punuar në drejtim të adaptimit të kërkesave për kapital për mbulimin e rrezikut të tregut me theks të veçantë të kërkesave për kapital për instrumentet e tregtueshme të borxhit, instrumentet e tregtueshme të kapitalit, pozicionet në mallra dhe pozicionet e këmbimit valutor. Gjithashtu gjatë vitit 2017 është punuar në drejtim të adaptimit të Definicionit të Kapitalit sipas kornizës globale rregullatore për banka dhe sisteme bankare më të qëndrueshme e njohur si Bazel III. Kjo mundëson që ekspozimet e bankave të mbulohen me bazë të kapitalit të kualitetit më të lartë përmes instrumenteve financiare që kanë mundësi më të mëdha abosorbuese të humbjeve. Përveç definicionit të kapitalit njëkohësisht është punuar në drejtim të harmonizimit të kërkesave rregullative me dokumentin e Bazel III mbi treguesin e leverazhit. Treguesi i leverazhit ka për qëllim kufizimin e rritjes së ekspozimeve bilancore dhe jashtëbilancore të bankave përmes emetimit të tepërt të instrumenteve të borxhit. Ky treguesi është i thjeshtë për t'u llogaritur dhe jo i bazuar në rrezik që vepron si masë kredibile shtesë ndaj kërkesave të kapitalit të bazuara në rrezik.

Lidhur me rregulloret e draftuara janë organizuar takime me banka në kuadër të Shoqatës së Bankave, si dhe janë kryer vlerësimet për ndikimin që këto rregullore mund të kenë për secilën bankë individuale si dhe në sektorin bankar në përgjithësi. Si hap tjetër i rëndësishëm i këtij projekti është edhe adaptimi i kërkesave të Shtyllës së Dytë të Kornizës së Bazelit për Kapital, të njohur si Procesi i Brendshëm i Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. the Internal Capital Adequacy Assessment Process: ICAAP), apo adaptimit të procesit të brendshëm të vlerësimit të adekuatshmërisë së kapitalit nga vet bankat, si dhe procesit të rishikimit nga mbikëqyrësi i këtij procesi të brendshëm të bankave për vlerësimin e nevojave për kapital. Në kuadër të Shtyllës së Dytë të Kornizës së Bazelit për Kapital adresohen edhe rreziqet të cilat nuk janë të mbuluar në Shtyllën e Parë siç janë: rreziku i normës së interesit në librin e bankës, rreziku, rreziku i koncentrimin, rreziku i kundërpalës, rreziku reputacional, rreziku i modeleve, rreziku i profitabilitetit, rreziku strategjik dhe rreziqe tjera që mund të ketë banka gjatë afarizmit.

Për sa i përket adaptimit të kërkesave të Shtyllës së Dytë të Kornizës së Bazelit për Kapital dhe ICAAP në veçanti, gjatë vitit 2017 është punuar në draftimin e Rregullores për ICAAP përveç Letrës Këshilluese për ICAAP e cila është publikuar nga BQK-ja në muajin gusht të vitit 2016. Gjithashtu është punuar në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të BQK-së përmes organizimit të punëtorisë, përmes asistencës teknike nga Banka e Sllovenisë, ku përveç stafit të BQK-së pjesëmarrës në këtë punëtori kanë qenë edhe stafi nga bankat qendrore të rajonit si nga Shqipëria dhe nga Maqedonia, si dhe është planifikuar që adaptimi i plotë dhe fillimi i zbatimit të ICAAP të kryhet gjatë vitit 2018.

Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të kërkesave të reja për kapital, do të rishikohen dhe përditësohen edhe kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat, të cilat ndikojnë në rritjen e transparencës për palët e interesit dhe të cilat janë të njohura si kërkesat e Shtyllës së Tretë të Kornizës së Bazelit me qëllim të ngritjessë disiplinës së tregut përmes kërkesave për shpalosje dhe rritjen e transparencës.

#### **4.2. Mbështetja e Qeverisë së Kosovës në përmirësimin e infrastrukturës ligjore për sistemin financiar**

BQK-ja edhe gjatë vitit 2017, ka dhënë mbështetje të përmirësimit të infrastrukturës ligjore për të avancuar më tej kornizën ligjore për sa i përket adresimit të çështjeve që ndërliken me shërbimet financiare dhe harmonizimin me direktivat e BE-së dhe standardet e mira ndërkombëtare duke dhënë kontribut konkret substancial në amandamentimin dhe përgatitjen e ligjeve si në vijim:

**Ligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare** – në maj të vitit 2017 me Vendimin e Ministrisë së Financave është themeluar ekipi përgjegjës për hartimin



e draft Ligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare. Në këtë ekip janë caktuar edhe dy përfaqësues të BQK-së, njëri nga të cilët është caktuar edhe zyrtar përgjegjës për hartimin e këtij projektligji. Drafti final nga ana e ekipit përgjegjës është hartuar dhe i njëjti është proceduar në Ministrinë e Financave në fund të muajit tetor të vitit 2017. Qëllimi i nxjerrjes së këtij Ligji është rregullimi i licencimit, veprimtarisë dhe mbikëqyrjes së institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare.

**Draft Ligji i ri për Mbrojtjen e Konsumatorit** – BQK-ja ka pasur rolin kyç në hartimin e Ligjit të ri për Mbrojtjen e Konsumatorit me të cilin është bërë transpozimi i Direktivës së BE-së për Marrëveshjet e Kredive për Konsumator (Direktiva 2008/48 EC); transpozimi i Direktivës së BE-së për Tregtimin e Shërbimeve Financiare në Distançë (Direktiva 2002/65 EC); trajtimi dhe rregullimi i çështjeve të cilat deri me tani kanë sjellë probleme në zbatimin e Ligjit aktual: a) dhënia e kredisë Publikut të Kufizuar që në praktikë ka paraqitur dilema në mënyrën e kuptimit dhe implementimit, si dhe b) është sqaruar çështja e kompetencës (së institucioneve) lidhur me marrjen e masave administrative në rast të shkeljes së dispozitave të ligjit. Edhe pse si draft ka qenë i përgatitur gjatë vitit 2016, megjithatë pas ofrimit të bashkëpunimit më të gjerë nga ana e Ministrisë së Tregtisë me Shoqatën e Bankave, gjatë vitit 2017 është rishikuar pjesa e draft ligjit lidhur me kreditë konsumuese dhe ofrimin e shërbimeve financiare në distancë ku përveç takimeve të mbajtura janë trajtuar edhe të gjitha komentet dhe propozimet e dhëna nga ana e Shoqatës së Bankave. Ligji pritet të hyjë në fuqi në të ardhmen e afërt.

Përfshirja e BQK-së në kuadër të grupeve punuese ndër-institucionale për përgatitjen dhe amandamentimin e ligjeve të lartcekura, por edhe për përgatitjen e planit të veprimit për implementimin e MSA-së dhe grupeve të caktuara për harmonizimin e legjislacionit me direktivat e BE-së në fushën e lëvizjes së lirë të shërbimeve dhe të kapitalit, dëshmon kontributin e BQK-së në përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm të infrastrukturës ligjore edhe në mbështetje të institucioneve tjera, për ndërtimin dhe ruajtjen e një sistemi të shëndosh dhe të qëndrueshëm financiar si parakusht për zhvillimin ekonomik të vendit.

### 4.3. Korniza rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme

Gjatë vitit 2017 BQK-ja ka filluar me projektin e rishikimit të kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme, në funksion të përditësimit të kërkesave për të përmirësuar praktikën e vlerësimit të pronave të paluajtshme nga ana e institucioneve financiare në përputhje me standardet e reja të Evropës (European Valuation Standards - EVS 2016). Ky projekt është duke u zhvilluar me mbështetjen e këshilltarit nga Thesari Amerikan z.Lewis Allen, ekspert i fushës me përvojë të gjatë në fushën e vlerësimit të pronave të paluajtshme për nevojat e bankave. Në kuadër të këtij projekti, gjatë vitit 2017 është filluar edhe me amandamentimin e rregullores për programin e licencimit të vlerësuesve të pronave të paluajtshme, të organizuar nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Odën Ekonomike, në funksion të adaptimit të kërkesave të nevojshme për implementimin e kontrollit të cilësisë, bazuar në standardet e reja të lartcekura, në mënyrë që të zhvillohet korniza e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së vlerësimeve të pronave të paluajtshme. Ky proces pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2018.

### 4.4. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar një numër i vizitave dhe aktiviteteve në funksion të rritjes së bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare të cilat ndërlidhen me fushën e mbikëqyrjes së institucioneve financiare.

BQK-ja gjithashtu gjatë këtij viti ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me EBA (European Banking Authority), si dhe për herë të parë është ftuar të marrë pjesë në takimet e

rregullta të këtij Institucioni, bashkë me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të rajonit (Ballkanit Perëndimor).

#### 4.5. Korniza rregullative

##### 4.5.1 Korniza rregullative e sistemit financiar

BQK-ja ka ndërtuar një kornizë rregullative për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare e mbështetur në vazhdimësi nga institucione të njohura ndërkombëtare, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID, Thesari Amerikan, KfW, GIZ, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe institucione tjera ndërkombëtare. Korniza rregullative është hartuar në pajtueshmëri me direktivat evropiane që adresojnë rregullimin e institucioneve financiare, si standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Gjithashtu, BQK-ja ka filluar një proces gradual drejt përafrimit me parimet bazike për mbikëqyrjen e bankave të nxjerra nga BIS – Bank for International Settlements, parimet bazike për mbikëqyrjen e siguruesve të nxjerra nga IAIS – International Association for Insurance Supervision, si dhe parimet për mbikëqyrjen e pensioneve të nxjerra nga IOPS - International Organisation of Pension Supervisors. Meqenëse direktivat, standardet ndërkombëtare dhe parimet e lartcekura lidhur me rregullimin e institucioneve financiare dhe fushën e veprimtarisë së tyre janë të karakterit dinamik, kjo ndikon që hartimi i kornizës juridike të jetë një proces i vazhdueshëm dhe kompleks pasi që kërkon plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe rregullative, si dhe kërkon një qasje adekuate në mënyrë, që të studiohen me kujdes rrethanat specifike të Kosovës, për një adaptim adekuat të këtyre instrumenteve juridike ndërkombëtare për nevojat e sektorit financiar në Kosovë.

Përpilimi dhe rishikimi i rregulloreve të mbikëqyrjes financiare (banka, institucione mikrofinanciare, institucione financiare jobankare, sigurime dhe fonde pensionale) bëhet nga grupet punuese, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të departamenteve përkatëse, si departamentit të mbikëqyrjes bankare, licencimit, sigurimeve, pensioneve, departamentit juridik si dhe departamentet tjera varësisht nga fusha që adresohet dhe ndërlidhja e saj me departamentet përkatëse të BQK-së. Gjatë përgatitjes së rregulloreve dhe çdo instrumenti rregullativ, BQK-ja bashkëpunon ngushtë me institucionet tjera dhe industrinë, përmes takimeve dhe komunikimit të vazhdueshëm me subjektet e rregulluara, kryesisht përmes shoqatave përkatëse të institucioneve, si Shoqatën e Bankave të Kosovës, Shoqatën e Sigurimeve, Shoqatën e Institucioneve Mikrofinanciare, por dhe me institucione tjera vendore në trajtimin e çështjeve që prekin edhe fusha tjera të ndërlidhura me sektorin financiar. Ky proces ka ndihmuar vazhdimisht në qartësimin e çështjeve specifike që adresohen me rregullore dhe rregullimin e drejtë të tyre, duke marrë parasysh ndikimin e tyre në stabilitetin e sistemit financiar në Kosovë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

##### 4.5.2 Plotësimi i kornizës rregullative për mbikëqyrjen e bankave<sup>11</sup>, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare

Në vijim janë shpalosur plotësimet në kornizën rregullative për mbikëqyrjen e bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare gjatë vitit 2017:

**Korniza rregullative për faktoringun**- gjatë vitit 2017 është themeluar grupi punues brenda BQK-së për hartimin e kornizës rregullative të faktoringut. Për këtë qëllim është siguruar edhe

<sup>11</sup> Aktivitetet rregullative që kanë të bëjnë me Adaptimin e Kornizës së Baselit për Kapitalin e Bankave, janë të përshkruara më lartë në pikën 3.1 të këtij raporti.

asistenca nga BERZH (EBRD). Finalizimi i kësaj kornize ligjore pritet të bëhet gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2018.

**Korniza rregullative për likuidimin e bankave** – gjatë vitit 2017 është themeluar grupi punues brenda BQK-së për hartimin e kornizës rregullative për likuidimin e bankave. Kjo kornizë do të hartohet për të siguruar pajtueshmëri me Direktivën e BE-së nr. 59 e vitit 2014 për rimëkëmbjen dhe likuidimin e bankave (Directive 2014/59/EU — rules for the recovery and resolution of credit institutions and investment firms). Për këtë qëllim, është siguruar edhe asistenca nga BERZH (EBRD). Finalizimi i kësaj kornize rregullative pritet të bëhet gjatë vitit 2018.

**Rregullorja për Kamatëvonesën** si rrjedhojë e Ligjit për Kamatëvonesën në transaksionet tregtare – DLS në bashkëpunim me DMB kanë finalizuar draftin i rregullores duke përfshirë trajtimin e komenteve dhe diskutimeve me Shoqatën e Bankave. Për këtë draft rregullorë të gjitha komentet dhe diskutimet janë përfunduar dhe ka mbetur vetëm miratimi nga ana e Bordit të BQK-së.

**Rregullorja për Kërkesat për Shpalosjen dhe Reklamimin e Shërbimeve Financiare** – kjo rregullorë fillimisht është përgatitur nga ekipi i Bankës Botërore në kuadër të projektit të mbrojtjes së konsumatorit gjatë vitit 2014. Drafti është shqyrtuar hollësisht nga stafi i BQK-së dhe është finalizuar në koordinimin me ekipin i BB-së dhe me institucionet financiare gjatë vitit 2015. Përpunimi i mëtutjeshëm është planifikuar gjatë vitit 2018 kur është paraparë që ky draft të përpunohet më tepër për të adresuar kërkesat sa i përket shpalosjes dhe reklamimit dhe për të përfshirë të gjitha shërbimeve financiare. Finalizimi i kësaj rregulloreje pritet të bëhet në fund të vitit 2018.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017 ka vazhduar hartimi i akteve nënligjore për IMF dhe IFJB. Finalizimi dhe procedimi për miratim nga Bordi i BQK-së, do të bëhet pas hyrjes në fuqi të Ligjit për IMF dhe IFJB.

#### 4.5.3 Plotësimi i kornizës rregullative për mbikëqyrjen e siguruesve

Në janar të vitit 2016 ka hyrë në fuqi Ligji 05/L-045 për Sigurimet bazuar në të cilin gjatë vitit 2016 janë amendamentuar pjesa më e madhe e rregullave ekzistuese për mbikëqyrjen e sigurimeve, të cilat janë shëndrruar në rregullore. Gjatë vitit 2017 ka vazhduar nxjerrja e rregulloreve të reja në zbatim të këtij ligji si dhe hartimi i rregulloreve tjera të cilat janë ende në proces për t'u finalizuar dhe më pas për t'u proceduar për vendimmarrje. Në vijim janë shpalosur më hollësisht plotësimet në kornizën rregullative të sigurimeve gjatë vitit 2017:

**Rregullore për Adekuatshmërinë e kapitalit:** (Rregullore për llogaritjen e kufirit minimal të aftësisë paguese, adekuatshmërisë së kapitalit dhe fondit garantues për siguruesit jojetë) (miratuar nga Bordi i BQK-së më 23 shkurt 2017) – kjo rregullore përcakton mënyrat e llogaritjes së kufirit minimal të aftësisë paguese, adekuatshmërisë së kapitalit dhe fondit garantues për siguruesit jo-jetë, si dhe afatet, format, përmbajtjen dhe mënyrën e raportimit në BQK.

**Rregullore për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm:** (miratuar nga Bordi i BQK-së më 31 gusht 2017) – qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e një licence për një sigurues/risigurues apo për një degë të siguruesit/risiguruesit të jashtëm.

**Rregullore për Licencimin e Ndërmjetësuesve të Sigurimeve:** (miratuar nga Bordi i BQK-së më 31 gusht 2017) – qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kriteret, procedurat dhe afatet për licencimin e ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe risigurimeve.

**Rregullore për Hapjen dhe Mbylljen Brenda dhe Jashtë Republikës së Kosovës të Degëve dhe Subjekteve të Varura të Siguruesve:** (miratuar nga Bordi i BQK-së më 31 gusht 2017) – qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për hapjen dhe mbylljen e degëve të siguruesve brenda Republikës së Kosovës dhe hapjen e degëve të siguruesve apo subjekteve të varura jashtë Republikës së Kosovës.

**Rregullore për Mbikëqyrjen e Konsoliduar të Grupeve të Sigurimeve:** (miratuar nga Bordi i BQK-së më 30 nëntor 2017) – qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve të siguruesve.

**Rregullore për Procedurat e Tribunalit të Arbitrazhit:** (miratuar nga Bordi i BQK-së më 30 mars 2017) – qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurat për funksionimin e Tribunalit të arbitrazhit.

**Rregullore për Llogaritjen dhe Financimin e Fondit të Kompensimit:** (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 28 dhjetor 2017). Me këtë rregullore është përcaktuar mënyra e financimit, llogaritjes dhe investimit të Fondit të Kompensimit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017, janë përgatitur draftet finale të **Rregullores për Licencimin e Trajtuesve të Dëmeve në Sigurime, Rregullores për përcaktimin e shkeljeve dhe dënimeve me gjobë për siguruesit dhe Udhëzimi mbi Statusin e Punonjësve të Siguruesve që Merren me Shitjen e Produkteve të Sigurimeve dhe Mënyrën e Shitjes së Sigurimit të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia**, të cilat pritet të miratohen gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2018.

#### 4.5.4 Plotësimi i kornizës rregullative për mbikëqyrjen e fondeve pensionale

Gjatë vitit 2017 është vazhduar me amandamentimin e kornizës rregullative për mbikëqyrjen e pensioneve në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për fondet pensionale dhe Ligji nr. 05/l -116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-115 dhe ligjin nr. 04/l-168 për adresimin e çështjeve që ndërlidhen me mbikëqyrjen e fondeve pensionale të cilat është vlerësuar e nevojshme të adresohen me anë të legjislacionit sekondar.

Gjatë vitit 2017 janë përgatitur dhe janë miratuar rregulloret në vijim:

**Rregullore për Vlerën e Kontributeve të Pensionit;** (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 27 prill 2017). Me këtë rregullore përcaktohen kriteret minimale për përcaktimin e vlerës që mund të kontribuohet për programin e pensionit plotësues.

**Rregullore për Mjetet e Pensioneve dhe Vlerësimin e Mjeteve Pensionale;** (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 29 qershor 2017). Me këtë rregullore përcaktohet metoda dhe parimet e vlerësimit të mjeteve pensionale, si dhe mënyra dhe afati kohor në të cilin mbajtësi duhet të dorëzojë raportet në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, Fondin e Pensioneve, si dhe Siguruesve të Pensioneve dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

**Rregullore për Kontrollin e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm;** (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 29 qershor 2017). Me këtë rregullore janë përcaktuar parimet themelore mbi organizimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme dhe funksionit të auditimit të brendshëm të fondeve pensionale.

**Rregullore për Raportimin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;** ( miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 30 mars 2017). Me këtë rregullore janë përcaktuar afatet dhe rregullat e raportimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në BQK dhe në Kuvendin e Kosovës.

**Rregullore mbi Investimet e Mjeteve Pensionale;** (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 23 shkurt 2017). Me këtë rregullore janë specifikuar kushtet dhe parimet e investimit të mjeteve pensionale në pajtim me Ligjin nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.

#### 4.5.5 Instrumente tjera rregullative

**Rregullore për Lëshimin e Certifikatave të Licencimit apo Regjistrimit të Institucioneve Financiare** - (miratuar më datë 31 gusht 2017) Me këtë rregullore është përcaktuar forma dhe përmbajtja e certifikatave të licencës apo regjistrimit të institucioneve financiare, si dhe është përcaktuar procedura për lëshimin dhe/ose zëvendësimin e tyre.

**Rregullorja për Instrumentet e Pagesave Elektronike** - (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 31 gusht 2017). Me këtë rregullore janë përcaktuar kushtet, kërkesat dhe procedurat për lëshimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike, si dhe përcaktimi i mënyrës së raportimit të informacionit gjatë përdorimit të këtyre instrumenteve të pagesave elektronike, nga bankat dhe institucionet e autorizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), që të kryejnë shërbime me instrumente të pagesave elektronike.

**Rregulla e Brendshme për Trajtimin e Ankesave** - (miratuar nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së më datë 26 dhjetor 2017). Me këtë rregull janë përcaktuar procedurat dhe afatet e shqyrtimit të ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare nga ana e BQK-së.

#### 4.5.6 Mbështetja ligjore dhe rregullative e shtyllës së Mbikëqyrjes Financiare

BQK-ja ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në përgatitjen e raporteve të rregullta që lidhen me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian (MSA) dhe përgatitjen e planit të veprimit për implementimin e obligimeve që dalin nga kjo marrëveshje për sa i përket fushës së mbikëqyrjes së institucioneve financiare.

Gjithashtu, Divizioni i Rregullimit dhe Standardizimit në kuadër të DLS-së, në mënyrë të vazhdueshme ka ofruar mbështetje ligjore për departamentet dhe divizionet e tjera të mbikëqyrjes financiare. Janë dhënë interpretime të instrumenteve rregullative të BQK-së, si dhe opinione të ndryshme ligjore kryesisht për nevojat e brendshme në kuadër të aktiviteteve të licencimit dhe mbikëqyrjes. Njëkohësisht, janë dhënë opinione ligjore dhe interpretime të vazhdueshme për Institucionet Financiare (bankat, siguruesit, IMF-të, IFJB-të, ndërmjetësuesit e sigurimeve dhe Fondet Pensionale) dhe institucionet e tjera shtetërore për sa i përket kornizës ligjore dhe rregullative në fuqi për mbikëqyrjen e institucioneve financiare.

### 4.6. Licencimi

#### 4.6.1 Politika dhe procedurat e licencimit

Sipas Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, autoriteti i vetëm përgjegjës për rregullimin, licencimin/regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Në Ligjin nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Ligjin nr. 05/L-045 për Sigurimet, Ligjin nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave, Ligjin nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra nga BQK janë të përcaktuara kriteret dhe kushtet që duhet plotësuar nga aplikantët për të marrë licencë/regjistrim për kryerjen e veprimtarive financiare nga bankat, siguruesit, fondet pensionale dhe subjektet tjera që ushtrojnë veprimtari financiare në Republikën e Kosovës.

Në kontekst të licencimit dhe regjistrimit objektivi i përgjithshëm i BQK-së është që të sigurojë një proces transparent gjithëpërfshirës, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurt, të



qëndrueshëm dhe konkurrues financiar. Në funksion të përmbushjes së këtij objekti, përmes rritjes së transparencës dhe inkurajimit të efikasitetit dhe konkurrencës, DLS ka rishikuar politikën, procedurat dhe praktikën e licencimit dhe regjistrimit të institucioneve financiare konkretisht për banka, institucione mikrofinanciare, institucione financiare jobankare, sigurues dhe ndërmjetësues në sigurime në mënyrë që të sigurojë një kornizë dinamike, efikase dhe të strukturuar të licencimit dhe regjistrimit financiar, përmes hartimit të manualeve dhe procedurave të licencimit gjatë vitit 2017 të cilat më pas janë miratuar nga Bordi i BQK-së.

**Manuali dhe Procedurat e Licencimit të Bankave** (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 14 korrik 2017). Manuali dhe procedurat kanë detajuar të gjitha procedurat që duhet ndjekur në rastet e shqyrtimit të kërkesave për licencimin e bankave, duke filluar nga faza e shprehjes së interesit për licencim nga palët deri në lëshimin e licencës finale. Gjithashtu pjesë përbërëse e manualit janë edhe format e ndryshme të cilat duhet të plotësohen nga palët që aplikojnë për licencim.

**Manuali dhe Procedurat e Licencimit të Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare** (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 14 korrik 2017). Manuali dhe procedurat kanë detajuar të gjitha procedurat që duhet ndjekur në rastet e shqyrtimit të kërkesave për regjistrimin e Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare, duke filluar nga faza e shprehjes së interesit për regjistrim nga palët deri në miratimin e tij. Gjithashtu pjesë përbërëse e manualit janë edhe format e ndryshme të cilat duhet të plotësohen nga palët që aplikojnë për regjistrim.

**Manuali dhe Procedurat e Licencimit të Siguruesve** (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 27 tetor 2017). Manuali ka detajuar të gjitha procedurat që duhet ndjekur në rastet e shqyrtimit të kërkesave për licencim të siguruesve, duke filluar nga faza e shprehjes së interesit për licencim nga palët deri në lëshimin e licencës finale. Gjithashtu pjesë përbërëse e manualit janë edhe format e ndryshme të cilat duhet të plotësohen nga palët që aplikojnë për licencim.

**Manuali dhe Procedurat e Licencimit të Ndërmjetësuesve në Sigurime** (miratuar nga Bordi i BQK-së më datë 27 tetor 2017). Manuali ka detajuar të gjitha procedurat që duhet ndjekur në rastet e shqyrtimit të kërkesave për licencim të ndërmjetësuesve në sigurime (si individ dhe si kompani ndërmjetësuese), duke filluar nga faza e shprehjes së interesit për licencim nga palët deri në lëshimin e licencës. Gjithashtu pjesë përbërëse e manualit janë edhe format e ndryshme të cilat duhet të plotësohen nga palët që aplikojnë për licencim si kompani ndërmjetësuese.


Në funksion të rritjes së transparencës dhe inkurajimit të efikasitetit dhe konkurrencës, **BQK-ja ka publikuar manualin e licencimit dhe regjistrimit** pasi që të njëjtat shërbejnë si një udhëzues për të gjithë të interesuarit potencial për themelimin e institucioneve financiare. **BQK-ja gjithashtu ka hartuar një përzgjedhje të pyetjeve më të shpeshta rreth procesit të licencimit dhe regjistrimit financiar të pranuar gjatë viteve nga të interesuarit për licencim, mediat dhe publiku i gjerë të cilat gjithashtu janë publikuar në ueb-faqen e BQK-së dhe të njëjtat do të përditësohen në baza të vazhdueshme.**

#### 4.6.2 Struktura e sistemit financiar në Kosovë

Kriteret e licencimit të përcaktuara me kornizën ligjore dhe rregullatore në fuqi, synojnë sigurimin e një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar nëpërmjet një procesi të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore.

Struktura e sistemit financiar në fund të vitit 2017, sipas llojit të institucioneve financiare të licencuara dhe regjistruara që ofrojnë shërbime financiare në Kosovë bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të renditura sipas peshës së tyre në sistem është paraqitur në figurën 44.

**Figura 44. Struktura e sistemit financiar në Kosovë**



Struktura e sistemit financiar përbëhet nga gjithsej 112 institucione financiare të cilat janë licencuar dhe regjistruar, si dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Struktura e sistemit financiar megjithatë donimohet nga bankat, fondet pensionale dhe siguruesit marrë parasysh që së bashku menaxhojnë 96.5% të gjithsej mjeteve të sistemit financiar përkundër faktit që në numër janë shumë më pak se IMF-të, IFJB-të dhe ndërmjetësuesit në sigurime së bashku. Peshën më të madhe në kuadër të sistemit financiar në vend e kanë dhjetë bankat të cilat në fund të vitit 2017, përbënin 65.5% të gjithsej mjeteve të sistemit financiar. Bankat pasohen nga dy fondet pensionale të cilat së bashku menaxhojnë 27.9% të mjeteve të sistemit. Siguruesit në vend radhiten të tretit për nga pesha marrë parasysh që në fund të vitit 2017 përbënin 3.0% të mjeteve të sektorit. Pjesa e mbetur prej 3.6% menaxhohet nga IMF-të, IFJB-të dhe ndihmësit në sigurime.

#### 4.6.3 Struktura e pronësisë të sistemit financiar sipas sektorëve

Struktura e mjeteve të sektorit financiare në fund të vitit 2017 dominohet nga bankat, të cilat menaxhojnë me 65.5% të gjithsej mjeteve në këtë sektor. Fondet pensionale radhiten të dytat për nga pesha pasi që menaxhojnë me 27.9% të gjithsej mjeteve të sistemit. Siguruesit menaxhojnë me 3.0% të gjithsej mjeteve të sistemit prandaj edhe rënditen në pozitën e tretë. Pjesa e mbetur e mjeteve të sektorit financiar në Kosovë, menaxhohet nga institucionet mikrofinanciare (2.5%) dhe institucionet financiare jobankare dhe ndihmësit tjerë financiarë (1.0%).

Struktura e kapitalit të sektorit bankar vazhdon të dominohet nga kapitali i huaj, ku në fund të vitit 2017, tetë (8) nga dhjetë (10) bankat e licencuara të operojnë në vend janë me kapital të huaj dhe përbëjnë 90.2% të gjithsej kapitalit të sektorit, duke mos shfaqur ndonjë ndryshim të madh krahasuar me një vit më parë.


Tabela 5. Struktura e mjeteve të institucioneve financiare

Transaksionet	2013		2014		2015		2016		2017	
	Vlera € ('000)	Pjesëmarrja %	Vlera € ('000)	Pjesëmarrja %	Vlera € ('000)	Pjesëmarrja %	Vlera € ('000)	Pjesëmarrja %	Vlera € ('000)	Pjesëmarrja %
Bankat	3,059.28	72.3%	3,186.62	70.2%	3,385.34	69.0%	3,637.05	67.5%	3,877.46	65.5%
Fondet Pensionale	918.93	21.7%	1,094.08	24.1%	1,237.33	25.2%	1,425.44	26.5%	1,653.00	27.9%
Siguruesit	132.52	3.1%	139.98	3.1%	152.68	3.1%	161.89	3.0%	177.31	3.0%
Institucionet Mikrofinanciare	73.54	1.7%	74.08	1.6%	82.21	1.7%	110.03	2.0%	147.36	2.5%
Institucionet Financiare Jobankare dhe ndihmësit tjerë financiar	46.98	1.1%	47.68	1.0%	48.41	1.0%	52.24	1.0%	62.00	1.0%
<b>Gjithsej</b>	<b>4,231.25</b>	<b>100.0%</b>	<b>4,542.44</b>	<b>100.0%</b>	<b>4,905.97</b>	<b>100.0%</b>	<b>5,386.65</b>	<b>100.0%</b>	<b>5,917.12</b>	<b>100.0%</b>

Burimi: BQK (2018)

Banka më e mëdhe në vend, e cila përbën 25.6% të gjithë kapitalit të sektorit (figura 45), është nga Austria, ndërsa e dyta është nga Gjermania dhe përfaqëson 20.6% të gjithë kapitalit të sektorit. Turqia përfaqësohet me tri banka në Kosovë (dy nga të cilat në formë të degëve të bankave të huaja) të cilat përbëjnë 22.0% të gjithë kapitalit të sektorit. Sllovenia vijon të përfaqësohet me një bankë në treg, e cila renditet e treta për nga madhësia me pjesëmarrje prej 14.0% në gjithë kapitalin e sektorit bankar. Dy banka vendore përfaqësojnë 9.8% të gjithë kapitalit duke shënuar rritje të lehtë të pjesëmarrjes në sektor krahasuar me një vit më parë. Shqipëria vazhdon të përfaqësohet me një bankë, e cila operon në formë të degës, me pjesëmarrje prej 6.5% në kapitalin e sektorit, e cila ka zvogëluar lehtë pjesëmarrjen krahasuar me vitin 2016. Një bankë nga Serbia vazhdon të operojë në treg në formë të degës dhe ka pjesëmarrjen prej 1.5% të gjithë kapitalit të sektorit bankar.

Figura 45. Struktura e kapitalit në sektorin bankar sipas origjinës



Burimi: BQK (2018)

Struktura e pronësisë së sektorit të sigurimeve dominohet nga siguruesit e sigurimeve jo-jetë të menaxhojnë 87.8% të gjithë mjeteve të tregut të sigurimeve siç edhe shihet në tabelën 6. Megjithatë, trendi pesë vjeçar i zhvillimit të sektorit tregon një rritje graduale të pjesëmarrjes së sigurimeve jetë në gjithë mjetet e sektorit. Siguruesit vendorë për herë të parë në vitin 2017 dominojnë sigurimet jojetë duke marrë parasysh që menaxhojnë rreth 52.17% të gjithë mjeteve të kësaj pjese të sektorit dhe 58% të gjithë mjeteve të sektorit të sigurimeve. Ky ndryshim në strukturën e pronësisë vjen si rezultat i transferimit të pronësisë nga një sigurues i huaj në atë vendor në gjashtëmuorin e parë të vitit 2017. Në anën tjetër, gjithë mjetet e sigurimeve jetë në tërësi vazhdojnë të menaxhohen nga sigurues të huaj.

Tabela 6. Struktura e tregut të sigurimeve


Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
<b>Gjithsej Asetet (miliona Euro)</b>	<b>132.7</b>	<b>140.4</b>	<b>152.7</b>	<b>161.9</b>	<b>177.3</b>
Pjesëmarrja sipas përqindjes					
<b>Jojetë</b>	<b>90.00%</b>	<b>90.00%</b>	<b>90.00%</b>	<b>89.88%</b>	<b>87.83%</b>
Vendore	39.00%	36.00%	31.50%	42.27%	52.17%
Të jashtme	61.00%	64.00%	68.50%	57.73%	47.83%
<b>Jetë</b>	<b>10.00%</b>	<b>10.00%</b>	<b>10.00%</b>	<b>10.12%</b>	<b>12.17%</b>
Vendore	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Të jashtme	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

Burimi: BQK (2018)



Origjina e kapitalit të siguruesve të huaj është paraqitur në figurën 46. Katër sigurues të cilët menaxhojnë 36% të mjeteve të sektorit janë me origjinë nga Shqipëria (aksionari indirekt nga Austria). Sllovenia vijon të përfaqësohet me dy sigurues në treg, të cilët menaxhojnë 17% të gjithë mjeteve të sektorit. Shqipëria përfaqësohet me dy sigurues në sektorin e sigurimeve në vend të cilët sikur të ishin në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullatore do të radhiteshin të katërtit për nga pjesëmarrja, megjithatë të dy mbesin nën kërkesat rregullatore për kapital. Me transferimin e pronësisë në gjashtëmuorin e parë të vitit 2017, Turqia më nuk është prezente në tregun e sigurimeve në vend.

Figura 46. Struktura e kapitalit në sektorin e sigurimeve, sipas origjinës



Burimi: BQK (2018)

Struktura e pronësisë së sektorit pensional dominohet nga fondi detyrues pensional vendor, i cili menaxhon 99.5% të gjithë mjeteve të tregut të pensioneve siç edhe shihet në tabelën 7. Fondi plotësues me kapital të kombinuar vendor dhe slloven menaxhon 0.6% të gjithë mjeteve të sektorit.

Tabela 7. Struktura e sektorit pensional


Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
<b>Gjithëj Asetet (miliona Euro)</b>	<b>918.9</b>	<b>1094.1</b>	<b>1237.3</b>	<b>1425.4</b>	<b>1653.0</b>
Pjesëmarrja sipas përqindjes					
Fondi Detyrues (vendor)	99.4%	99.5%	99.5%	99.5%	99.5%
Fondi Plotësues (i huaj-vendor)	0.6%	0.6%	0.6%	0.6%	0.6%

Burimi: BQK (2018)

#### 4.6.4 Rrjeti i sistemit financiar sipas sektorëve

Bankat në fund të vitit 2017, veprimtarinë e tyre e ushtruan në gjithë 55 degë dhe 183 zyra brenda territorit të vendit (figura 47). Gjatë këtij viti bankat, me miratim të BQK-së kanë hapur 2 nëndegë, kanë zhvendosur 16 degë dhe zyra si dhe kanë mbyllur 26 zyra. Ngushtimi i rrjetit të degëve dhe zyrave është bërë kryesisht bazuar në vlerësim të performancës dhe efikasitetit të tyre, si dhe si rrjedhojë e zgjerimit të shërbimeve të automatizuara si: e-banking, bankomatëve, terminaleve të shitjes, mobile banking etj.

Figura 47. Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave



Burimi: BQK (2018)

Shpërndarja gjeografike e rrjetit bankar përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit përkundër ngushtimit të shënuar në raport me numrin e degëve dhe zyrave (tabela 8). Megjithatë, vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe zyrave në regionin e Prishtinës (35%), ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (28%) siç edhe shihet në figurën 48.

**Tabela 8. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave**

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2013	102	34%	47	16%	52	17%	62	21%	35	12%	298
2014	97	35%	45	16%	46	17%	55	20%	34	12%	277
2015	93	35%	40	15%	45	17%	52	20%	35	13%	265
2016	95	36%	38	15%	42	16%	52	20%	35	13%	262
2017	83	35%	37	16%	39	16%	47	20%	32	13%	238


Burimi: BQK (2018)

Trendi pesëvjeçar sugjeron strategji konsistente të bankave sa i përket fokusimit gjeografik të rrjetit bankar duke marrë parasysh, që nuk kemi ndryshim të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe në raport me përqindjen e degëve dhe zyrave bankare, përkundër ndryshimeve në raport me numrat e degëve dhe zyrave, për arsye se ngushtimi i rrjetit është bërë në mënyrë proporcionale në të gjitha regjionet.


Siguruesit veprimtarinë e tyre e ushtrojnë përmes 88 degëve, 380 zyreve, 534 agjentëve të brendshëm dhe 229 agjentëve të jashtëm brenda territorit të vendit (figura 49). Gjatë vitit 2017, kemi ngushtim të rrjetit të përgjithshëm të siguruesve në vend, me përjashtim të agjentëve të jashtëm numri i të cilëve ka shënuar rritje. Rënia e numrit të zyrave reflekton strategjinë e siguruesve për zvogëlim të kostove ndërsa rënia e numrit të agjentëve ndër të tjerash reflekton edhe faktin që me miratimin e Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, agjentët e brendshëm të siguruesve më nuk janë subjekt i miratimit të BQK-së që nga data 15 shtator 2017.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit të siguruesve përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit megjithatë nuk përputhet me shpërndarjen gjeografike të popullsisë.

Përdorimi i përqendrimi më i madh i popullsisë është në regjionin e Prishtinës (28%, figura 48), përqendrimi i rrjetit të siguruesve është në regjionin e Pejës, që është një nga regjionet më pak të populluara në vend (shih figurën 48) dhe kjo strukturë është konsistente gjatë pesë viteve të fundit (tabela 9).

**Figura 48. Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve**

Burimi: ASK (2018)

**Figura 49. Rrjeti i siguruesve**

Burimi: BQK (2018)

**Tabela 9. Rrjeti i siguruesve sipas shpërndarjes gjeografike**

Vitet	Rajoni i Prishtinës		Rajoni i Prizrenit		Rajoni i Pejës		Rajoni i Gjiçanit		Rajoni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2013	10	16.9%	10	16.9%	15	25.4%	15	25.4%	9	15.3%	59
2014	10	15.9%	10	15.9%	16	25.4%	17	27.0%	10	15.9%	63
2015	15	20.5%	41	56.2%	14	19.2%	7	9.6%	9	12.3%	86
2016	11	15.1%	11	15.1%	21	28.8%	18	24.7%	11	15.1%	72
2017	13	17.8%	11	15.1%	20	27.4%	19	26.0%	10	13.7%	73

Burimi: BQK (2018)

Fondet pensionale aktivitetin e tyre e zhvillojnë vetëm përmes zyrave qendrore të vendosura në Prishtinë.

Shpërndarja gjeografike e zyrave të institucionet mikrofinanciare është e përqendruar në vetëm dy regjione të territorit të vendit konkretisht në regjionin e Prishtinës dhe të Pejës, pas mbylljes së degës/zyrës së fundit në regjionin e Prizrenit gjatë vitit 2017 (tabela 10). Institucionet mikrofinanciare, në fund të vitit 2017 aktivitetin e tyre e ushtruan përmes 118 zyra të shpërndara brenda territorit të vendit. Gjatë vitit 2017 është aprovuar hapja e 8 zyrave, si dhe zhvendosja e 8-të zyrave tjera të IMF-ve.

**Tabela 10. Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike**

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2013	8	57%	2	14%	4	29%	14
2014	7	54%	2	15%	4	31%	13
2015	7	54%	2	15%	4	31%	13
2016	7	64%	1	9%	3	27%	11
2017	8	73%	0	0%	3	27%	11

Burimi: BQK (2018)

Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të institucionet financiare jobankare është i përqendruar në pothuajse gjithë territorin e vendit me përjashtim të regjionit të Mitrovicës (tabela 11). Institucionet financiare jobankarenë fund të vitit 2017, aktivitetin e tyre e ushtruan në gjithsej 719 zyra dhe agjentë të shpërndarë brenda territorit të vendit.

**Tabela 11. Rrjeti i IFJB-ve sipas shpërndarjes gjeografike**

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjiçanit		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2013	16	37%	6	14%	12	28%	9	21%	43
2014	17	36%	6	13%	12	26%	12	26%	47
2015	17	35%	7	14%	12	24%	13	27%	49
2016	18	35%	8	15%	12	23%	14	27%	52
2017	22	39%	10	18%	12	21%	12	21%	56

Burimi: BQK (2018)

#### 4.6.5 Aktiviteti i licencimit në sistemin financiar

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të licencimit dhe funksionimit normal të veprimtarive financiare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në zbatim të kërkesave që rrjedhin nga Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Ligji nr. 05/L-045 për Sigurimet, Ligji nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave, Ligjin nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale

të Kosovës dhe kuadri tjerë rregullativ i BQK-së, gjatë vitit 2017 ka shqyrtuar gjithsej 745 kërkesa nga të cilat 17 aplikacione për licencim/regjistrim dhe 728 kërkesa të institucioneve financiare për miratim të transaksioneve të cilat sipas legjislacionit në fuqi kërkojnë miratim paraprak të BQK-së (tabela 12). Këtu nuk përfshihen: i) kërkesat e shqyrtuara të bartura për vendimmarrje në vitin 2018; ii) shprehjet e interesimit për licencim/regjistrim, ii) kërkesat të cilat vlerësohen mirëpo nuk janë subjekt i miratimit të BQK-së dhe iv) pyetjet, njoftimet e vlerësimet tjera të shqyrtuara nga Divizioni i Licencimit në DLS.

Licencimi dhe regjistrimi i 17 institucioneve të reja për të ushtruar aktivitet financiar në vend gjatë vitit 2017, të cilat plotësojnë kriteret e licencimit të përcaktuara me kornizën ligjore dhe rregullatore në fuqi, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja pa i cenuar kërkesat ligjore. Gjatë 2017, ngjashëm me vitin e kaluar BQK-ja ka pranuar kryesisht kërkesa për regjistrim të IMF-ve, IFJB-ve dhe ndërmjetësuesve në sigurime. Në përgjithësi struktura e kërkesave për licencim mbetet e ngjashme, rritja e lehtë e shënuar në krahasim me vitin paraprak reflekton kërkesën më të lartë për regjistrim të IFJB-ve.

**Tabela 12. Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratua/refuzuara nga BQK**

Transaksionet	2016						2017					
	Bankë	Fonde pensionale	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime	Gjithsej	Bankë	Fonde pensionale	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime	Gjithsej
Aplikacionet	0	0	4	0	10	14	0	0	6	0	11	17
Aksionarët kryesor dhe ndryshime në kapital	1	0	2	3	2	8	1	0	1	3	1	6
Drejtorë dhe menaxherë të lartë	19	0	21	49	12	101	40	0	22	30	3	95
Auditori i jashtëm	10	1	22	15	8	56	10	1	24	16	7	58
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit	4	0	5	4	0	13	4	0	4	4	2	14
Përvetësimet e interesit të kapitalit dhe transferimi i portofolit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1
Zgjerim i veprimtarive financiare	0	0	1	5	0	6	0	0	0	3	0	3
Hapja, zhvendosja dhe mbyllja e degëve dhe zyrave brenda dhe jashtë vendit	22	0	74	114	6	216	44	0	46	86	6	182
Licencimi dhe regjistrimi i agjentëve	0	0	63	176	68	307	0	0	70	61	91	222
Tërheqja e licencimit/regjistrimit	0	0	19	0	1	20	0	0	96	0	1	97
Tjetër	40	0	9	1	0	50	40	0	9	1	0	50
<b>Gjithsej</b>	<b>96</b>	<b>1</b>	<b>220</b>	<b>367</b>	<b>107</b>	<b>791</b>	<b>139</b>	<b>1</b>	<b>278</b>	<b>205</b>	<b>122</b>	<b>745</b>

Burimi: BQK (2018)

Në kuadër të këtyre 17 aplikacioneve, BQK-ja gjatë vitit 2017 ka marrë vendime për miratimin e regjistrimit të IuteCredit Kosova SH.A. si Institucion Mikrofinanciar si dhe janë miratuar regjistrimet e Timi Invest (me veprimtari të kredidhënies dhe lizingut), Bi Credit (me veprimtari të kredidhënies dhe shërbimit të pagesave), Saint Matthew Merchant (me veprimtari të shërbimit të pagesave), Euro Mani SH.P.K., Goni SH.P.K. dhe Arttin SH.P.K (me veprimtari të këmbimit valutor), si Institucione Financiare Jobankare. Janë miratuar licencat për 3 kompani të kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime si: Pro Insurance Broker SH.A. (Kompani Brokerimi) Premium Broker L.L.C (Kompani Brokerimi) dhe NLB Bankës i është miratuar për ndërmjetësim në sigurime si veprimtari shtesë. Pjesa e mbetur e aplikacioneve të shqyrtuara dhe miratuara/refuzuara gjatë vitit 2017 paraqet licencimin e 7 brokerëve individualë si ndërmjetësues në sigurime për policëmbajtësit.

Në procesin licencues, BQK-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit të parimeve dhe rregullave bazë për një drejtim të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave, duke vlerësuar strukturat e tyre organizative, menaxhimin, si dhe ndarjen e përgjegjësisë. Bazuar në rregullativën në fuqi, BQK-ja ka shqyrtuar (miratuar/refuzuar) kërkesat e bankave për 40 anëtarë të rinj të bordeve të drejtorëve, anëtar (ekspert) të jashtëm të Komitetit të auditimit, si dhe menaxherë të lartë. Në radhët e siguruesve, BQK-ja ka (miratuar/refuzuar) 30 anëtar të bordit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të siguruesve. Në të njëjtën kohë, BQK-ja ka shqyrtuar (miratuar/refuzuar) kërkesa të ngjashme edhe për institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare dhe ndërmjetësuesit në sigurime. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 25 anëtarë të bordit të

drejtorëve dhe menaxherë të lartë të institucioneve mikrofinanciare, institucioneve financiare jobankare, si dhe kompanive ndërmjetësuese në sigurime.

Në vitin 2017 janë miratuar edhe dy kërkesa (BPB dhe AGC Faktor) për shitblerjen e aksioneve, si dhe transferimi i aksioneve të KS Kosova e Re SH.A. Gjatë këtij viti gjithashtu janë miratuar 14 kërkesa për ndryshimin e statutit, 4 nga të cilat kanë qenë në radhët e bankave, 4 nga siguruesit, si dhe 4 nga institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare si dhe 2 nga kompanitë ndërmjetësuese në sigurime.

Shqyrtimi i kërkesave për licencim/regjistrim të agjentëve individualë si ndërmjetësues në sigurime, si dhe agjentëve të IFJB-ve është paraqitur në transaksion individual për të evituar hutime të mundshme marrë parasysh numrim shumë të lartë të tyre. Siç edhe shihet në tabelën 12, gjatë vitit 2017 BQK-ja ka miratuar/refuzuar 222 kërkesa të tilla duke e bërë licencimin dhe regjistrimin e agjentëve transaksionin me frekuencën më të lartë. Megjithatë, në krahasim me vitin paraprak kemi një rënie të theksuar të këtij lloji të kërkesës kryesisht marrë parasysh faktin që nga gushti 2017, agjentët e brendshëm të siguruesve më nuk janë subjekt miratimi i BQK-së. Ngjashëm me licencimin dhe regjistrimin e agjentëve edhe tërheqja e licencimit regjistrimit të agjentëve është një kërkesë për miratim me frekuencë të lartë, që tregon për një volatilitet të rrjetit të sistemit financiar në raport me agjentët. Në këtë drejtim, ngjashëm sugjerojnë edhe të dhënat për miratim të hapjeve, zhvendosjeve dhe mbylljeve të degëve dhe zyrave të institucioneve financiare në vend. Gjatë vitit 2017, janë shqyrtuar 182 kërkesa të tilla, kryesisht të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve që në tërësi paraqet një rënie të lehtë nga viti paraprak, mirëpo në raport me llojin e institucioneve kemi dyfishim të numrit të kërkesave të tilla nga bankat dhe gati përgjysmim të numrit të kërkesave të IMF-ve dhe IFJB-ve.

BQK-ja edhe gjatë vitit 2017, ka shqyrtura kërkesat për miratimin e transaksioneve periodike që kërkojnë miratimin e BQK-së sipas kornizës ligjore dhe rregullatorë në fuqi si, miratimet e auditorëve të jashtëm për të gjitha llojet e institucioneve financiare.

Gjithashtu gjatë vitit 2017, BQK-ja ka revokuar licencën/regjistrimin e Këmbimore Beni dhe N.SH. Blujona të regjistruara në BQK si institucione financiare jobankare me veprimtari të këmbimit valutor si dhe Safe Life SH.P.K. e licencuar nga BQK-ja si kompani e agjentëve.

#### **4.7. Ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare**

Përgjegjësia kryesore e Divizionit të ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (tani e tutje divizioni i ankesave) është pranimi, sistemimi dhe shqyrtimi i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare.

Divizioni i ankesave ka për qëllim zbatimin dhe zhvillimin e politikave, praktikave më të mira për shqyrtimin e ankesave, në aspekt të mbrojtjes së konsumatorëve.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi që ka të përcaktuara për funksionin e tij, Divizioni i ankesave ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të parapara me planin vjetor për vitin 2017, ku ka realizuar në pothuajse në tërësi planin vjetor. Edhe gjatë këtij viti, ky Divizion ka pranuar, sistemuar dhe shqyrtuar ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në pajtueshmëri me rregulloren e aprovuar, ku përveç detyrave dhe përgjegjësi të përgjithshme, Divizioni i ankesave ka vazhduar me raportimin e rregullt për komisionin evropian përmes zyrës së integriteteve në BQK. Është raportuar lidhur me aktivitetet për trajtimin e ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në baza tremujore. Po ashtu Divizioni i ankesave ka mbajtur takime me zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), ku është punuar në Projektligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, pasi që edhe BQK-ja ka qenë pjesë e grupit punues. Gjatë vitit 2017, ka kontribuar në realizimin e aktiviteteve si në vijim:

- a) Shqyrtimi i ankesave në baza ditore – divizioni i ankesave ka pranuar, sistemuar dhe shqyrtuar ankesa në baza ditore nga shfrytëzuesit e shërbimeve financiare. Të gjitha ankesat e pranuar janë shqyrtuar me kohë varësisht nga kompleksiteti i tyre. Gjithashtu, procesi i shqyrtimit të ankesave ka ndikuar që të zhvillohet ekzaminim në vend në kuadër të Mbikëqyrjes Financiare tek institucionet financiare, i cili ka rezultuar edhe marrjen e masave administrative ndaj institucioneve financiare, si dhe ka ndikuar në rregullimin e praktikave të ofrimit të shërbimeve/produkteve financiare.
- b) Raporti i ankesave – divizioni i ankesave mirëmban databazën mbi numrin dhe llojin e ankesave të shqyrtuara dhe përgatit raporte mbi to sipas kërkesës. Divizioni gjithashtu ka filluar raportimin e rregullt javor të numrit të ankesave për sektorin dhe institucionet individualisht.
- c) Kontributi në edukimin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit – gjatë vitit 2017, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare Child & Youth Finance International Youth, European Fund for Southeast Europe (EFSE) dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës, ka mbajtur takimin e tretë të Grupit Rajonal të Punës për Edukimin Financiar të të Rinjve dhe Përfshirjen Financiare për Evropën Juglindore, ku pjesëmarrës në të ka qenë edhe stafi i Divizionit të ankesave. Divizioni ka kontribuar edhe në tryezën me titull “Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit” të organizuar nga MTI.

Gjatë vitit 2017 janë shqyrtuar 602 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizikë e juridikë):

a) Gjithsej ankesat për banka komerciale, institucione mikrofinanciare (IMF), institucione financiare jobankre (IFJB) dhe fonde pensionale të adresuara në BQK për vitin 2017 kanë qenë 335, ndërsa ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me çështje të ndryshme që ndërlidhen me kredi (si p.sh. kategorizimi në regjistrin e kredive, parapagimi i kredive, etj.), çështje që ndërlidhen me llogari (si p.sh. bllokimi i llogarisë), si dhe një pjesë e ankesave kanë qenë mbi rritjen e tarifave/provizioneve bankare.

b) Gjithsej ankesat ndaj kompanive të sigurimeve të adresuara në BQK për vitin 2017 kanë qenë 267. Ankesat më të shpeshta kanë të bëjnë me moskompensim të dëmit material dhe jomaterial nga sigurimi i autopërgjegjesisë TPL, mosrespektimi i afateve kohore për pagesë temarrëveshjet jashtëgjyqësore, si dhe moskompensimin e shpenzimeve mjekësore nga sigurimi shëndetësor.

**Tabela 13. Numri i ankesave sipas institucioneve**

Industria financiare	Numri i ankesave sipas viteve			
	2017	2016	2015	2014
Bankat komerciale/IMF, IFJB, fonde pensionale	335	252	221	158
Kompanitë e sigurimeve	267	283	221	195
Total	602	535	442	353

Burimi: BQK (2018)

Në tabelën e mësipërme është i paraqitur numri i ankesave të shqyrtuara nga divizioni i ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare nëpër vite, ndërsa në figurën 50 nga ku vërejmë një trend të theksuar rritës të numrit të ankesave ndër vite.

Në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, kemi rritje prej 13% të gjithsej numrit të ankesave të trajtuara (figura 50). Ankesat ndaj bankave komerciale, IMF-ve, IFJB-ve e fondeve pensionale kanë shënuar rritje prej 33% në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, ndërsa ankesat ndaj kompanive të sigurimeve kanë trend negativ, ku nga figura 50 vërejmë se krahasuar me vitin 2016 gjatë vitit 2017 kemi 6% më pak ankesa.



Rritja e numrit të ankesave të paraqitura nga policëmbajtësit, depozitorët/huamarrësit dhe shfrytëzuesit e të gjitha shërbimeve dhe produkteve të institucioneve financiare të licencuara, rregulluara dhe mbikëqyrura nga BQK-ja mund të shihet qartë edhe në tabelën 14 të paraqitur më poshtë. Kjo rritje reflekton kryesisht vetëdijësimin të shfrytëzuesve financiarë mbi të drejtën e tyre për ushtrimin e ankesës. Në tabelën 14, vërejmë se 37.15% e gjithsej ankesave janë zgjidhur në favor të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare. Sa i përket industrisë, vërehet se 28.66% e ankesave ndaj bankave komerciale, IMF-ve, IFJB-ve e fondeve pensionale janë zgjidhur në favor të palëve, ndërkohë që 47.57% e ankesave ndaj kompanive të sigurimeve janë zgjidhur në favor të palëve. Kryesisht ankesat refuzohen apo nuk zgjidhen në favor të palëve për shkak se nuk kanë bazë ligjore për trajtim.

Figura 50. Numri i ankesave sipas viteve, në përqindje




Tabela 14. Numri i ankesave sipas statusit të zgjidhjes

Industria financiare	Numri i ankesave	Të zgjidhura në favor të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare	Të zgjidhura në favor të institucioneve financiare
Bankat komerciale/IMF, IFJB, fonde pensionale	335	28.66%	71.34%
Kompanitë e sigurimeve	267	47.57%	52.43%
Totali i ankesave	602	37.15%	62.85%

Burimi: BQK (2018)

#### 4.8. Mbikëqyrja bankare

Gjatë vitit 2017 sikurse viteve të kaluara prioritet të caktuar i është dhënë zbatimit të planit vjetor të ekzaminimit të bankave, duke vazhduar me aplikimin e qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Me fokus në ekzaminimin e bankave sipas rrezikut, e cila ka mundur në planifikim të mirë të kohës dhe resurseve njerëzore në ekzaminime. Konform rreziqeve të vlerësuara sipas matricës së rreziqeve dhe monitorimit të performancës së bankave nga BQK-ja janë përcaktuar edhe llojet e ekzaminimit.

Gjatë vitit 2017 janë kryer gjithsej 14 ekzaminime të bankave, prej të cilave 2 ekzaminime të plota dhe 12 ekzaminime të fokusuara, e cila tregon se fokusi kryesor në ekzaminime ka qenë aplikimi i qasjes proaktive ndaj bankave me fokus te rreziqet. Ekzaminimet në vend të bankave janë kryer duke vlerësuar çështjet vijuese si: profilin e rrezikut të bankave, verifikimin e statusit të përmbushjes së rekomandimeve të dala nga ekzaminimet parapraket të BQK-së, si dhe duke dhënë rekomandime përkatëse për implementim. Raportet e ekzaminimit janë përgatitur bazuar në llojet e rreziqeve bankare si: rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit, rreziku i tregut dhe rreziku operacional si dhe aplikimi i sistemit të vlerësimit të deritashëm rangues.

Gjithashtu, ekzaminimet kanë përfshirë edhe vlerësimin e kontroleve të brendshme, pajtueshmërinë me kornizën ligjore në fuqi të BQK-së, respektivisht pajtueshmërinë me rregulloret bankare, praktikat më të mira bankare, vlerësimin e kapitalit, vlerësimin e politikave dhe procedurave, menaxhmentin, fitimet si dhe ekzaminimin e fushës së teknologjisë informative. Edhe gjatë vitit 2017, rreziku kryesor në kuadër të sektorit bankar vazhdon të mbetet rreziku

kreditor. Nga ekzaminimet, rezulton se bankat janë të shëndosha dhe stabile, si dhe përgjithësisht kanë qenë në pajtueshmëri me kornizën ligjore të BQK-së.

Gjatë vitit 2017 sektori bankar ka vazhduar me zhvillimin e mëtejshëm të kanaleve elektronike të ofrimit të shërbimeve të klientëve, të cilat janë duke vazhduar të shoqërohen me një shkallë në rritje të ekspozimit të tyre ndaj rrezikut operacional.

Bankat janë duke respektuar kërkesat e rregullatorit të cilat janë të përcaktuara me Rregulloren mbi Menaxhimin e Rrezikut Operacional, duke u orientuar në zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve të tyre për menaxhimin sa më të mirë të rrezikut operacional, e cila tregon për vetëdijësim në rritje për këtë rrezik.

Gjatë vitit 2017 gjatë ekzaminimeve në banka, konform objektivave të ekzaminimit është ekzaminuar edhe fusha e rrezikut operacional në banka, duke u fokusuar në vlerësimin e këtij rreziku, mënyrën e menaxhimit, statusin e përmbushjes së rekomandimeve nga ekzaminimet paraprake të BQK-së, si dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për implementim. Nga ekzaminimet ka rezultuar se bankat kanë marrë masa për adresim të rekomandimeve të ekzaminimit paraprak dhe në drejtim të zvogëlimit të rrezikut operacional.

Gjatë ekzaminimeve në banka është ekzaminuar edhe fusha e teknologjisë informative, duke u fokusuar në vlerësimin e rrezikut të bankës në këtë fushë, sigurinë e përgjithshme të sistemeve të teknologjisë informative, si dhe krijimit dhe plotësimit të masave të sigurisë së sistemeve të teknologjisë informative, statusit të përmbushjes së rekomandimeve nga ekzaminimet paraprake të BQK-së për këtë fushë. Bazuar në vlerësimet e ekzaminimit për këtë fushë janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse për implementim.

#### **4.9. Mbikëqyrja në vend e sigurimeve**

Në përputhje me objektivat e BQK-së, respektivisht sigurimit të qëndrueshmërisë së tregut të sigurimeve dhe mbrojtjes e policëmbajtësve, BQK-ja edhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar aktivitetin e saj duke realizuar në vazhdimësi ekzaminime në vend të siguruesve. Rrjedhimisht janë realizuar ekzaminime të plota dhe të fokusuara, si dhe ekzaminime ad-hoc për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve. Qëllim i ekzaminimeve ishte vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të institucioneve përkatëse në raport me pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, në funksion të mbrojtjes së policë mbajtësve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të institucioneve.

Klasifikimi i siguruesve për të qenë subjekt i ekzaminimeve është bazuar në disa faktorë duke filluar nga analizat e treguesve financiarë nga raportimet e rregullta në BQK, opinionit të pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm, periudhave paraprake të ekzaminimeve të realizuara, ankesave të policëmbajtësve në BQK, si dhe faktorë tjerë relevantë. Kjo ka ndikuar në aplikimin e qasjes selektive në prioritizimin e institucioneve më me risk për të qenë subjekt i ekzaminimeve të radhës nga BQK-ja dhe si rrjedhojë në ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes efektive.

Si rrjedhojë, për vitin 2017 janë realizuar gjithsej 16 ekzaminime ku tetë prej tyre kanë qenë ekzaminime të plota, si dhe tetë tjera ekzaminime të fokusuara.

Qëllimi i ekzaminimeve të plota ka qenë vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të siguruesve, duke përfshirë vlerësimin e efektshmërisë së funksionimit të kontrolleve të brendshme, zbatimin e rekomandimeve nga ekzaminimet e kaluara, pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, vlerësimin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së kompanive nga organet drejtuese, praktikrat e siguruesve, vlerësimin e politikave dhe procedurave për menaxhimin e rreziqeve, të gjitha këto në funksion të mbrojtjes së policëmbajtësve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të siguruesve.

Në anën tjetër, tetë ekzaminimet e fokusuara kanë rezultuar nga ndryshimet ligjore dhe rregullative mbikëqyrëse, të cilat u realizuan me fokus vlerësimin e implementimit të Rregullos



për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe menaxhimin e shpenzimeve të siguruesve, e cila ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017.

Ekzaminimet në vend të siguruesve në disa raste kanë evidentuar mospajtueshmëri me kornizën ligjore të BQK-së si dhe praktika jo të shëndosha si: mungesë e rolit aktiv qeverisës të bordit drejtues të siguruesve, mungesë e sistemit efektiv të kontrolleve të brendshme, nivel i dobët i auditimit të brendshëm, vonesa në trajtimin dhe pagesën e dëmeve si dhe numër të lartë të dëmeve pezull, mosrespektim i standardeve ndërkombëtare për disa pozicione të pasqyrave financiare, praktika jo të mira dhe të shëndosha të menaxhimit të mjeteve të kompanisë, dobësi dhe praktika jo të mira të transaksioneve me palë të ndërlidhura, nënvlerësim i rezervave teknike etj. Po ashtu, bazuar në raportimet e rregullta të siguruesve në BQK, janë evidentuar raste të mosrespektimit të kërkesave ligjore në raport me nivelin minimal të kapitalit dhe asetëve në mbulim të provizioneve teknike.

Për të gjitha ekzaminimet janë përgatitur raportet, në të cilat janë ngritur dhe adresuar çështje të evidentuara gjatë ekzaminimit, së bashku me rekomandimet përkatëse. Kompanitë në fjalë vazhdojnë të raportojnë në baza mujore në BQK për marrjen e veprimeve të nevojshme për eliminimin/përmirësimin e mangësive të evidentuara në raportet e ekzaminimit të BQK-së.

Po ashtu, si rezultat i të gjeturave nga ekzaminimet e realizuara dhe performancës jo të mirë financiare, janë lëshuar vendime nga BQK-ja në të cilat janë shqiptuar masa administrative sipas legjislacionit në fuqi.

#### **4.10. Mbikëqyrja e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare**

Mbikëqyrja e realizuar në institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare ka pasur në fokus ngritjen e përgjegjësisë së institucioneve të tilla në zbatimin e praktikave adekuate të operimit. Në këtë drejtim gjatë vitit 2017 është vazhduar performimi i një mbikëqyrje ku objektivi i ekzaminimeve kryesisht ka qenë vlerësimi i menaxhimit të riskut, pajtueshmëria me legjislacionin e BQK-së dhe politikat e brendshme të tyre, si dhe statusi i përmbushjes së rekomandimeve nga ekzaminimet paraprake të BQK-së, duke u dhënë kështu edhe rekomandime përkatëse për implementim.

Gjithashtu, gjatë ekzaminimeve në institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare është ekzaminuar edhe fusha e teknologjisë informative, duke vlerësuar rrezikun në fushën e teknologjisë informative, ku fokus i veçantë i është kushtuar sigurisë së përgjithshme të sistemeve të teknologjisë informative, si dhe krijimit dhe plotësimit të masave të sigurisë së sistemeve të teknologjisë informative.

Bazuar në hapësirën e caktuar të dhënë ndaj ekzaminimit të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare gjatë periudhës së vitit 2017 janë ekzaminuar tetë (8) institucione, respektivisht gjashtë (6) prej tyre institucione financiare jobankare dhe dy (2) dhe institucione mikrofinanciare ku disa prej tyre janë shoqëruar edhe me vendime për masa administrative. Përveç realizimit të ekzaminimeve të plota të cekura më lartë, po ashtu janë kryer ekzaminime të fokusuara në tridhjetë e dy zyra të këmbimit valuator. Si rrjedhojë e ekzaminimit në zyret e këmbimit të valutave është proceduar për tërheqje të regjistrimit për dy zyra të këmbimit valuator.

Për më tepër, si rrjedhojë e ekzaminimit në vend një institution financiar jobankar ka shtuar kapitalin e tij dhe si i tillë ka rezultuar që të arrijë të jetë në pajtueshmëri me rregullativën e BQK-së në fuqi.

Nga ekzaminimet përkatëse të realizuar në institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, përgjithësisht është evidentuar se institucionet e tilla kanë arritur avancim në zbatimin e rregullativës në fuqi, si dhe dhe fuqizimin e menaxhimit e rriskut.

Rrjedhimisht, reflektimet pozitive në pozicionin e tyre konform rregullativës në fuqi si dhe avancimet e tjera të theksuara më lartë lidhur me industrinë mikrofinanciare dhe jobankare tregojnë për hapat e sukseseve karshi mbikëqyrjes adekuate dhe qasjes proaktive të BQK-së.

#### **4.11. Mbikëqyrja e pensioneve dhe tregut të letrave me vlerë**

Sistemi pensional gjatë vitit 2017 vazhdon të ketë numrin e njëjtë të operatorëve. Në industrinë e pensioneve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde pensione, të cilat administrojnë mjetet pensione, përkatësisht Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës me mandat ekskluziv për të administruar kontributet pensione të detyrueshme (shtyllën e dytë), si dhe Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve, i licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për të administruar vetëm fondet e pensionit vullnetar (shtyllën e tretë).

Sistemi pensional në Kosovë vazhdoi të rritet edhe gjatë vitit 2017, duke ruajtur qëndrueshmërinë e komponentëve përbërës, sigurinë e kursimeve pensione, diversitetin e investimeve, kthimin pozitiv të investimeve dhe ruajtjen e likuiditetit.

Gjithsej mjetet e sistemit pensional në vitin 2017 arritën në vlerë prej 1,653 milion euro apo 16 % rritje krahasuar me vitin 2016. Rritja e mjeteve i atribuohet kryesisht rritjes së çmimit të njësisë në tregjet globale gjatë vitit 2017. Në rritjen e mjeteve të sektorit pensional në vitin 2017, kontribut kryesor ka dhënë FKPK-ja me 1,646 milion euro ose 99.56%, pasuar nga FSKP-ja me 7,325 mijë euro ose 0.44 % të gjithsej mjeteve të sistemit pensional.

Kontributet e detyrueshme përkatësisht mjetet pensione të shtyllës së dytë, mbeten burim kryesor i financimit në sektorin e pensioneve. Për më tepër kontributet e detyrueshme janë nën menaxhimin ekskluziv të FKPK-së, të cilat përbëjnë 99.56% të gjithsej detyrimeve të sektorit pensional, i pasuar nga FSKP-ja me 0.44% të gjithsej detyrimeve të sektorit pensional, me kontributet e fondeve vullnetare, përkatësisht shtyllës së tretë.

Kthimi bruto i investimeve në sektorin pensional gjatë vitit 2017 i atribuohet FKPK-së me 102,558 mijë euro, pasuar nga FSKP-ja me 535 mijë euro.

Rolin kryesor në këtë performancë të investimeve të FKPK-së dhe FSKP-ës e patën investimet në tregun financiar jashtë Kosovës, duke kontribuar në pjesën dërrmuese edhe në totalin e kthimit nga investimet.

##### **4.11.1 Mjetet pensione të fondeve pensione**

###### **4.11.1.1 Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës**

Mjetet pensione nën menaxhimin e FKPK-së, deri në fund të vitit 2017 arrijnë në vlerë prej 1,646 milion euro. Mjetet nën menaxhimin gjatë vitit 2017 janë rritur për 227 milionë euro apo 16 %, derisa në vitin paraprak mjetet nën menaxhim janë rritur për 189 milion euro. Vlen të theksohet fakti që prej themelimit të FKPK-së e deri në fund të vitit 2017 mjetet pensione patën një rritje të qëndrueshme.

Gjatë periudhës trembëdhjetë vjeçare, rritje me e theksuar u evidentua ndërmjet periudhës 2014-2017 në shumë prej 558 milionë euro, e pasur nga periudha 2010-2013 në shumën prej 418 milionë euro, përderisa periudha paraprake 2006-2009 shënoi rritje prej 166 milion euro.

#### 4.11.1.2. Performanca e kthimit të investimeve nën menaxhimin e FKPK-së

Performanca e investimeve për mjetet pensionale nën menaxhimin e FKPK-së, prej themelimit e deri në vitin 2017 konsiderohet përformancë optimale e kthimit të investimeve, e cila është realizuar kryesisht prej ekspozimit ndaj tregut të aksioneve në vendet e zhvilluara. Performanca e mirë e tregjeve globale financiare dhe investimet në tregun e letrave me vlerë në Kosovë, në tri vitet e fundit ka mundësuar kthim të investimeve bruto në shumë prej 197 milion euro.

Vlera e çmimit të njësisë së FKPK-së, me 31 dhjetor 2017 arriti në 1.4648 euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.48% në krahasim me vitin paraprak.

#### 4.11.2 Fondi Silloveno-Kosovar i Pensioneve


Mjetet pensionale nën menaxhimin e FSKP-së prej themelimit e deri në vitin 2017 arrijnë në vlerë prej 7,326 mijë euro.

Për gjatë zhvillimit të periudhës nëntë vjeçare rritje më e theksuar ishte ndërmjet periudhës 2010-2013 në shumë prej 2,087 mijë euro, e pasur nga periodha 2014-2017 në shumën prej 1,839 mijë euro.

##### 4.11.2.1 Përformanca e kthimit të investimeve nën menaxhimin e FSKP-së


Performanca e investimeve për mjetet pensionale nën menaxhimin e FSKP-së, prej themelimit e deri në vitin 2017 vlerësohet të jetë përformancë e mirë e kthimit të investimeve, e cila është realizuar kryesisht prej investimeve në tregjet globale financiare. Performanca e tregjeve globale financiare të kthimit bruto nga investimeve në vitin 2017 ishte në shumë 713 mijë euro.

Figura 51. Mjetet nën menaxhim të FKPK-së, në milionë euro




Burimi: BQK (2018)

Figura 52. Çmimi dhe mesatarja e çmimeve për aksion të FKPK-së



Burimi: BQK (2018)

Figura 53. Mjetet nën menaxhim të FSKP-së, në mija euro



Burimi: BQK (2018)

Vlera e çmimit të njësisë së FSPK-së, me 31 dhjetor 2017 arriti në 1.65 euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.5%.

#### 4.11.3 Kontributet e arkëtuara dhe llogaritë e kontribuuesve në sistemin pensional

Kontributet e arkëtuara dhe llogaritë e kontribuuesve në industrinë e pensioneve vazhduan të rriten me një përqindje mjaft të kënaqshme.

Gjatë vitit 2017 kontributet e arkëtuara arritën shumë prej 161 milion euro, krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar rritje për 8 milion apo 5.5 %. Kontribut kryesor në rritjen e kontributeve pensionale të arkëtuara ka dhënë FKPK-ja me 160 milionë euro apo 99.5%, pasuar nga FSKP-ja me 0.5 %.

Mjetet pensionale neto nën menaxhimin e fondeve pensionale që operojnë në tregun e Kosovës më datën 31 dhjetor 2017 arrijnë në vlerë prej 1,653 milionë euro, duke shënuar rritje prej 227 milion euro, 16 %. Përderisa numri i kontribuuesve gjatë vitit 2017 arriti në 595 mijë kontribuues, që paraqet një rritje prej 9.1 % krahasuar me vitin paraprak.

Struktura e mjeteve pensionale të shpërndara sipas grup moshave të kontribuuesve pensional konsiderohet mjaft e favorshme për zhvillimin e politikës investuese në periudhën afatgjatë.

Më datën 31 dhjetor 2017, pjesëmarrja e kontribuuesve sipas moshës, në mjetet neto përfaqësohen si në vijim: grupë-mosha deri në 25 vjet përfaqëson shumë prej 23 milionë euro apo 1.4%, e pasuar nga grupë-mosha prej 25-34 vite, që arrin shumë prej 273 milionë euro apo 16.7%, deri sa grup-mosha prej 35-44 përfaqëson shumë prej 510 milionë euro apo 31%, grupë-mosha 45-57 arrijnë vlerën 450 milionë euro apo 27.5%, deri sa grupe-mosha 55-64 përfaqëson shumë prej 375 milionë euro apo 23%, deri sa grupë-mosha mbi 65 vjet përfaqëson shumë prej 7 milionë euro. Shpërndarja sipas grup-moshave pasqyron një strukturë të mirë duke reflektuar shumanshëm në ngritjen e kapaciteteve të të gjitha palëve të interesit nga këto mjete financiare.

#### 4.11.4 Struktura e Investimit të Mjeteve Pensionale në Sektorin Pensional

Investimet jashtë vendit dominojnë strukturën e mjeteve në sektorin pensional. Më datën 31 dhjetor 2017, investimet jashtë vendit kishin një pjesëmarrje prej 89.79 % në gjithsej mjetet. Pjesa e mbetur përbëhet nga investimet në bonot e Thesarit të Qeverisë së Kosovës me pjesëmarrje prej 8.88 % të gjithsej mjeteve, si dhe nga paraja në BQK dhe banka komerciale, me pjesëmarrje prej 0.84 % të gjithsej mjeteve të sektorit pensional.

Mjetet pensionale të investuara në Kosovë dominohen nga investimet në instrumentet e emetuara nga Thesari i Republikës së Kosovës.

Figura 54. Çmimi dhe mesatarja e çmimeve për aksion të FSKP-së





Figura 55. Pjesëmarrja e kontribuuesve sipas moshës, në mjetet neto



Pjesëmarrja e Fondeve Pensionale në tregun e Letrave me Vlerë të Qeverisë, sipas gjendjes më 31 dhjetor 2017 ku pjesëmarrja e FKPK në Letra me Vlerë të Qeverisë ishte me shumë nominale prej 103,130 mijë euro, apo 17.94% , deri sa pjesëmarrjen FSKP ishte 970 mijë euro apo 0.16%.

#### 4.11.5 Strategjia Investuese e Sektorit Pensional

Fondet pensionale gjatë vitit 2017 kanë zhvilluar procesin e investimeve në harmoni dhe zbatim të plotë të dispozitave të ligjit, me qëllim të maksimizimit të kthimit nga investimet, dhe në të mirë të kontribuuesve dhe përfituesve.

Në kuadër të industrisë së pensioneve, investimet e kursimeve pensionale janë realizuar duke u mbështetur mbi parimet bazë të sigurimit të mjeteve pensionale, diversifikimit të investimeve, ruajtjen e kthimit maksimal për nivelin e ndërmarrë të rrezikut, si dhe ruajtja e likuiditetit të mjaftueshëm.

Vlen të theksohet fakti se FKPK në zbatimin e politikës/strategjisë diversifikuese ka shtuar fonde të reja investuese. Strategjia investuese përmes kornizës së re ka aplikuar përcaktimin e limiteve/kufijve minimal dhe maksimal, që përkufizon kufijtë e ndarjes së mjeteve sipas klasave dhe strategjisë investuese të mjeteve pensionale nën administrimin e FKPK-së.


**Tabela 15. Kufijtë e alokimit të mjeteve pensionale të FKPK-së**

Limitet e alokimit sipas strategjisë Investuese		Limitet e alokimit sipas klasave Investuese	
Drejtimoret	24%-60%	Aksione	27%- 56%
Risk i menaxhuar	32%-68%	Multi-asete	25%- 55%
Të hyrat	10% - 25%	Instrumente Borxhi (Bono Kredi)	7% - 34%
		Tregu i Parasë dhe Thesari i Kosovës	1% - 12%


Burimi: BQK (2018)

Sfidë e rëndësishme e strategjisë investuese mbetet vlerësimi i hapësirave për më tepër rritje/rënie të riskut investues, duke përcaktuar limitet e investimeve në strategjinë “risk i menaxhuar” dhe strategjinë e “kthimit/dividendit”, përkatësisht investim me rrezik të lartë.

**Grafik 56. Struktura e investimit të mjeteve pensionale**



**Figura 57. Alokimi i mjeteve sipas aset menaxherëve, në milionë euro**



Përderisa Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve të gjitha mjetet pensionale i ka të investuara përmes një fondi investues.

#### 4.11.6 Ekzaminimet në vend (on-site) të fondeve pensionale

Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë të sektorit financiar, gjatë vitit 2017 janë zhvilluar ekzaminimet e plota të fondeve pensionale sipas planit vjetor. Mbikëqyrja e pensioneve ka qenë konsistent me praktikat ndërkombëtare në fushën përkatëse, duke e mbështetur qasjen e bazuar në rrezik, vëmendje e theksuar i është kushtuar qeverisjes së fondeve, strategjisë së investimeve, efektivitetit të kontrolleve të brendshme, ruajtjes së likuiditetit adekuat dhe rreziqeve tjera.

Mbikëqyrja e pensioneve gjatë vitit 2017, ka kryer 2 ekzaminime të plota në fondet pensionale, me qëllim të aplikimit të mbikëqyrjes më të përafërt të fondeve. Ekzaminimet në vend të fondeve janë realizuar në harmoni me planin vjetor të vitit 2017, duke pasur për qëllim vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të fondeve pensionale, përkatësisht vlerësimin e qeverisjes së fondeve, politikat dhe procedurat, menaxhmentin, performancën e investimeve, efektshmerinë e funksionimit të kontrolleve të brendshme, zbatimin e rekomandimeve nga ekzaminimet e kaluara, si dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së.

Gjithashtu, ekzaminimet në vend kanë përfshirë edhe vlerësimin e kontrolleve të brendshme, pajtueshmërinë me kornizën ligjore në fuqi të BQK-së, respektivisht pajtueshmërinë me rregulloret e fondeve pensionale, vlerësimin e politikave dhe procedurave, menaxhmentin, performanca e mjeteve pensionale si dhe ekzaminimin e fushës së teknologjisë informative.

Gjatë ekzaminimeve të fondeve pensionale është zhvilluar edhe ekzaminimi i fushës së teknologjisë informative, duke u fokusuar në vlerësimin e rrezikut të fondeve në këtë fushë, sigurinë e përgjithshme të sistemeve të teknologjisë informative, si dhe krijimit dhe plotësimit të masave të sigurisë së sistemeve të teknologjisë informative. Bazuar në vlerësimet e ekzaminimit për këtë fushë janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse për implementim.

Për të gjitha ekzaminimet janë përgatitur raportet, në të cilat janë ngritur dhe adresuar çështje të evidentuara gjatë ekzaminimit, së bashku me rekomandimet përkatëse.

#### 4.11.7 Zhvillimi i kornizës ligjore-rregullative

Me qëllim të avancimit të kornizës ligjore në sferën e sistemit pensional, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka përforcuar më tej kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse. Në këtë drejtim, janë finalizuar dhe aprovuar rregullore të caktuara për mbikëqyrjen e fondeve pensionale, të cilat kanë rregulluar mbikëqyrjen e funksioneve përkatëse, si dhe janë plotësuar kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, të cilat kanë rrjedh nga amendamenti i fundit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017 ka hyrë në fuqi "Ligji nr. 05/L -116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 3 / 17 janar 2017."

#### 4.11.8 Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun në sistemin pensional

Sistemi i Pensioneve në Kosovë sa i përket transparencës ndaj publikut zhvillon një proces të mirëfilltë informativ, të përcjella me azhurnime kohore. Gjatë vitit 2017, industria e pensioneve ka vazhduar me transparencën dhe marrëdhëniet me publikun.

Në harmoni me Ligjin për Fondet Pensionale të Kosovës dhe rregulloret e BQK-së, operatorët pensionalë publikojnë/ofrojnë qasje publike në informatat kyçe në operacionet e fondeve pensionale për publikun. Kontribuuesit dhe publiku i gjerë, në baza tremujore informohen përmes raporteve

tremujore të publikuara lidhur me pasqyrën e fundit rreth investimeve për tremujorin e mbuluar, informata lidhur me çmimin e aksionit dhe informatat lidhur me mjetet nënmenaxhim.

Për më tepër, kontribuuesit në çdo kohë mund të qasen on-line në llogarinë e kursimeve pensionale përmes ueb-faqeve përkatëse, të shikojnë bilancin e llogarisë, informohen mbi kontributet që janë paguar në emër të saj/tij, të përditësojnë shënimet e kontaktit si p.sh. statusin martesor, etninë, të përditësojnë shënimet demografike si p.sh. adresën, numrin e telefonit, përzgjedh metodën e pranimit të pasqyrës individuale, si dhe shërbime dhe informata të tjera.

Informatat ofrohen në gjuhët zyrtare sipas Kushtetutës së Kosovës, që mundëson qasje të lehtë edhe për komunitetet jo shumicë.

#### **4.11.9 Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare**

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS). BQK-ja në vazhdimësi mbështet stafin në pjesëmarrjen e aktiviteteve të organizuara nga Organizata Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve. Pjesëmarrja në këto aktivitete konsiston në zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit me organizatat tjera relevante dhe autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve, duke shkëmbyer përvojat dhe njohuritë profesionale gjatë pjesëmarrjes në konferenca dhe seminare, të organizuara nga IOPS-i.

#### **4.12. Parandalimi i pastrimit të parave**

Raporti vjetor për vitin 2017 paraqet gjendjen e sektorit, respektivisht bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare dhe masat e ndërmarra në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Divizioni i Parandalimit të Pastrimit të Parave (PPP) për funksionimin dhe kryerjen e aktiviteteve në përmbushjen e mandatit të tij funksional gjatë vitit 2017, pikë referuese të ushtrimit të aktivitetit kishte Planin strategjik të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, planin vjetor të mbikëqyrjes financiare, planin vjetor dhe strategjinë dhe planin e veprimit të Divizionit për parandalimin e pastrimit të parave.

Meqenëse tanimë ligji i ri për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe rregullorja janë në fuqi, për implementimin sa më efektiv të tyre në praktikë, është parë e nevojshme analizimi i nevojës për nxjerrjen e akteve udhëzuese nga ana e Divizionit. Pas finalizimit të Rregullores për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, gjatë vitit 2017 janë draftuar edhe dy akte tjera nënligjore, përkatësisht dy udhëzime: 1) Udhëzimi në lidhje me plotësimin e deklaratimit të prejardhjes së fondeve dhe 2) Udhëzimi mbi identifikimin e pronarëve përfitues.

Divizioni ka arritur gjatë vitit 2017 ta bëjë adaptimin në mënyrë teknike me sistemet e pagesave që menaxhohen nga ana e Bankës Qendrore, ku përmes këtij aktiviteti është krijuar platformë dhe bazë e të dhënave nga ana e divizionit duke gjeneruar, analizuar dhe monitoruar sipas nevojës kategori të caktuara të transaksioneve të vlerësuara me rrezik potencial.

Realizimi i këtij objekti ka implikuar rritje të bashkëpunimit me divizione dhe departamente tjera jashtë funksionit të mbikëqyrjes financiare, si dhe adoptim të sistemeve të teknologjisë informative.

##### **14.12.1 Mbikëqyrja e institucioneve financiare nga prizmi i PPP-së**

Mbikëqyrja në vend e institucioneve financiare, është fokusuar në aspektin e mbrojtjes së sistemeve të tyre, nëpërmjet zbatimit të standardeve dhe legjislacionit për parandalimin dhe



luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Fokusi kryesor i Divizionit brenda kësaj periudhe raportuese ishte që të kryejë ekzaminimin e bankave dhe institucioneve financiare në fushën PPP/FT. Këto aktivitete janë paraparë edhe pa planin strategjik të Divizionit dhe qëllimi kryesor ishte marrja e informacioneve në vend në lidhje me nivelin e masave që institucionet financiare kanë ndërmarrë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjatë vitit 2017 janë realizuar gjithsej 10 ekzaminime në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. Ekzaminimet kanë përfshirë bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Në këtë drejtim, janë realizuar ekzaminime në 6 banka, 2 institucione mikrofinanciare dhe 2 institucione financiare jobankare (IFJB).

Në saje të realizimit të një numri të konsiderueshëm të ekzaminimeve, këtë vit është intensifikuar përcjellja e rekomandimeve dhe përmbyllja e tyre nga ana e institucioneve financiare të ekzaminuara. Përcjellja e rekomandimeve dhe masave u evidentua përmes formave të vlerësimit (tabelave), ku ishin pjesë integrale e aktivitetit pasues të secilit ekzaminim. Në këtë drejtim brenda vitit 2017, Divizioni pranoi 20 informata kthyese nga ana e institucioneve financiare, ku 13 prej tyre ishin nga bankat dhe të tjerat nga institucionet mikrofinanciare dhe ato financiare jobankare. Në analizimin e përmbajtjes së këtyre informatave kthyese, fokusi vërehet tek struktura dhe emërimi i zyrtarëve të pajtueshmërisë, meqë kjo ishte edhe kërkesë e re ligjore dha bankat ndërmorën më së shumti hapa në këtë drejtim.

Pika kyçe të vlerësimit gjatë ekzaminimeve të caktuara në institucione financiare, ishin obligimet dhe përgjegjësitë ligjore dhe rregullative të institucioneve financiare, me qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të aktiviteteve terroriste sipas standardeve dhe praktikave më të mira të fushës. Bankat kanë hartuar politika dhe procedura që krijojnë mundësi për masa efektive në PPP/FT. Bankat në pronësi të huaj, këto politika dhe procedura i kanë krijuar edhe me ndihmën e bankave amë, të cilat janë miratuar nga bordi drejtues. Institucionet financiare të ekzaminuara kanë vazhduar të ndërmarrin masa në drejtim të shtimit të kapaciteteve humane dhe teknike brenda institucionit, duke rekrutuar personel të posaçëm për pajtueshmëri me PPP/FT dhe duke e pavarësuar në masë të konsiderueshme nga funksioni i kontrollit të brendshëm. Masat e ndërmarra dhe aktivitetet, këtë vit divizioni i ka pranuar në mënyrë proaktive nga bankat në baza të vazhdueshme.

Poashtu, institucionet financiare kanë ndërmarrë masa të konsiderueshme në drejtim të rritjes së efikasitetit të monitorimit, procedurës së identifikimit të klientëve dhe hapjes së llogarive të reja dhe përcaktimit të pronarit përfitues.

#### **14.12.2 Bashkëpunimi i brendshëm dhe i jashtëm**

Përveç aktivitetit të brendshëm në drejtim të fuqizimit të mbikëqyrjes së PPP/FT në sektorin financiar, Divizioni ka zhvilluar edhe aktivitete bashkëpunimi me autoritete dhe institucione të tjera jashtë BQK-së. Bashkëpunimi ndërinstytucional është edhe njëra ndër objektivat strategjike të planit vjetor të Divizionit dhe Mbikëqyrjes Financiare, ku brenda kësaj periudhe janë shënuar aktivitete të ndryshme.

Bashkëpunim i veçantë ndërinstytucional theksohet me Njësinë për Inteligjencë Financiare, në drejtim të hartimit të akteve të ndryshme nënligjore në fushën e PPP/FT dhe në aspekt të shkëmbimit të informacioneve me interes, në pajtim me marrëveshjen për bashkëpunim dypalësh në fuqi. Divizioni i PPP-së ka përfaqësuar BQK-në edhe në projekte të ndryshme, sa i përket prezantimit të të arriturave në drejtim të fuqizimit të mbikëqyrjes së PPP/FT. Në këtë drejtim Divizioni i PPP-së ka raportuar në baza tremujore te Koordinatori Nacional kundër Krimin Ekonomik dhe te Sekretariati i Strategjisë Kombëtare kundër krimin të organizuar.



Divizioni për parandalimin e pastrimit të parave ishte edhe pjesë aktive në projektin e financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, “Projekti Kundër Krimin Ekonomik”, në të cilin në bashkëpunim me institucione tjera të zbatimit të ligjit si Policia e Kosovës, Njësia për Inteligjencë Financiare, Prokuroria, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës etj., ka ofruar inputin e vet në mënyrë të vazhdueshme sa herë është kërkuar.


## 5. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

### 5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është kompetente për sigurimin e një furnizimi të duhur të ekonomisë vendore me kartëmonedha dhe monedha euro. Këtë funksion BQK-ja e kryen në mënyrë indirekte përmes sektorit bankar i cili është drejtpërdrejt i lidhur me bizneset dhe qytetaret. Përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme gjatë vitit 2017 sikurse edhe në vitet paraprake kishin të bënin me euron si valuta që përdoret zyrtarisht në Kosovë.


Gjatë vitit 2017 BQK-ja siguroi një ofertë kualitative dhe kuantitative të kartëmonedhave dhe monedhave euro për sektorin bankar me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme të ekonomisë dhe qytetarëve. Si rrjedhojë, funksioni për sigurimin e një furnizimi të duhur me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi është përmbushur në mënyrë të suksesshme nga ana e BQK-së.

Figura 58. Furnizimi me para të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Figura 59. Pranimi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2017, shënoi një rritje prej 13.6 përqind krahasuar me vitin 2016. Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk patën ndonjë ndryshim të dukshëm nga viti 2016 në vitin 2017. Te kartëmonedhat euro vëllimet e kërkesave për furnizim gjatë vitit 2017 shënuan një rritje prej rreth 2.8 përqind krahasuar me vitin 2016 dhe vazhduan të dominojnë kërkesat për furnizime me denominimet – 5, 10, 20, 50 dhe 100 euro, ndërsa kërkesat për vëllimet e denominimeve prej 200 dhe 500 euro mbeten dukshëm më të ulëta. Gjatë vitit 2017 kërkesa për vëllimet e denominimeve në vlerë prej 100 euro patën rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë kurse kërkesa për vëllimet e denominimit në vlerë prej 50 euro kishte një rënie të lehtë.

Siç është paraqitur në figurat e mëposhtme, gjatë vitit 2017, BQK-ja e furnizoi sektorin bankar më afër 10.8 milionë copë kartëmonedha euro (në vlerë prej afër 425 milionë euro) dhe me mbi 5 milionë copë monedha euro (në vlerë prej afër 1.1 milion euro).

Vëllimet e kërkesave për furnizim me monedha gjatë vitit 2017 shënuan një rritje prej rreth 5.4 përqind krahasuar me vitin 2016. Kërkesa për furnizim me monedha euro, njëjtë sikurse gjatë vitit 2016, në vitin 2017 kryesisht u dominua nga monedhat me vlerë të vogël nga 1 euro cent deri në 5 euro cent. Vëllimet e kërkesave për furnizim me denominime të ulëta në vlerë prej 5 euro cent, 2 euro cent dhe 1 euro cent gjatë vitit 2017 shënuan një rënie grupore prej rreth 12.6 përqind kurse kërkesat për furnizim me denominimet prej 1 euro, 50 euro cent, 20 euro cent dhe 10 euro cent shënuan një rritje grupore prej rreth 86.8 përqind që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë.

Figura 60. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)





Figura 61. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje prej 17.9 përqind në vitin 2017 krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi afër 16.3 milionë copë kartëmonedha (mesatarisht rreth 65,000 copë kartëmonedha në ditë) dhe afër 2.6 milionë copë monedha euro (mesatarisht rreth 10,000 copë monedha në ditë) si depozita në para të gatshme nga sektori bankar. Të shprehura në vlerë, depozitat e parave të gatshme arritën përafërsisht shumat prej 987.9 milionë kartëmonedha euro dhe 1.7 milion monedha euro përkatësisht. Vëllimet e kartëmonedhave të pranuar gjatë vitit 2017 shënuan një rritje prej rreth 14.8 përqind krahasuar me vitin 2016 kurse vëllimet e depozitave të monedhave shënuan një rritje prej rreth 178.6 përqind krahasuar me vitin 2016. Struktura e kartëmonedhave euro të pranuar gjatë vitit 2017 siç shihet në grafikun e mëposhtëm nuk pati ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak përderisa struktura e monedhave të pranuar gjatë vitit 2017 shënoi rritje tek prerjet e monedhave prej 20 cent krahasuar me vitin e kaluar.

Figura 62. Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)





Figura 63. Monedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)



Ngjashëm me vitet e kaluara edhe gjatë vitit 2017, paratë e gatshme neto<sup>12</sup> të pranuar ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 567.7 milionë euro, ndryshimi i tillë ishte në një masë më të lartë se sa në vitin e mëhershëm që ishte rreth 468 milionë euro. Kjo rritje ishte kryesisht si rezultat i rritjes së depozitimeve nga sektori bankar.


Meqë BQK-ja mban vetëm nivelin optimal të nevojshëm të parave të gatshme për kryerjen e operacioneve, tepriat dërgohen në eurozonë, ku më pastaj përdoren për kryerjen e pagesave ndërkombëtare si dhe përmes investimeve kthehen në mjete interes-prurëse. Neto dërgesat<sup>13</sup> jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2017 arritën shumën prej 529.8 milionë euro duke qenë më të lartë për 61.6 përqind se sa një vit më herët kur ishin 327.8 milionë euro. Kjo rritje neto e

<sup>12</sup> Depozitat minus tërheqjet e parave të gatshme.

<sup>13</sup> Importet minus eksportet e parave të gatshme


dërgesave në vitin 2017 erdhi si rrjedhojë e rritjes së rritjes së depozitimeve nga sektori bankar. Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy figurat në vijim.

Figura 64. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Figura 65. Importi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro




Burimi: BQK (2018)

Operacionet me para të gatshme vijuan të kryhen përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat standarde. Të gjitha paratë e gatshme të pranuar nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera u procesuan (afër 16.3 milionë copë kartëmonedha euro dhe 2.6 milionë copë monedha euro) dhe u klasifikuan sipas shkallës së përshtatshmërisë.


Rreth 4.9 milionë copë kartëmonedha euro (30.1 përqind e numrit të përgjithshëm kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar) gjatë vitit 2017 u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim (tejet të vjetërsuara/dëmtuara) dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e Eurozonës. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të papërshtatshme të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës. Ngjashëm me vitet e kaluara, kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim, ishin ato të denominimeve 50, 20, 10 dhe 5 euro. Ato përbënin rreth 88.4 përqind të kartëmonedhave të papërshtatshme për riqarkullim për shkak të normës më të madhe të lëvizjes prej dore në dorë nga qytetarët gjatë qarkullimit të tyre.

Figura 66. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2018)

Figura 67. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar (%)



Burimi: BQK (2018)

Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të sektorit bankar me kartëmonedha euro plotësisht të reja, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2017, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me më shumë se 4.5 milionë copë kartëmonedha të reja euro (42.4 për qind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara).

Figura 68. Furnizimi me kartëmonedha të reja (numri i copëve)





Figura 69. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara



Rreth 86.1 përqind e sasisë së kartëmonedhave të reja të furnizuara gjatë vitit 2017 ishin kartëmonedha të denominimeve me vlerë të ulët (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Mandej, edhe të gjitha kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim euro me të cilat u furnizuan ishin të një cilësie të lartë (të përshtatshme për riqarkullim).

Për sa u përket masave kundër falsifikimit, BQK-ja vazhdoi të

bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false. BQK-ja së bashku me Laboratorin e Forenzikës publikuan në faqen zyrtare të<sup>14</sup> BQK-së statistikat mbi paratë e falsifikuara në nivel të Republikës së Kosovës. Më tutje, materiale edukative u publikuan me qëllim të informimit të publikut të gjerë mbi tiparet e sigurisë së kartëmonedhave të serisë Europa.

## 5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe institucione të tjera siç janë bankat dhe institucionet të tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore), dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të Ligjit nr. 03/L-209 të BQK-së. Në vitin 2017, ngjashëm me vitet e mëparshme, këto shërbime përbëheshin kryesisht nga mirëmbajtjet e llogarive dhe kryerja e pagesave.

BQK-ja ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Ministrisë së Financave dhe të Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Format e pagesave dhe mënyrat e komunikimit u janë përshtatur kërkesave të tyre. Vlen të veçohet elektronizimi i plotë i kryerjes së urdhërtransferëve ndërkombëtarë të Ministrisë së Financave. Gjatë vitit 2017 të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT kurse të gjitha pagesat vendore u realizuan përmes sistemit ATS, duke shkurtuar kështu kohën dhe duke rritur efektivitetin e procesimit.


<sup>14</sup> <http://bqk-kos.org/?id=31>

**Tabela 16. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)**


Llojet e transaksioneve	2013	2014	2015	2016	2017
<b>Transaksionet me para te gatshme</b>	<b>+470,786</b>	<b>+475,752</b>	<b>+476,310</b>	<b>+467,362</b>	<b>+563,570</b>
Depozita ne para te gatshme	737,524	794,989	776,195	842,240	989,618
Terheqje te parave te gatshme	266,738	319,237	299,885	374,878	426,048
<b>Transferet vendor</b>	<b>+581,797</b>	<b>+839,345</b>	<b>+942,520</b>	<b>+1,041,198</b>	<b>+1,131,645</b>
Transferet vendor ardhës	1,554,535	1,615,753	1,677,024	1,712,605	1,861,640
Transferet vendor dales	972,738	776,408	734,504	671,407	729,995
<b>Transferet nderkombetar</b>	<b>-321,676</b>	<b>-714,099</b>	<b>-441,312</b>	<b>-580,656</b>	<b>-432,050</b>
Transferet nderkombetar ardhës	653,710	404,473	538,375	970,941	1,081,879
Transferet nderkombetar dales	975,386	1,118,572	979,687	1,551,597	1,513,929

Burimi: BQK (2018)

Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së në vitin 2017 u kryen në emër të dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të dhe për llogari të Thesarit<sup>15</sup>.

**Figura 71. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse, numri**

Burimi: BQK (2018)

**Figura 72. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse, në milionë euro**


Burimi: BQK (2018)

BQK-ja ka procesuar në emër të klientëve të saj mbi 386 mijë urdhërpagesa shkuarëse vendore (një zvogëlim prej 1% krahasuar me vitin paraprak), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 87<sup>16</sup> mijë urdhërpagesa ardhëse (një zvogëlim prej 21 përqind krahasuar me vitin paraprak). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat shkuarëse vendore kapnin shumën prej mbi 730 milionë euro (një rritje prej 8.8% krahasuar me vitin paraprak) dhe urdhërpagesat ardhëse vendore kapnin shumën mbi 1.86 miliardë euro (një rritje prej 8.7 përqind krahasuar me vitin paraprak). Numri dhe shuma më e madhe e transaksioneve vendore u krye nga BQK-ja me urdhër dhe për Thesarin.

Sa i përket pagesave vendore dalëse, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato, kurse institucionet e sigurimit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.


<sup>15</sup> Thesari – Ministria e Financave<sup>16</sup> Shumica e pagesave ardhëse me implementimin e sistemit ATS pranohen nga BQK si të grupuara

Figura 73. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse, numri



Burimi: BQK (2018)


Figura 74. Vlera e transaksioneve vendore ardhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)


Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kishte të bënte me transferet e fondeve të bankave komerciale. Të dhënat vjetore mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në katër figurat në vijim.

Figura 75. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, numri



Burimi: BQK (2018)


Figura 76. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)


Më 31 dhjetor 2017, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës arritën shumën prej 339.9 milionë euro, ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 471.3 milionë euro. Se bashku, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës dhe ato të AKP-së përbënin rreth 65.4 përqind të depozitave të gjithsejta që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2017.

Figura 77. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2018)

Figura 78. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2018)

**Tabela 17. Niveli i depozitave të klientëve kryesorë (në mijëra euro)**

Gjendja e llogarive	2013	2014	2015	2016	2017
<b>Gjithsej gjendja</b>	<b>1,324,296</b>	<b>1,082,519</b>	<b>1,135,559</b>	<b>1,074,458</b>	<b>1,239,730</b>
Institucionet Qeveritare	206,838	155,481	248,780	257,393	339,906
Agjencia Kosovare e Privatizimit	550,328	557,801	486,819	460,961	471,299
Bankat Komercale + Kompanitë e Sigurimeve	332,798	321,670	320,934	301,051	336,732
Të tjera	234,332	47,567	79,025	55,053	91,793

Burimi: BQK (2018)

Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe institucionet e sigurimit janë më të rëndësishmet sa i përket nivelit të depozitave në BQK. Depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimeve që mbahen në BQK, kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat dhe obligimet rregullatore dhe ligjore. Ato përbënin 27.2 për qind të depozitave të gjithsejta që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2017. Më 31 dhjetor 2017, depozitat e bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit ishin në shumën prej 336.7 milionë euro.

**Figura 79. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së, në milionë euro**

Burimi: BQK (2018)

### 5.3. Sistemi i Pagesave

Në funksion të avancimit të mëtejme të sistemit të pagesave dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve, si një ndër objektivat primare të BQK-së, gjatë vitit 2017 është vazhduar me zhvillimin e kuadrit rregullator bazuar në standardet e aplikueshme në Bashkimin Evropian, si dhe me avancimin e proceseve operative për të rritur efikasitetin e sistemit të pagesave.

Në vitin 2017 është kryer edhe funksionalizimi i plotë i sistemit të ri të pagesave, i cili ka filluar implementimin nga korriku i vitit 2016. Sistemi i ri është karakterizuar me qëndrueshmëri, siguri dhe efikasitet të lartë, i cili ka mundësuar kliringun dhe shlyerjen me kohë të të gjitha transaksioneve.

Në kuadër të fuqizimit të bazës ligjore, gjatë vitit 2017 janë aprovuar dy rregullore të lidhura me sistemin e pagesave, rregullorja për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave dhe rregullorja për instrumentet e pagesave elektronike. Po ashtu është punuar në fuqizimin e kornizës rregullative për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave bazuar në parimet e BIS për infrastrukturën e tregjeve financiare.

Gjatë vitit 2017 është vazhduar me avancimin e Regjistrimit të Llogarive Bankare për të adaptuar kërkesat e reja që dolën nga amandamenti i Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Bazuar në këto kërkesa, janë zgjeruar edhe funksionet e këtij regjistri ku aktualisht i gjithë procesi i zbatimit të vendimeve përmbartimore mundësohet të kryhet në mënyrë automatike përmes shkëmbimit të vendimeve përmbartimore ndërmjet organeve të përmbartimit dhe bankave në formë elektronike. Këto ndryshime kanë ngritur nevojën për rishikimin e Udhëzimit për Regjistrin e Llogarive Bankare për të adaptuar këto kërkesa të Ligjit për procedurën përmbartimore, i cili është në proces të amandamentimit dhe pritet të finalizohet gjatë vitit 2018.




### 5.3.1 Operimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare

Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN) mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar, si dhe shlyerjen e letrave me vlerë. Figurat në vijim, paraqesin numrin dhe vlerën e transaksioneve të kryera përmes SPN-së për periudhat përkatëse:


Treguesit statistikorë të aktivitetit të SPN-së kanë reflektuar me një rritje në vëllim dhe vlerë të transaksioneve të paraqitur si në vijim:

Figura 80. Numri i transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2018)


Figura 81. Vlera e transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2018)


Janë procesuar rreth 11.7 milionë transaksione me vlerë totale prej afërsisht 11.6 miliardë euro. Krahasuar me transaksionet e SPN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve është rritur për 0.78% dhe vlera e transaksioneve është rritur për 9.23%.

Figura 82. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SPN



Burimi: BQK (2018)

Figura 83. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SPN




Burimi: BQK (2018)

Rritja e vazhdueshme në vëllim dhe vlerë të transaksioneve ndërbankare të SPN-së pasqyron rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar. Në kuadër të SPN-së realizohen pagesat përmes dy komponentëve.


Në komponentën RTGS realizohen në kohë reale të gjitha pagesat me vlerë mbi 10,000 €, si dhe të gjitha pagesat të urdhëruara me prioritet nga ana e klientëve, ndërsa në komponentën ACH realizohen të gjitha pagesat me vlerë nën 10,000 € dhe përfshijnë këto lloje të pagesave: pagesat e rregullta (individuale dhe masive), pagat dhe pensionet, pagesat Kos-Giro dhe Debitimi Direkt. Niveli i rritjes si për nga vëllimi ashtu edhe vlera e këtyre kategorive të pagesave për vitet 2016 dhe 2017 është paraqitur në figurat si në vijim:

Figura 84. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2018)

Figura 85. Vlera vjetore e transaksioneve të SPN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2018)

Pagesat e rregullta (individuale dhe masive) përbëjnë rreth 48.2% të vëllimit dhe 17% të vlerës së transaksioneve të SPN-së.

Transaksionet Kos-Giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Gjatë vitit 2017 numri i pagesave Kos-Giro është zvogëluar për 35.2%, ndërsa vlera e tyre shënoi rritje prej rreth 3.2%.

Transaksionet RTGS, procesohen dhe shlyhen gjatë orarit të punës në kohë reale dhe në baza bruto. Gjatë vitit 2017 numri i tyre përbënte rreth 0.9% të numrit të përgjithshëm të transaksioneve në SPN, ndërsa vlera e tyre rreth 35% të vlerës së transaksioneve përmes SPN-së.


Debitimi Direkt si instrument i pagesës ende nuk është duke u përdorur në atë masë sa instrumentet tjera të pagesave. Kështu që gjatë vitit 2017, ky lloj i transaksioneve përfaqësonte në total më pak se 1% të vëllimit dhe vlerës së transaksioneve të SPN-së.

Pasqyrimi i pagesave të procesuara përmes sistemit ACH gjatë vitit 2017 sipas sesioneve, tregon një përqendrim më të theksuar në sesionin e parë të kliringut, krahasuar me dy sesionet tjera. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë sesionit të fundit të kliringut minimizon rreziqet shtesë në kuadër të funksionimit të sistemit të pagesave.

Numri dhe vlera e transaksioneve në përqindje sipas sesioneve është paraqitur në figurën 86 dhe figurën 87.


Vlera e përgjithshme e transaksioneve të shlyera në SPN gjatë vitit 2017 ka qenë 11,631,558,178 €, ku tri institucionet e para me vlerë më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 60.62% të vlerës

Figura 86. Numri i transaksioneve sipas sesioneve në SPN



Burimi: BQK (2018)

Figura 87. Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në SPN



Burimi: BQK (2018)

së përgjithshme, ndërsa të gjitha institucionet tjera zënë 39.38%. Sa i përket numrit të transfereve të iniciuara, nga numri i përgjithshëm i tyre prej 11,678,336, tri institucionet e para me numër më të madh të transfereve të iniciuara zënë 73.63% të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë institucionet tjera zënë 26.37%.

Një pasqyrë e detajuar e treguesve të përqendrimit të pjesëmarrjes së institucioneve më aktive në SPN gjatë vitit 2017, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem, është paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela 18. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SPN**

Sistemi SPN	Vëllimi	Vlera
3 banka	73.63%	60.62%
7 bankat tjera	26.37%	39.38%
Gjithsejt	11,678,336	11,631,558,178

Burimi: BQK (2018)

### 5.3.2 Mbikëqyrja dhe analizat e sistemeve të pagesave

Në kuadër të funksionit të mbikëqyrjes dhe analizave të sistemeve të pagesave, gjatë periudhës raportuese, është amandamentuar Rregullorja mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave në harmonizim me Rregulloren e Bankës Qendrore Evropiane - BQE-së nr. 1409/2013 për Statistikat e Pagesave. Sipas kësaj rregulloreje, raportimi periodik i instrumenteve të pagesave do të zhvillohet duke aplikuar format e reja të raportimit duke u bazuar në standardet dhe kriteret të përcaktuara nga BQE, që janë thelbësore për identifikimin dhe monitorimin e zhvillimeve në tregjet e pagesave dhe për të ndihmuar në promovimin e funksionimit më të mirë të sistemeve të pagesave.

Në gusht të vitit 2017, Bordi i BQK-së ka miratuar Rregulloren për instrumentet e pagesave elektronike me qëllim të përcaktimit të kushteve, kërkesave dhe procedurave për lëshimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike, si dhe përcaktimin e mënyrës së raportimit të informacionit gjatë përdorimit të këtyre instrumenteve të pagesave elektronike. Me anë të kësaj rregulloreje janë adaptuar kërkesat për rritjen e transparencës për klientin dhe rregullat për mbrojtjen e klientit. Kjo rregullore përcakton detyrimet ndaj lëshuesve dhe mbajtësve për lëshimin dhe për mënyrën e përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike. Gjithashtu, kjo rregullore adreson edhe instrumentin e parasë elektronike, e cila përcakton kushtet dhe kërkesat bazuar në standardet e Bashkimit Evropian.

Me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe efikasitetit të raportimit të instrumenteve të pagesave, BQK-ja në tremujorin e katërt të 2017 ka përgatitur infrastrukturën dhe ka zhvilluar marrëveshjen për automatizimin e raportimit të statistikave të pagesave përmes sistemit të raportimit elektronik. Ky sistem do të ndikojë në ngritjen e nivelit të sigurisë gjatë shkëmbimit të informacionit, do të mundësojë konsolidimin automatik të të gjitha raporteve nga njësitë raportuese në një të vetëm që do të ndikojë në shkurtrimin e kohës, do të shërbejë për qëllime arkivore dhe në të ardhmen sipas nevojës mund të zhvillohet edhe për qëllime të avancuara analitike.

Zhvillime të rëndësishme nga prioritetet në fushën e mbikëqyrjes, janë Rregullorja për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave me rëndësi sistematike dhe Metodologjia për vlerësimin e sistemeve të pagesave. Të dy këto dokumente janë përgatitur në formë draftit duke u bazuar në dokumentet përkatëse të Bankës Qendrore të Evropës dhe në Parimet për Infrastrukturat e Tregut Financiar të Bankës për Rregulime Ndërkombëtare për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e sistemeve

të pagesave të rëndësishme sistematike të cilat pritet të finalizohen dhe të fillojnë implementimin gjatë këtij viti.

Gjatë vitit 2017 ka vazhduar publikimi i analizave dhe raporteve të rregullta rreth zhvillimeve të sistemeve të pagesave, si :

- Analiza mbi përdorimin e kartelave në Kosovë – analizë vjetore që pasqyron shpërndarjen socio-demografike të kartelave të cilat përdoren nga ana e qytetarëve të Kosovës, si dhe analizon faktorët të cilët kanë ndikuar në një shpërndarje të tillë të kartelave;
- Analiza mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë - analizë e publikuar në baza tremujore që pasqyron statistikën lidhur me procesin e SPN-së me theks të veçantë, numrin dhe vlerën e transaksioneve ndërbankare, numrin e llogarive bankare, numrin dhe funksionin e terminaleve ATM dhe POS, numrin e kartelave sipas funksionit dhe transaksionet me kartela.


Gjithashtu në baza të rregullta janë përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare të BQK-së raportet periodike:

- Raporti mujor mbi numrin dhe vlerën e pagesave të SPN-së;
- Raporti mujor mbi depozitat e bankave komerciale dhe rezervat;
- Raporti mujor mbi instrumentet me para të gatshme dhe jo me para të gatshme;
- Raporti vjetor mbi depozitat e bankave komerciale dhe rezervat;
- Raporti vjetor krahasues mbi instrumentet elektronike.

### 5.3.3 Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave


Raportimet e bankave për instrumente të pagesave tregojnë se deri në fund të dhjetorit të vitit 2017 numri i kartelave të debitit arriti në 926,209 ndërsa numri i kartelave të kreditit arriti në 164,740. Krahasuar me një vit më parë, konstatohet se numri i kartelave të debitit është rritur për 8.1%, ndërsa numri i kartelave të kreditit është rritur për 5.3%.

Figura 88. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2018)

Figura 89. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit




Burimi: BQK (2018)

Sa i përket infrastrukturës së terminaleve ATM (bankomate) dhe POS (pika të shitjes) të ofruara nga ana e bankave komerciale në Kosovë, shihet se ka pasur rritje të vazhdueshme të numrit të terminaleve POS (11,501), kurse terminalët ATM janë karakterizuar me një ulje të lehtë edhe gjatë këtij viti (512).


Krahas rritjes së numrit të terminaleve dhe instrumenteve të pagesave, nga të dhënat statistikore shihet se viti 2017 është karakterizuar edhe me rritje të përdorimit instrumenteve elektronike të pagesave.

Figura 90. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2018)


Figura 91. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2018)


Numri i pagesave të kryera përmes shërbimit e-banking arriti në 3.4 milionë transaksione që krahasuar me vitin paraprak paraqet rritje për 16.9%, ndërsa vlera e tyre arriti në 8.5 miliardë euro, me rritje vjetore prej 26.6%.

Figura 92. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2018)

Figura 93. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2018)

Viti 2017 po ashtu u karakterizua me një tendencë në rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Numri i pagesave në POS terminale është rritur për 11.7%, ndërsa vlera e tyre është rritur për 3.4%. Po ashtu edhe tërheqjet në ATM terminale janë karakterizuar me rritje. Numri i tërheqjeve në ATM gjatë vitit 2017 është rritur për rreth 17%, ndërsa vlera e tërheqjeve është rritur për 26.6%.

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2017, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve ishte rreth 1.97 milion, që paraqet një rritje prej 4.95% krahasuar me fundin e vitit 2016. Rreth 98.45 % e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.55% janë të jorezidentëve.

Nga totali i llogarive, në fund të vitit 2017, rreth 357.3 mijë llogari kishin qasje “online” nga interneti për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë, duke shënuar një rritje prej 54.7% në krahasim me vitin 2016.

Bazuar në të dhënat statistikore zhvillimi i infrastrukturës ka rezultuar me një ritëm më të shpejtë të zhvillimit. Inkurajues mbetet trendi i shpejt i rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

**Tabela 19. Numri i llogarive**

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2015	2016	2017	2015	2016	2017
Llogaritë e klientëve (1+2)	1,886,644	1,875,091	1,967,755	187,297	230,905	357,320
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.37%	98.45%	98.40%	97.22%	97.86%	98.51%
a-Individuale (%)	93.18%	92.85%	93.10%	79.66%	79.68%	84.26%
b-Kompani (%)	6.82%	7.15%	6.90%	20.34%	20.32%	15.74%
2-Llogari të jo-rezidentëve (c+d) (%)	1.63%	1.55%	1.60%	2.78%	2.14%	1.49%
c-Individuale (%)	96.60%	96.99%	97.48%	91.99%	91.54%	91.85%
d-Kompani (%)	3.40%	3.01%	2.52%	8.01%	8.46%	8.15%

Burimi: BQK, Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave"

Sa i përket krahasimit të Kosovës me vendet në rajon, shihet se trendi i shpejtë i zhvillimit gjatë viteve të fundit ka ndikuar, që sot Kosova të ketë përmirësuar pozitën e saj krahasuar me vendet fqinje.

**Tabela 20. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave<sup>17</sup>**

Përshkrimi	Banorë	ATM për milion banorë	POS për milion banorë	Kredit Kartelat për milion banorë	Debit Kartelat për milion banorë	E-Banking për milion banorë
Kosova	1.77	295	5,982	88,382	484,021	130,454
Shqipëria	2.89	277	2,461	29,736	301,596	72,372
Republika Çeke	10.55	446	14,066	187,922	951,556	-
Turqia	78.74	615	22,177	746,704	1,486,813	-
Slovenia	2.06	814	-	56,267	1,249,059	-
Bullgaria	7.15	804	14,614	170,065	878,315	-
Hungaria	9.83	508	12,319	137,940	772,029	-
Bosnja	3.52	430	7,478	-	-	109,023
Mali i Zi	0.62	626	20,692	63,924	680,106	177,400
Kroacia	4.19	1,084	25,318	33,680	1,640,330	-
Maqedonia	2.07	502	16,896	181,475	697,112	335,855

Burimi: BQK (2018) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse

### 5.3.4. Reduktimi i pagesave me para të gatshme

Zhvillimet në përmirësimin e kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe zhvillimet tjera në infrastrukturë, kanë ndikuar në rritjen e përdorimit të pagesave përmes instrumenteve elektronike.

Nga të dhënat statistikore për vitin 2017, vërehet rritje në numër dhe vlerë të kredit transfereve, të cilat paraqesin një alternativë për pagesa pa para të gatshme. Me rritje të dukshme të përdorimit janë karakterizuar edhe pagesat përmes instrumenteve elektronike siç janë: transaksionet përmes debit kartelave, kredit kartelave dhe e-bankingut, duke ndikuar në zvogëlim të pagesave në para të gatshme.

Nëse krahasojmë vitin 2016 dhe 2017, atëherë mund të theksojmë se në vitin 2017 numri i transaksioneve me kartela është rritur për 9.5% ndërsa vlera e tyre ka një rritje prej 30.7%, duke vijuar me trendin rritës të vërejtur gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, edhe transaksionet përmes e-banking janë rritur për 17.7%, në krahasim me vitin paraprak. Prirja gjithnjë e në rritje e përdorimit të e-banking lidhet ngushte edhe me përmirësimin e infrastrukturës, si dhe mundësi për t'u qasur në e-banking edhe përmes aplikacioneve në telefon mobil.

<sup>17</sup> Të dhënat në tabelë janë nga viti 2016 pasi që shumica e vendeve në rajon të dhënat për vitin 2017 nuk i kanë publikuar ende

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në kryerjen e transaksioneve me kartela, në funksion të rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike për pagesa, BQK-ja është duke analizuar mundësitë për implementimin e një sistemi ndërbankar të pagesave me kartelë për të ofruar funksionalitet ndër operimi mes lëshuesve të kartelave në mënyrë që të unifikohen терминаlet e pikave të shitjes POS dhe ATM-ve, që do të mundësonte uljen e kostos dhe zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit. Lidhur me këtë çështje, gjatë vitit 2018 do të zhvillohet një projekt me mbështetjen e Bankës Botërore, për të gjetur zgjidhjen më adekuate për krijimin e këtij sistemi.

#### 5.4. Menaxhimi i Mjeteve

Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve është përgjegjës për plasmanin e mjeteve financiare nën menaxhim të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), si dhe për operimin e sistemit depozitar dhe platformës elektronike për tregtimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në veçanti, detyra e menaxhimit të rezervave ndërkombëtare është e specifikuar në kuadër të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

##### 5.4.1. Menaxhimi i Investimeve

Sipas Politikës së Investimeve të aprovuar nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së, objektivat kryesore të përcaktuara gjatë menaxhimit të mjeteve janë: siguria, likuiditeti dhe kthimi në investime.

Përgjatë vitit 2017, të gjitha mjetet janë investuar në instrumente financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta, likuide dhe me vlerësim kreditor adekuat.

Kategoritë e instrumenteve financiare në të cilat janë investuar mjetet janë:

- depozitat e afatizuara bankare me afat maturimi deri në një vit, përkatësisht depozita në euro dhe dollar amerikan të afatizuara me banka komerciale të shteteve të Eurozonës dhe Rezervën Federale të SHBA-së;
- obligacionet qeveritare, supranacionale apo të agjencive shtetërore të emetuara në euro me afat maturimi deri në pesë vite;
- obligacionet shtetërore të emetuara nga Qeveria e Kosovës të tregtuara në tregun sekondar të letrave me vlerë me afat maturimi deri në pesë vite.

Shpërndarja e portfolios së investimeve sipas llojit të instrumentit, maturitetit dhe shumës është vendosur në përputhje me zhvillimet në tregjet financiare dhe nevojat e parashikuara për likuiditet të BQK-së. Karakteristika kryesore e vitit 2017 është plasmani i mjeteve me afat më të gjatë kohor, respektivisht periudha tri deri në pesë vjeçare. Një plasman i tillë vjen si rezultat i normave të pavaforshme dhe negative në tregun e parasë së Eurozonës.

Shpërndarja e instrumenteve financiare të portfolios së BQK-së në vitin 2017 është ndikuar nga normat negative në Eurosistem të cilat kanë ngushtuar gamën e instrumenteve adekuate për investimin e fondeve. Instrumentet e tregut të parasë në euro janë përcjellë me norma kthimi negative gjatë gjithë vitit, ndërsa normat pozitive të kthimit për obligacionet shtetërore dhe ato të garantuara nga shtetet kanë ofruar norma pozitive kthimi vetëm për periudhat mbi 5 vite. Prandaj, me qëllim të shpërndarjes më efektive të portfolios investuese dhe realizimit të kthimeve nga investimet, është kryer plasmani i investimeve në obligacione të agjencive shtetërore dhe obligacione supranacionale, si dhe në instrumente të tregut të parasë në valuta tjera përveç euros, siç është dollari amerikan.



Shpërndarja e portfolios së BQK-së në kategoritë kryesore të instrumenteve financiare e paraqitur në figurën 94 tregon një përqendrim të lartë në instrumente borxhi, respektivisht letra me vlerë të qeverive. Gjatë tërë vitit është mbajtur shpërndarja nën totalin prej 70 përqind të portfolios në letra me vlerë si kriter i përcaktuar në Politikën e Investimeve. Po ashtu, është respektuar kufizimi tjetër prej maksimum 60 përqind në depozita bankare, si dhe kufijtë kohor të maturitetit.


Menaxhimi i portfolios së investimeve drejt periudhave më të gjata kohore është balancuar me mbajtjen e një pjese të konsiderueshme të mjeteve likuide për përmbushjen e nevojave të depozitorëve të saj për realizimin e pagesave. Rrjedhimisht, 38.17 përqind e mjeteve të disponueshme janë siguruar në para të gatshme në llogaritë e jashtme të BQK-së.

Letrat me vlerë të emetuara nga shtetet e Eurozonës, agjencitë shtetërore supranacionale si dhe letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës përbëjnë instrumentet kryesore për nga pjesëmarrja në portfolio prej 55.68 përqind të totalit të mjeteve të disponueshme për investim. Rritja e qëndrueshme në letra me vlerë përgjatë muajve e paraqitur në figurën 94 vjen si rezultat i shpërndarjes së investimeve nga tregjet e huaja në tregun vendor. Letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës janë ndër instrumentet kryesore që kanë ngritur ekspozimin në kategorinë e instrumenteve të tregut të letrave me vlerë.

Krahasuar me vitin 2016, viti 2017 karakterizohet me një shumë më të lartë të mjeteve të disponueshme për investim. Kjo rritje në totalin e mjeteve për investim në portfolio vjen si pasojë e pagesave hyrëse në favor të BQK-së, si dhe përqendrimit më të lartë të mjeteve në para të gatshme në trezor për të evituar normat negative të aplikuar nga Banka Qendrore Evropaine (BQE) sipas politikës së normës depozitare (-0.40%).


Pjesëmarrja më e lartë në letra me vlerë e shpjeguar si më lartë shihet në figurën 96 ku pasqyrohet portfolio investuese sipas kategorive të instrumenteve financiare për vitin 2017 krahasuar me vitet paraprake.

Figura 94. Raporti i shpërndarjes së investimeve të portfoliit të BQK-së, në përqindje




Burimi: BQK (2018)

Figura 95. Saldoja përfundimtare e mjeteve të investuara nga BQK sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2018)

Figura 96. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit



Burimi: BQK (2018)



### 5.4.1.2. Përformanca e portfolios për vitin 2017

Normat negative të interesit në Eurozonë kanë arritur nivele historike në vitin 2017. Gjithashtu, gjatë vitit 2017, BQE ka vazhduar të zbusë gjendjen e likuiditetit në Eurosistem me politika ekspansioniste duke vazhduar drejtpërdrejtë programin për blerjen e mjeteve dhe ka lehtësuar procedurat e riblerjeve në tregun sekondar. Kjo ka sjellë një ndikim pozitiv të shkurtër në tregun ndërbankar të euros edhe pse normat kanë vazhduar të qëndrojnë në territor negativ.

Luhatshmëri të tjera në tregun e Eurozonës janë shkaktuar si pasojë e zhvillimeve politike në Britani të Madhe, Itali dhe Francë.

Përkundër paqëndrueshmërive në tregun financiar, BQK-ja ka realizuar kthime pozitive nga investimet në instrumentet financiare. Njëkohësisht gjatë kësaj periudhe nuk është depozituar me banka evropiane të cilat kanë pasur probleme ligjore dhe është mbajtur niveli adekuat i likuiditetit.

Figura 97 paraqet kthimet e realizuara nga investimet në depozita në euro dhe në dollar amerikan. Investimet në dollar amerikan kanë rezultuar në kthime pozitive, ndërsa investimet në euro kanë shënuar nivel rekord të ulët të normave si rezultat i zhvillimeve në Eurosistem të përshkruara si më lartë.

Struktura e horizontit kohor po ashtu ndryshon për depozitat bankare në krahasim me letrat me vlerë, ashtu siç paraqitet në figurën 98 horizonti me afat të shkurtër kohor në depozita (4 ditë) vjen si rezultat i investimeve në periudha kohore ditore në dollar të cilat kanë ulur mesataren e përgjithshme të plasmaneve në depozita.


### 5.4.2. Menaxhimi i Rrezikut

Investimi i mjeteve bëhet në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet apo agjensitë më kredibile të Eurozonës, supranacionale si dhe në institucionet bankare me vlerësim kreditor investiv sipas vlerësimeve nga Agjencitë Kreditorë Ndërkombëtare: Standard&Poor's dhe Moody's.

Rreziqet financiare gjatë investimit të mjeteve nga ana e BQK-së janë: rreziku kreditor, rreziku i normës së interesit, rreziku likuiditetit, rreziku valutor dhe rreziku operacional.


**Rreziku kreditor** - Portfolio e investimeve është shpërndarë në mënyrë që të mbahet rreziku kreditor në nivel të ulët. Të gjitha investimet janë realizuar në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër dhe afatgjatë kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P) për afat të shkurtër dhe Baa2/BBB- (Moody's/S&P) për afat të gjatë, si dhe në rastet

Figura 97. Norma e kthimit të investimeve në portfolio nga depozitat në EUR dhe USD për dy periudhat gjashtëmujore të vitit 2017 (%)



Burimi: BQK (2018)

Figura 98. Horizonti kohor mesatar i shprehur në ditë deri në maturim për dy kategoritë e plasmaneve



Burimi: BQK (2018)

e jashtëzakonshme në treg si në rastin e normave negative të interesit me P-3/A-3 për afat të shkurtë dhe Baa3/BBB- (Moody's/S&P) për afat të gjatë.

**Rreziku i normës së interesit** - është matur duke krahasuar normën e kthimit nga investimet në portfolion e BQK-së me normën EURIBOR 1 mujor (Norma mesatare e huadhënies ndërbankare për valutën euro) si normë krahasuese.

**Rreziku i likuiditetit** - investimet janë bërë në përputhje me horizontin kohor të përcaktuar me Politiken e Investimeve. Instrumentet në të cilat është investuar janë kryesisht instrumente me afat të shkurtër sidepozita bankare, bono thesari dhe obligacione shtetërore.

**Rreziku valutor**- paraqitet si pasojë e lëvizjeve të kursit këmbimor që implikojnë vlerën e valutave në tregun financiar ku mund të paraqitet kthimi apo humbja si rezultat i ndryshimeve të kursit këmbimor. BQK-ja kishte një nivel të ulët ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutor, gjatë vitit 2017. Në fund të vitit 2017, portfolio e investimeve është ekspozuar vetëm në valutën euro dhe dollar amerikan.

**Rreziku operacional** - ky rrezik ekziston në të gjitha aktivitetet dhe për të minimizuar rrezikun operacional, investimet janë realizuar me saktësi duke ju nënshtruar kontrollit efikas për çdo transaksion.

#### 5.4.3 Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës


Në pajtim me Ligjin për Borxhet Publike BQK-ja vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave (MeF).

Sipas kalendarit të emetimeve të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, në vitin 2017 janë mbajtur 19 ankande përmes platformës elektronike: 1 ankand për bono thesari me afat maturimi 91 ditë, 2 ankande për bono thesari me afat maturimi 182 ditë, 5 ankande për bono thesari me afat maturimi 364 ditë, 4 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi dy vite, 2 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi tre vite dhe 3 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi 5 vite.

Për herë të parë në vitin 2017 janë realizuar 2 ankande për obligacione qeveritare me afat maturimi 7 vite.


Në figurën 99 paraqitet struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës e shprehur në përqindje sipas afatit të maturimit. Figura 100 paraqet strukturën e institucioneve pjesëmarrësve në ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës.<sup>18</sup>

Figura 99. Struktura e Letrave me Vlerë sipas afatit të maturimit



Burimi: BQK (2018)

Figura 100. Struktura e pjesmarrësve në ankande



Burimi: BQK (2018)

<sup>18</sup> Pjesëmarrës në tregun e letrave me vlerë të Qeverisë kanë qenë akterët primarë (bankat komerciale), Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës si pjesëmarrës primar, kompanitë e sigurimeve dhe pjesëmarrësit tjerë përmes akterëve primarë.

Krahasuar me vitin paraprak, si rrjedhojë e rritjes së kërkesës së tregut për letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës norma mesatare vjetore e kthimit për bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë ka shënuar rënie prej 65 %, për bonot e thesarit me afat maturimi 182 ditë është shënuar rënie prej 30% ndërsa për bonot e thesarit me afat maturimi 364 ditë është shënuar rënie prej 50%. Norma mesatare vjetore e kthimit për obligacionet qeveritare me afat maturimi 2 vite në vitin 2017 ka shënuar rënie prej 36%, për obligacionet qeveritare 3 vite është shënuar rënie prej 46% ndërsa për obligacionet qeveritare 5 vite është shënuar rënie prej 54%. Norma mesatare e kthimit për obligacionet qeveritare 7 vite për vitin 2017 ishte 3.25% (figura 101).

Në figurën 102 janë paraqitur të gjitha ankandet ku shihet se kërkesa më e lartë nga tregu ishte për bono thesari 364 ditë dhe për obligacione qeveritare dy vite.

Aktivitetet në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës krahasuar me vitin paraprak kanë vazhduar me intensitet të zvogëluar, për shkak të rënies së normave të kthimit në tregun primar.

Figura 101. Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2016 dhe 2017, në përqindje





Figura 102. Ankandet e letrave me vlerë të qeverisë në vitin 2017




## 5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës

Bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK-ja mund të operojë, të rregullojë, të licencojë, të regjistrojë dhe të mbikëqyrë sistemet e informacionit të kredive me qëllim të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit të kredive mes institucioneve financiare si dhe mund të nxjerrë rregullore për zbatimin përkatës.

Bazuar në këtë objektiv që nga viti 2006, BQK-ja ka nën menaxhim të saj sistemin e Regjistrimit të Kredive (RKK), i cili funksionon si një aplikacion i bazuar në internet dhe ka për qëllim mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave pozitive dhe negative të personave fizikë dhe juridikë, me qëllim të përmirësimit të procesit vlerësues të klientëve kreditorë, si dhe realizimin e funksionit mbikëqyrës të BQK-së.

Nga një perspektivë e përgjithshme ekonomike, Regjistri i Kredive lehtëson kredidhënien sa i përket vëllimit dhe kostove, si dhe kontribuon në stabilitetin financiar në përgjithësi duke

Figura 103. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së



ndihmuar kredi-dhënësit për një vendimmarrje të drejtë, brenda një kohe më të shkurtër në mënyrë më të saktë dhe më objektive.

Në bazë të rregullores së Regjistrimit të Kredive, anëtarë në sistemin e RKK-së janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga BQK-ja për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të gjitha bankat dhe institucionet mikro-financiare të licencuara, si dhe ato institucione financiare jobankare dhe kompani të sigurimeve të licencuara për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore.

Bazuar në të dhënat e sistemit të RKK-së aktualisht janë të regjistruar 1575 përdorues aktivë të institucioneve kredidhënëse, ku dominon numri i përdoruesve nga e institucionet bankare me 1239 përdorues aktiv, institucionet mikro-financiare dhe ato jo bankare vijnë me 304 përdorues dhe në fund kompanitë e sigurimeve me 32 përdorues aktiv të sistemit të RKK-së. Gjatë vitit 2017, Regjistri i Kredive ka regjistruar 371 përdorues të ri.

Sistemi i Regjistrimit të Kredive është i disenjuar që të sigurojë një infrastrukturë të avancuar për funksionimin e tregut të kredive duke paraqitur një mjet të rëndësishëm për institucionet kredidhënëse në vlerësimin e riskut kreditor.

Sistemi i RKK-së është një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga stafi i institucioneve kredi-dhënëse.

Institucionet kredidhënëse në sistemin e RKK-së hulumtojnë mbi historitë kreditore të aplikantëve kreditor ku sipas statistikave që dalin nga sistemi i RKK-së, numri i hulumtimeve gjatë vitit 2017 kap shifrën prej 658,672 hulumtime.


Një pasqyrë mbi këtë aktivitet, në baza vjetore, për vitet 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 është paraqitur në vijim në figurën 103.

Të gjithë ofruesit e kredive janë të obliguar të raportojnë në RKK, të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga BQK-ja.

Gjatë vitit 2017 bazuar në të dhënat e sistemit të RKK-së, janë raportuar 217,965 kredi të disbursuara ku përfshihen huat, kredit kartelat, mbitorheqjet, kreditë hipotekare rezidenciale, linjat kreditore, garancionet, lizingu, faktoringu dhe asetet tjera kreditore.


Raporti i numrit të kredive të aprovuara sipas llojit të institucionit kredidhënës për vitet 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 është paraqitur në vijim përmes figurës 104.

Figura 104. Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2018)

Figura 105. Numri i kërkesave për raporte kreditore



Burimi BQK (2018)

Në qershor të vitit 2017, BQK-ja ka implementuar sistemin e ri të RKK-së përmes të cilit janë shtuar informata të reja për raportim nga institucionet kredidhënëse për qëllime të mbikëqyrjes, statistikave dhe analizave.

Ndër informatat e reja të raportuara nga institucionet kredidhënëse është e dhëna nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.

Figura 105 paraqet numrin e kërkesave për raportin individual kreditor të kredimarrësve (fizikë / juridikë) bazuar nga të dhënat e sistemit të Regjistrimit të Kredive për vitet 2013, 2014, 2015, 2016, dhe 2017.


Regjistri i Kredive gjatë vitit 2017 ka kontribuar drejtpërdrejt në të dhënat e mbledhura nga Banka Botërore (BB) për vlerësimin e të Bërit Biznes.

Raporti i Bankës Botërore të të Bërit Biznes 2018 i publikuar më 31 tetor 2017, vlerëson Kosovën për indikatorin “Marrja e Kredive” me pozitën e 12-të me një përmirësim prej 8 pozitash për dallim nga raporti paraprak. Sipas përmbledhjes në raportin e të Bërit Biznes 2018, Kosova ka forcuar pozitën e saj sa i përket indikatorit Marrja e Kredive duke miratuar Ligjin për Falimentimin përmes të cilit janë vendosur prioritetet ndërmjet kreditorëve të siguruar gjatë procedurës së falimentimit si dhe duke ofruar bazë të qartë për shkarkim nga ndalesa për kreditorët e siguruar në procedurë të riorganizimit.

Nëse bëhet një krahasim me vendet e rajonit, Kosova qëndron në të njëjtin nivel me dy vendet tjera - Mali i Zi dhe Maqedonia si vendet me vlerësimin më të mirë në rajon për indikatorin - Marrja e Kredive.

Në figurën 106 paraqitet pozita e Republikës së Kosovës për indikatorin “Marrja e Kredive” në krahasim me vendet e rajonit.

Figura 106. Rangimi i Kosovës në raportin Doing Business 2018



Burimi: Doing Business 2018

## 5.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar

Në funksion të realizimit të objektivave të saj, BQK-ja ka vazhduar t'i kushtojë vëmendje të veçantë analizave rreth zhvillimeve të përgjithshme ekonomike në vend, si dhe analizave që kanë të bëjnë me vlerësimin e stabilitetit financiar dhe me aktivitetin e sistemit financiar të vendit. Pjesa më e madhe e këtyre analizave publikohet në baza periodike në kuadër të publikimeve të BQK-së, duke shërbyer kështu si një burim i rëndësishëm informimi për autoritetet politikëbërëse, sektorin e biznesit (përfshirë edhe vetë industrinë financiare), si dhe publikun e gjerë.

Një ndër publikimet më të rëndësishme periodike është Raporti i Stabilitetit Financiar, i cili që nga viti 2014 ka filluar të publikohet dy herë brenda vitit. Raporti i Stabilitetit Financiar pasqyron qëndrueshmërinë e sistemit financiar duke analizuar zhvillimet e përgjithshme ekonomike së bashku me zhvillimet në aktivitetin, performancën dhe qëndrueshmërinë e të gjithë komponentëve të sistemit financiar të vendit.

Për t'i siguruar publikut qasje sa më të shpejtë në informacionet rreth zhvillimeve në ekonominë e vendit, BQK-ja ka vazhduar të publikojë në baza të rregullta Vlerësimin Tremujor të Ekonomisë. Për më tepër, BQK-ja vazhdon të publikojë edhe Raportin e Informatave Mujore të Sistemit

Financiar, i cili paraqet një përmbledhje të indikatorëve kyç për të gjithë komponentët e sistemit financiar të Kosovës dhe publikohet çdo muaj.

BQK-ja ka vazhduar të realizojë Anketën e Kreditimit Bankar me bankat komerciale, duke mbledhur kështu informacion të rëndësishëm për faktorët me ndikim në aktivitetin kredidhënës të bankave në Kosovë, si dhe për pritjet për aktivitetin kredidhënës në periudhën e ardhshme. Informacionet nga kjo anketë e cila realizohet dy herë në vit, përveç që kanë ndihmuar për të kuptuar më mirë zhvillimet në sektorin bankar, shërbejnë edhe si input i rëndësishëm për parashikimin e rritjes ekonomike dhe të agregatëve tjerë makroekonomik.

Gjatë vitit 2017 ka përfunduar ndërtimi i Modelit Makroekonomik për Ekonominë e Kosovës, i cili është i pari i këtij lloji në BQK. Ky model ofron një panoramë të thjeshtëzuar të realitetit ekonomik në Kosovë duke përshkruar lidhjet kryesore funksionale të ekonomisë. Për këtë arsye, modeli do të përdoret si një mjet suplementar nga BQK-ja në analizimin e zhvillimeve në vend, parashikimin e treguesve kryesorë makroekonomik, si dhe në simulimin e goditjeve apo skenarëve të ndryshëm që mund të përjetojë ekonomia e Kosovës. Synimi është që gjatë vitit 2018 të bëhet funksionalizimi i plotë dhe përdorimi i gjerë i tij në analiza të ndryshme ekonomike/financiare dhe azhurnimi i rregullt i tij.

Po ashtu, në vitin 2017 është arritur të publikohet materiali diskutues “Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë”, qëllimi i të cilit është adresimi i dimensionit strukturor dhe ndërsektorial të rrezikut sistemik që ndërlidhet me bankat me rëndësi sistemike. Në këtë punim modeli për identifikimin e BRS-ve për sektorin bankar të Kosovës është avancuar konform standardeve të Autoritetit Evropian Bankar dhe për herë të parë është kalibruar instrumenti i politikës makroprudenciale për adresimin e këtyre institucioneve financiare me rëndësi sistemike, duke dhënë kështu kontribut në operacionalizimin e Politikës Makroprudenciale të BQK-së.

Gjatë vitit 2017, në shërbim të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik të institucioneve bankare, janë përpiluar analiza të posaçme që pasqyrojnë zhvillimet makroekonomike dhe ato të lidhura me stabilitetin financiar, si dhe rreziqet e mundshme makroekonomike me të cilat mund të ballafaqohet stabiliteti financiar në vend. Gjatë këtij viti, po ashtu është rritur frekuenca e përpilimit të analizave të brendshme mbi sistemin financiar, posaçërisht analizave të sektorit bankar, si analiza mbi rreziqet bankare, ecurinë e kredive joperformuese. Në të njëjtën periudhë, është punuar në avancimin e metodologjisë për përpilimin e modelit stres-test.

### **Korniza Makroprudenciale**

Komiteti Këshillëdhënës për Makroprudencë (KKMP) gjatë vitit 2017 ka mbajtur takime të rregullta periodike në përputhshmëri me termat e referencës në Politikën e Makroprudencës të aprovuar nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së në vitin 2016. Për më tepër, takimet janë mbajtur me anëtarësinë bazë dhe të zgjeruar, duke shqyrtuar gjendjen aktuale dhe tendencat e zhvillimeve në sistemin financiar.

Objektiva kryesore e Politikës Makroprudenciale është të ndihmojë ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar duke zvogëluar akumulimin e rrezikut sistemik dhe duke fuqizuar rezistencën e sistemit financiar. Përderisa, objektivat e ndërmjetme të kësaj politike janë zvogëlimi dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kredive dhe të levës, zvogëlimi dhe parandalimi i mospërputhjes së tepruar dhe maturitetit, zvogëlimi dhe parandalimi i jolikuiditetit, kufizimi i koncentrimit të ekspozimeve kreditore, kufizimi i ndikimit sistemik të nxitjeve që synojnë zvogëlimin e rrezikut moralë dhe forcimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturës financiare.

Instrumentet si pjesë përbërëse e Politikës për Mbikëqyrje Makroprudenciale janë të disajnuara të sigurojnë realizimin e objektivave të lartpërmendura. Këto instrumente kanë karakter



parandalues drejt zvogëlimit të mundësive të ngjarjes dhe shtrirjes së një gjendje financiare të paqëndrueshme.

Sipas termave të referencës gjatë vitit 2017, KKMP ka mbajtur 4 takime të rregullta ku është prezantuar gjendja makroprudenciale tremujore, përmes raporteve analitike me indikatorë makroprudencialë (Raporti për treguesit kyçë të sektorit financiar, kushtet e tregut dhe rreziqet sistemike), raporteve mbi profilet e rrezikut të mbikëqyrjes bankare dhe të sigurimeve dhe ka diskutuar mbi ambientin makroekonomik në përgjithësi.

KKMP gjatë vitit 2017 ka evidentuar një ambient të përgjithshëm stabil makroekonomik me përshpejtim të aktivitetit ekonomik në vend, mbështetur kryesisht nga rritja e shënuar në pozicionin e investimeve dhe përmirësimin e pozicionit të neto eksporteve. Bazuar në analizën e përgjithshme të treguesve të shëndetit të sektorit bankar si indikator të zgjedhur të makroprudencës, Kosova rezulton me një stabilitet financiar mjaft të qëndrueshëm dhe pa ndonjë rrezik që do kërkonte vëmendje shtesë nga BQK-ja.

KKMP pas çdo takimi, gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet relevante për gjendjen dhe zhvillimet në sistemin financiar ka raportuar te Bordi Ekzekutiv i BQK-së për vendimmarrje të informuar dhe me kohë.

### 5.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2017

BQK është prodhues zyrtar i statistikave në Kosovë. Në bazë të përgjegjësive, BQK-ja bën mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e statistikave të sektorit monetar e financiar (SMF) dhe statistikave të sektorit të jashtëm (SSJ). Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Statistikës janë të përcaktuara me Ligjin për BQK-në dhe të plotësuara me rregulloret e aprovuara nga Bordi i BQK-së.

Gjatë vitit 2017, BQK-ja ka bërë përparim të rëndësishëm në shpërndarjen e statistikave të sektorit të jashtëm (ESS) në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe zgjeruar më tej gamën e të dhënave të shpërndara në Eurostat. BQK-ja ka koordinuar me sukses implementimin e *Sistemit të Avancuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme* të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Gjithashtu, gjatë 2017 BQK-ja ka zgjeruar gamën e statistikave të reja; rritur mbulueshmërinë; përmirësuar më tej cilësinë e vlerësimeve dhe ka bërë avancim në krijimin e kornizës për hartimin e statistikave të llogarisë financiare.

Nga fillimi i janarit 2017 BQK-ja ka filluar dërgimin e SSJ në Eurostat për publikim të mëtutjeshëm, duke e bërë kështu një hap shumë të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit statistikor të Kosovës. Statistikat e Kosovës për datasetat: (1) bilanci i pagesave; (2) pozicioni i investimeve ndërkombëtare (PIN); (3) tregtia ndërkombëtare në shërbime; dhe (4) investimet e huaja direkte; —janë publikuar për herë të parë nga Eurostat në fillim të këtij viti. Përpilimi i këtyre statistikave është në përputhje të plotë me kërkesat e raportimit për vendet e Bashkimit Evropian (BE). Përveç fillimit të rregullt të raportimit në Eurostat, BQK-ja ka përgatit për publikim edhe seritë kohore për vitet e kaluara (trembëdhjetë vite seri kohore për pasqyrën e bilancit të pagesave; dhjetë vite për PIN; dy vite seri kohore për tregtinë në shërbime; dhe dy vite për investimet direkte. Që nga janari 2017 këto të dhëna janë dërguar në Eurostat konform kalendarit paraprak të publikimeve që aplikon Eurostat.

Në maj të vitit 2017, Kosova ka implementuar Sistemin e Avancuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme të FMN-së (anglisht: Enhanced General Data Dissemination System “e-GDDS”), sistem i rekomanduar nga FMN. Në këtë mënyrë Kosova është zotuar se do të përmbushë një seri kërkesash të rrepta për prodhimin, shpërndarjen dhe dokumentimin e statistikave të publikuara. Statistika të besueshme, të publikuara në kohë dhe me standarde ndërkombëtare janë informatë e domosdoshme në procesin e politikë bërjes ekonomike. Pjesëmarrja në e-GDDS dëshmon

transparencë të sistemit statistikor kombëtar të Kosovës dhe kontribuon në thelb për t'i siguruar Kosovës atraktivitetin si vend biznesi dhe financiar. Si pjesë e sistemit e-GDDS, është ndërtuar faqe kombëtare e të dhënave përmbledhëse (anglisht National Summary Data Page - NSDP) për të gjithë sektorët e ekonomisë. Ky version i NSDP-së i postuar në faqen e internetit të BQK-së, përmban të dhëna statistikore dhe metodologjitë e publikuara lidhur me përpilimin e këtyre të dhënave. Kjo faqe ka për qëllim të shërbejë si një mjet i njëkohshëm për publikimin e të dhënave thelbësore makroekonomike, duke ofruar këtë informacion me qasje të njëkohshme dhe transparente për të gjithë përdoruesit si dhe në formate të lexueshme sipas kalendarit paraprak të publikimit. Kosova është një nga vendet e para të rajonit që ka implementuar sistemin e-GDDS.

Sa i përket përpilimit të informatave të reja statistikore, BQK-ja ka bërë përparim të rëndësishëm duke përgatitur disa tabela të reja statistikore që janë publikuar për herë të parë. Gama me statistika të reja është shumëfishuar me fillimin e publikimit të statistikave të sektorit të jashtëm në Eurostat. Për shembull, statistikave të bilancit të pagesave sipas shteteve, ose investimet direkte sipas klasifikimit NACE. Për më shumë, në faqen e internetit të BQK-së ka publikuar të dhënat e reja për investimet direkte; normat efektive të interesit të ndërmjetësit e tjerë financiar; treguesit e qëndrueshmërisë financiare; bilanci i suksesit i kompanive të sigurimit; kreditë e bankave sipas afatit të mbetur; depozitat në banka sipas afatit të mbetur; si dhe huamarrjet e bankave –sipas afatit origjinal. Për më tepër, në qershor të vitit 2017, BQK-ja ka dërguar për herë të parë në Eurostat dy pyetësor të rinj për të dhënat mbi të Ardhurat e Investimeve të Drejtpërdrejta (të dhënat vjetore për vitin 2015) dhe Pozicionet e Investimeve Direkte (të dhënat vjetore për vitin 2015).

Sa i përket përmirësimit të kualitetit të të dhënave të publikuara, BQK-ja gjatë gushtit 2017 ka realizuar një anketë me jorezidentët që vizitojnë Kosovën, me fokus te diaspora kosovare, për të vlerësuar nivelin dhe strukturën e shpenzimeve të diasporës në Kosovë. Bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi, në fund të vitit 2017 janë reviduar statistikave të bilancit të pagesave, duke përfshirë edhe serinë kohore për dy vitet e fundit. Të dhënat e reja kanë ndikuar në përmirësimin e saktësisë së vlerësimeve të bëra në pasqyrën e bilancit të pagesave. BQK-ja ka bërë progres në përmirësimin e afatit të publikimit të pasqyrave të BQK-së nga 25 pas përfundimit të muajit referues në 15 ditë.

Përveç kësaj, BQK-ja ka përditësuar manualin *Metodologjia e Përpilimit të Statistikave të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare*. Ky manual i publikuar në kuadër të menisë "Statistika" tani është plotësisht në përputhje me një format që përdorin vendet e BE-së, i cili publikohet nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Metodologjia e publikuar është në format të njëjtë me atë që publikojnë vendet e Eurozonës, në mënyrë që lexuesit ta kenë më të lehtë krahasimin dhe që Kosova të jetë në hap me vendet e BE-së. Për më tepër, BQK-ja ka publikuar për herë të parë manualin metodologjik për përpilimin e Statistikave të Tregtisë në Shërbimeve, i cili është plotësisht në përputhje me doracakët e përdorur nga vendet e BE-së.

Me qëllim të përmirësimit të praktikave të shpërndarjes dhe publikimit të të dhënave, BQK-ja ka bërë disa ndryshime në menunë "Statistikat", duke riorganizuar tabelat statistikore të publikuara në kuadër të Serive Kohore. Kjo faqe përmban tabelat statistikore të publikuara mbi sektorin monetar e financiar dhe sektorin e statistikave me jashtë.

BQK-ja ka avancuar sistemin e përpunimit të të dhënave dhe ka automatizuar shumë procese lidhur me përpunimin e të dhënave dhe gjenerimin e raporteve. Me ndihmën e softuerit të ri statistikor, të gjitha të dhënat e sektorit financiar mbledhen përmes një platforme online, e cila ju mundëson raportuesve të ngarkojnë direkt raportet në sistem dhe të bëjnë validimin e të dhënave paraprakisht. Softueri i ri përdoret prej shumë departamenteve brenda BQK-së. Si rrjedhojë, gjatë 2018 planifikohet përmirësim i efikasitetit dhe shkurtim i afateve të publikimeve për statistikave që janë në domenin e BQK-së.



Gjatë periudhës së korrikut 2017, sistemi statistikor i Kosovës ka kaluar një proces të rishikimit nga një mision i ekspertëve të Eurostat-it. Një mision i tillë ka vizituar Kosovën për herë të parë për të kryer një vlerësim të gjerë të sistemit statistikor në Kosovë. BQK-ja si një nga prodhuesit e statistikave kombëtare ka kryer obligimet e veta që dalin nga ky proces. Misioni i Eurostat-it në raportin e tyre kanë konstatuar se përpilimi i statistikave është në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, bankat qendrore të rajonit dhe institucionet relevante vendore në fushën e statistikave ka vazhduar edhe gjatë vitit 2017. Të dhëna të rregullta periodike janë dërguar në FMN, Bankën Botërore, Eurostat, Bankën Qendrore Evropiane (BQE) për qëllime të publikimit. BQK-ja ka marrë pjesë në takimet e rregullta në Komitetin për Statistikat Monetare, Financiare dhe Statistikat e Bilancit të Pagesave të organizuar nga Eurostat-i dhe BQE. Departamenti i Statistikës ka realizuar një vizitë në Bankën Qendrore të Maqedonisë për të rritur bashkëpunimin dhe shkëmbyer përvojat në fushën e statistikave.

### 5.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja

Gjatë vitit 2017 në Divizionin e Rishqyrtimit janë pranuar për rishqyrtim kërkesat nga institucionet financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja, si:

- Kërkesa e institucionit mikrofinanciar “Atlantic Capital Partners” e datës 25 janar 2017.
- Kërkesa e institucionit financiar “Turkiye Ish Bankasi” (më tutje: ISB) dega në Kosovë e datës 8 mars 2017,
- Kërkesa e Aktuarit të Kompanisë së Sigurimeve “Kosova e Re” e datës 29 mars 2017
- Kërkesa e institucionit financiar “Banka Kombëtare Tregtare” dega në Kosovë e datës 21 prill 2017,
- Kërkesa e institucionit financiar, bankës TEB Sh.A e datës 20 qershor 2017,
- Kërkesa e IFJB MONETA SH.P.K të datës 8 gusht 2017,
- ( me kërkesë të BE – është rishqyrtuar kjo kërkesë).
- Kërkesa e Institucionit Mikrofinanciar “Qelim Kosova” e datës 6 tetor 2017,
- Kërkesa e Institucionit Mikrofinanciar “Iner-Expertise sh.p.k.” e datës 04.12.2017.

Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar me kujdesin profesional dhe ligjor dhe janë sjellë konkluzione të cilat janë adresuar në rekomandimet përkatëse që i janë përcjell Bordit Ekzekutiv të BQK -së për vendimmarrje.

Divizioni i rishqyrtimit ka kontribuar në zhvillimin e projektit Alfresco (projekt për sistemin e menaxhimit të informacionit –SMI në BQK-ë), me dhënien e informacione të nevojshme dhe përshkrimin e procesit për punët që bën divizioni dhe procedurat që ndjek, me qëllim të qartësimit të procedurës për *përcaktimin e diagramit të procesit* për menaxhim të informacionit në Divizionin e rishqyrtimit

Divizioni i rishqyrtimit ka rishqyrtuar dhe ka iniciuar ndryshimin e Rregullores për *procedurat për ndëshkime administrative*, e cila është amendamentuar gjatë vitit 2017.

Divizioni i rishqyrtimit ka kontribuar në identifikimin e indikatorëve të rrezikut si dhe ka raportuar vetëvlerësimin e rrezikut në kuadër të menaxhimit të rrezikut në BQK, ka identifikuar dokumentet të cilat do duhej të përfshihen në *listën e asetëve vizuele të BQK-së*, për krijimin e manualit të simboleve të BQK-së për asetet vizuele. Divizioni i rishqyrtimit ka kryer edhe punë të tjera me kërkesë të menaxhmentit të lartë të BQK-së.

## 6. Zhvillimet e Brendshme

### 6.1. Auditimi i Brendshëm

Auditori i Brendshëm (tutje AB), në praktikat institucionale është organ i pavarur brenda institucionit, që konsiderohet një nga hallkat kyçe të kontrolleve të brendshme të vendosura nga institucioni. Auditimi i brendshëm bashkë me auditimin e jashtëm përmbyll zingjirin e llogaridhënies brenda çdo institucioni.

Në bazë të Ligjit të BQK-së, Shefi i Auditimit të Brendshëm është funksioni që përfaqëson auditimin e brendshëm në BQK. Ligji dhe aktet e tjera rregullative të BQK-së, AB-së i ofrojnë autoritet të plotë dhe qasje të pakufizuar për të zhvilluar angazhime të auditimit. AB, ofron rekomandime për të përmirësuar proceset, operacionet apo kontrollet e brendshme të zhvilluara në BQK. Këto rekomandime adresohen në të mirë të menaxhimit sa më ekonomik, efikas dhe efektiv të buxhetit dhe pasurisë si dhe shtimit të vlerës së institucionit. Kjo kornizë e bën përgjegjës AB-në për të përmbushur detyrat profesionalisht dhe për të raportuar në lidhje me angazhimet e kryera dhe performancën e treguar.

AB, gjatë vitit 2017 ka ofruar shërbime të auditimit bazuar në Planin Vjetor të punës së auditimit, të rishikuar nga Komiteti i Auditimit dhe miratuar nga Bordi i BQK-së. Plani është përpiluar bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të rreziqeve për të përkrahur të ashtuquajturën qasje të bazuar në rrezik, model i adaptuar nga praktikat e Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankave të tjera Ndërkombëtare me sistem të avancuar të auditimit. Auditimet e kryera ishin të natyrës: Financiare, të Pajtuëshmërisë, Operacionale dhe të Teknologjisë Informative.

Funksioni i AB-së gjatë vitit 2017, përveç angazhimeve të auditimeve të planifikuara sipas planit, karakterizohet edhe me disa aktivitete të tjera që ndikojnë në rritjen e performancës së shërbimeve dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e këtij funksioni.

Zyra e Shefit të AB-së, për herë të parë këtë vit shënoi muajin e ndërgjegjësimit të auditimit, ngjarje kjo e zhvilluar tradicionalisht në shumë vende të botës. Në vazhden e promovimit të profesionit të auditimit, organizoi tryezën me titull "Roli dhe rëndësia e auditimit të brendshëm". Ky muaj është shpallur nga Instituti Global i AB-së (SHBA) si ngjarje e njohur ndërkombëtarisht në vendet me auditim të avancuar. Ngjarja, në nivel global synon të avancojë njohjen e rolit thelbësor që luan AB në qeverisje organizative, kontroll të brendshëm dhe menaxhim efektiv të rrezikut. Kjo do të ndihmojë në ngritjen dhe vetëdijësimin e institucioneve karshi rolit dhe rëndësisë së AB-së.

Fushëveprimi i AB-së ka vazhduar të jetë i orientuar në drejtim të përmirësimit dhe avancimit të sistemeve dhe proceseve të cilat e ndihmojnë Menaxhmentin dhe ndikojnë në avancimin e mëtejshëm të qeverisjes korporative.

Në përputhje me Ligjin e BQK-së dhe "Statutin e Auditimit të Brendshëm", Shefi i AB-së, gjatë vitit 2017 ka raportuar në periudha të rregullta tremujore dhe vjetore në Komitet të Auditimit dhe Bord të BQK-së lidhur me të gjeturat e auditorit, rekomandimet, si dhe veprimet e ndërmarra për adresimin e tyre. Raportet janë diskutuar paraprakisht në Komitetin e Auditimit dhe Bordin e BQK-së dhe çështjet për trajtim të më tutjeshëm janë adresuar për Menaxhmentin ekzekutiv. Përmes tyre AB, njëkohësisht ka raportuar në lidhje me nivelin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në periudhat paraprake. Shefi i AB-së, gjithashtu ka njoftuar Bordin e BQK-së dhe menaxhmentin e lartë ekzekutiv për angazhimet e tjera të përditshme të AB-së.

Janë vazhduar aktivitetet me qëllim të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga vlerësimet e jashtme (Banka Botërore; Banka Qendrore Evropiane; FMN dhe USAID-i lidhur me përmirësimin

dhe avancimin e cilësisë së punës së auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat profesionale të auditimit.

AB, ka përgatitur strategjinë e auditimit për periudhën trevjeçare 2017-2019. Mbi bazën e së është përgatitur Plani Vjetor i Punës së AB-së për vitin 2018. Plani i përgatitur nga AB, pas rishikimit dhe diskutimeve me Komitetin e Auditimit, është aprovuar në Bordin e BQK-së. Në bazë të kërkesës nga marrëveshja midis Qeverisë së Kosovës, BQK-së dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, në baza gjashtëmujore janë kryer dy auditime të pavarura të rekonsilimit të llogarive të Qeverisë.

Përveç angazhimeve të planifikuara të karakterit funksional, AB ka zhvilluar edhe aktivitete të tjera mbështetëse të cilat ndihmojnë rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të punës. Me qëllim të ofrimit të informacioneve për vënien në funksion të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, AB ka vazhduar me dhënien e kontributit në këtë drejtim.


Për të avancuar njohuritë profesionale dhe eksperiencën teknike, gjatë vitit 2017 AB ka vazhduar t'i kushtojë rëndësi zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit, përmes pjesëmarrjes në disa ngjarje me karakter ndërkombëtar ashtu edhe kombëtar si vijon: Kursi online i organizuar nga FMN "Analizat e tregut Financiar (FMAx)" që ka rezultuar i kryer me sukses nga dy (2) auditorë të lartë; punëtorja me titull "Forcimi i AB-së dhe roli i Komitetit të Auditimit", i organizuar nga Qendra për Ekselencë Financiare e Lubjanës dhe e mbështetur nga Banka e Sllovenisë. Në këtë ngjarje, me ftesë të organizatorit, Shefi i AB-së ka prezantuar zhvillimet e fundit dhe eksperiencat e funksionit të auditimit të brendshëm në BQK. Gjithashtu, stafi i AB-së ka ndjekur seminare në lidhje me praktikatat e auditimit të brendshëm në Banka Qendrore, kontrollit të brendshëm, si dhe atyre për menaxhim të rrezikut.

## 6.2. Burimet njerëzore

Në fund të vitit 2017 numri i të punësuarve në BQK ka qenë 216 punonjës. Moshja mesatare e të punësuarëve ka qenë 40.93 vite. Nga gjithsej numri i të punësuarve, 110 punonjës ose 50.93 % janë femra dhe 106 punonjës ose 49.07 % janë meshkuj.

Në strukturën e përgjithshme të edukimit tre punonjës ose 1.4 % janë me PhD, 67 punonjës ose 31.0 % me edukim pasuniversitar, 114 punonjës ose 52.8 % me edukim universitar, 29 punonjës ose 13.4 % me edukim të mesëm dhe 3 punonjës ose 1.4 % me edukim bazik (figura 107).

Figura 107. Struktura sipas edukimit



Burimi: BQK (2017)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vlerëson personelin si një ndër resurset me rëndësi të veçantë dhe vazhdimisht angazhohet për mbështetjen e tyre që t'u sigurojë njohuri të duhura, aftësi dhe ekspertizë adekuate për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive sipas standardeve më të larta për arritjen e potencialit të plotë të tyre përmes kurseve, seminareve, edukimeve, etj.

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarëve, 96 punonjës ose 44.65 % e tyre kanë marrë pjesë në trajnime profesionale, prej tyre 17 trajnime në vend dhe 79 trajnime jashtë vendit, kryesisht të organizuara nga Banka Qendrore Europiane, FMN, JVI, Deutsche Bundesbank, Banka e Holandës, Banka e Polonisë, Shoqata e Bankave të Kosovës dhe "Center of Excellence in Finance – CEF".

Gjithashtu, BQK-ja vazhdimisht ju ofron mundësi studentëve nga universitetet/kolegjet si nga vendi ashtu edhe jashtë vendit, mbajtjen e praktikës për studentë në mënyrë që t'u sigurojë atyre mundësi unike për të fituar përvojë praktike në fusha të ndryshme të funksioneve dhe operacioneve të BQK-së. Në vitin 2017, gjithsej 15 studentë mbaruar programin e praktikës në BQK. Prej tyre 7 punonjës të organizuar/trajnuar nga përfaqësuesit e departamentit të statistikave gjatë muajit korrik dhe gusht kanë kryer detyrën e anketuesve në terren në mbledhjen e informatave në tri pika kufitare të Kosovës lidhur me nivelin dhe strukturën e shpenzimeve të emigrantëve gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë.

### 6.3. Aktiviteti ligjor i BQK-së

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2017 ka vazhduar me implementimin e infrastrukturës ligjore ekzistuese të sektorit financiar në Kosovë, si dhe ka punuar drejt avancimit të së njëjtës, duke synuar gjithmonë që të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe e harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Gjatë këtij viti, ka pasur dy ndryshime të ligjeve në fuqi. Në janar të vitit 2017, është ndryshuar dhe plotësuar Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168. Qëllimi i ndryshimit të këtij Ligji ka qenë rritja e mëtejme e sigurisë lidhur me administrimin dhe menaxhimin e mjeteve pensionale. Në mars të vitit 2017 është ndryshuar dhe plotësuar Ligji nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me të cilin ndryshim është përmirësuar më tej korniza qeverisëse dhe kontrolluese e BQK-së në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për bankat qendrore.

Ndërsa, sa i përket përmbushjes së objektivave dhe detyrave të Bankës Qendrore, janë miratuar një numër i akteve nënligjore nga organet vendimmarrëse të cilat paraprakisht, para miratimit të tyre, janë shqyrtuar dhe konfirmuar nga aspekti ligjor. Më konkretisht, kuadri rregullativ i veprimtarisë së institucioneve financiare është avancuar me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e ri dhe atë ekzistues.

Gjithashtu, aktiviteti ligjor ka vazhduar edhe me lidhje të marrëveshjeve bashkëpunimi me institucione vendore dhe të huaja, me qëllim të kryerjes sa më efikase të detyrave përkitazi me çështjet brenda fushave të kompetencave reciproke të institucioneve përkatëse.

Në vijueshmëri të aktivitetit ligjor, në pajtim me autorizimet ligjore dhe objektivat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të vazhdojë me përcjelljen e zhvillimeve të reja ligjore dhe teknologjike dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përmbushur të gjitha objektivat dhe detyrat e përcaktuara me ligj, me qëllim që të sigurojë një sistem financiar stabil, të sigurt dhe të qëndrueshëm.

### 6.4. Teknologjia Informative

Gjatë vitit 2017, BQK-ja ka avancuar sistemet e Teknologjisë Informative, duke i përditësuar dhe duke ngritur sigurinë me implementimin e kontrolleve sipas standardeve ndërkombëtare. Janë përkrahur dhe ofruar shërbime sipas kërkesave të ardhura nga biznesi.

Ndër projektet kryesore të implementuara janë: finalizimi i sistemit për autentikim të dyfishtë, ridizajnimi i rrjetave kompjuterike, duke përshtatur kërkesat e sigurisë sipas karakteristikave të sistemeve të veçanta dhe qasja e sigurt nga distanca për stafin e BQK-së. Po ashtu, gjatë vitit 2017 është realizuar edhe testimi i plotë i Qendrës dhe Planit të Vazhdimësisë së Biznesit. Ekipi për menaxhimin e planit të vazhdimësisë së Biznesit ka simuluar situatën kur ndërtesa kryesore e

BQK-së nuk është e qasshme dhe ka vazhduar punën në Qendrën për Vazhdimësi të Biznesit në Prizren.

### **6.5. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut**

Menaxhimi i rrezikut operacional dhe evitimi i humbjeve potenciale nga aktivitetet operative kanë gëzuar vëmendje të rëndësishme gjatë vitit 2017. Në këtë fushë është vazhduar me rritjen e nivelit të integritetit të menaxhimit të rrezikut të gjithë bartësit e proceseve për kornizën raportuese dhe parametrat e njohjes së rrezikut operacional.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar përshtatshmërisë së zhvillimit të indikatorëve kyçë të rrezikut dhe raportimit të rreziqeve emergjente. Vlerësimi i përshtatshmërisë së menaxhimit të rrezikut është peshuar kundrejt objektivave strategjike të njërive punuese të përcaktuara në planin strategjik të BQK-së dhe përgjegjësisve operative të secilës njësi punuese.

Aktivitetet domethënëse në këtë periudhë raportuese janë avancimi i kuadrit rregullues duke shtuar linjat e raportimi, vlerësimi dhe monitorimi i rreziqeve të raportuara nga format e vetëvlerësimit të rrezikut operacional, vlerësimi i rreziqeve operationale për njësi organizative dhe raportimi vlerësues tremujore i menaxhimit të rrezikut.

Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut ka koordinuar aktivitetet e kontrollit dhe vlerësimit me linjat tjera të mbrojtjes, me theks të veçantë bashkërendimi me Auditimit e Brendshëm, me të cilin ka bashkëpunuar ngushtë duke ofruar informata nga vlerësimet e rreziqeve operationale për njësi organizative.

BQK-ja është i orientuar drejt sendërtimit të një kulture të fortë të Menaxhimit të Rrezikut, e ndërtuar mbi praktika etike dhe me integritet të kryerjes së punëve. Prioritet për vitin 2018 do të jetë kompletimi i kuadrit rregullues, promovimi i instrumenteve matëse të rrezikut dhe vlerësimi i rrezikut operacional për njësit organizative me natyrë operationale të punës në përputhje me planin vjetor 2018.

## 7. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

### 7.1. Marrëdhëniet ndërkombëtare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në pajtim me përgjegjësitë e saj ka vazhduar me avancimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin funksional me institucionet financiare ndërkombëtare siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), USAID, Banka Botërore (BB), Banka Qendrore Evropiane (ECB), Autoriteti Bankar Evropian (EBA) dhe institucionet tjera. Ky bashkëpunim është shfaqur edhe në takime dhe në tryeza me institucionet financiare qendrore evropiane dhe me bankat qendrore të vendeve të ndryshme.

Në frymën e këtij bashkëpunimi, në vitin 2017, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Bankën Kombëtare të Austrisë (OeNB) dhe Bankën Investive Evropiane (EIB), ka organizuar konferencën ndërkombëtare me temë “Qasja në Financa, Kreditimi Bankar dhe Sektorët Bankarë në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore”, ku morën pjesë zyrtarë të lartë nga shumë institucioneve financiare ndërkombëtare, banka qendrore, si dhe banka komerciale.

Në vitin 2017, BQK-ja po ashtu ishte aktive në arritjen e marrëveshjeve të reja ndërkombëtare, ku vlen të përmendet arritja e marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e menaxhimit të mjeteve dhe investimeve, në mes të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankës Federale të New York-ut (Federal Reserve Bank of New York).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës po ashtu mori pjesë në shumë takime, konferenca dhe tryeza e forume rajonale dhe më gjerë. Kështu, BQK-ja ka marrë pjesë në takimet e rregullta pranverore dhe vjetore të FMN-së dhe BB-së, të cilat janë zhvilluar në Washington D.C. Gjatë këtyre ngjarjeve, delegacioni i BQK-së zhvilloi takime me zyrtarë të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, zyrtarë të Departamentit të Thesarit Amerikan, si dhe me përfaqësues të institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2017, BQK-ja ka zgjeruar bashkëpunimin edhe me Bankën Nacionale të Suedisë (Sveriges Riksbank), ku delegacioni i BQK-së i kryesuar nga Kryetari i Bordit dhe bashkëpunëtorët u takuan me Kryesuesen e Këshillit të Përgjithshëm të Riksbank, znj. Susanne Eberstein, Zëvendëskryesuesin e Këshillit të Përgjithshëm z. Michael Lundholm, Guvernatorin z. Stefan Ingves dhe Zëvendësguvernatorin z. Henry Ohlsson. Më këtë rast, përfaqësuesit e Bankës Nacionale të Suedisë i premtuan delegacionit të BQK-së mbështetje për projektin elektronik të pagesave përmes mobilit të quajtur “Swish”, të cilin kjo bankë e ka zhvilluar kohë më parë.

Në ngjarjet me karakter ndërkombëtar të përfaqësimit, menaxhmenti i lartë i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka marrë pjesë në:

- Forumin e Dubrovnikut të organizuar nga Banka Kombëtare e Kroacisë dhe FMN-ja. Në këtë Forum të nivelit të lartë, përveç guvernatorëve dhe ministrave të financave të shteteve të Evropës Qendrore, Lindore e Juglindore, mori pjesë edhe Drejtoresha Menaxhuese e FMN-së, Christine Lagarde më të cilën Guvernatori i BQK-së ka zhvilluar takim.
- Takimi i Guvernatorëve në Umag, nën organizimin e Bankës Kombëtare të Kroacisë dhe revistës kroate "Lider".
- Samitin e Guvernatorëve të Bankave Qendrore, Ministrave të Financave dhe Drejtorëve të Administratave Tatimore të Regjionit, i cili i zhvilloi punimet në Beçiq të Malit të Zi me temën “Stabiliteti Regjional Financiar në Ambientin e ri Global”.



- Konferencën vjetore të Bankës së Shqipërisë dhe Qendrës së Studimeve të Evropës Juglindore të Universitetit të Oksfordit.
- Takimin vjetor të EFSE (European Fund for Southeast Europe) në Split të Kroacisë, i titulluar “Krijimi i mundësive të përfshirjes financiare, nismat e reja (start-up) dhe ndërmarrësia”,
- Organizimin me rastin e Publikimit të Bankës Botërore në Vjenë, Austri, të raportit “Rreziqet dhe Kthimet (efektet): menaxhimi i kompromiseve financiare për rritje gjithëpërfshirëse në Evropë dhe Azi Qendrore”.
- Takimet e Konstituencës së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore në Lubjanë të Sllovenisë.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare, BQK-ja përmes përfaqësimit nga Guvernatori ka zhvilluar vizitë zyrtare në institucionet financiare në Gjermani duke marrë premtime për vazhdimin e bashkëpunimit, si dhe mundësinë e zgjerimit të fushave të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Gjatë vitit 2017, në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës kanë qëndruar për vizitë delegacione dhe zyrtarë të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare, ambasadorë të akredituar në vend dhe zyrtarë tjerë të lartë të institucioneve respektive.

Gjatë vitit 2017 në BQK nuk kanë munguar as vizitat dhe takimet me zyrtarët e lartë të FMN-së dhe në këtë nivel të bashkëpunimit Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është takuar me delegacionin nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, të kryesuar nga z. Jacques Miniane, Shef i Misionit për Kosovë në largim dhe znj. Stephanie Eble, Shefe e re e Misionit për Kosovën. Në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës janë pritur në vizitë edhe zyrtarë të Bankës Federale të New York-ut (Federal Reserve Bank of New York) me të cilët përveç tjerash është diskutuar për bashkëpunim në fushën e menaxhimit të mjeteve dhe investimeve.

Vizitë në BQK gjithashtu është realizuar nga z. Fadil Bajrami Zëvendësguvernatori në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë i cili është pritur nga menaxhmenti i BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është përfaqësuar nga Zëvendësguvernatori i BQK-së në ceremoninë vjetore të certifikimit të aktuarëve të rinj në Tiranë, ku përveç fjalës së rastit zëvendësguvernatori ka marrë pjesë edhe në ndarjen e diplomave për aktuarët e rinj.

Përveç organizimit të konferencës tradicionale të fundvitit me media nga Guvernatori, menaxhmenti i BQK-së ka qenë prezent edhe në mediat vendore dhe ndërkombëtare dhe kanë pasqyruar objektivat dhe aktivitetet e BQK-së me theks të veçantë të zhvillimeve të sistemit financiar në vend.

## 7.2. Edukimi Financiar

Në pajtueshmëri me objektivin primar të BQK-së për mbajtjen dhe ruajtjen e stabiliteti financiar, Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë, ka vazhduar të avancojë ngritjen e njohurive financiare përmes avancimit të fushës së edukimit financiar.

Bordi Ekzekutiv i BQK-së në prill 2017, ka miratuar programin e Edukimit Financiar i cili vendos bazën dhe kornizën e aktiviteteve dhe zhvillimeve në këtë fushë.

DMJ-ja ka vazhduar të përgatitë dhe zhvillojë ngjarje dhe aktivitete edukative duke targetuar nivele dhe grupe të ndryshme të publikut. Në kuadër të këtyre aktiviteteve për të katërtin vit radhazi është organizuar Java Ndërkombëtare e Parasë, aktivitet i cili organizohet nga bankat dhe institucionet financiare në mbarë botën. Në kuadër të kësaj jave janë realizuar shumë aktivitete si:

- Ligjërata në universitete private dhe shtetërore nga menaxhmenti i lartë i BQK-së.
- Vizita në shkolla fillore dhe organizimi i aktiviteteve edukativo-financiare në këto vizita.
- Në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave dhe Muzeun e Kosovës, DMJ-ja ka organizuar aktivitete edukative në Muzeun e Kosovës gjatë tërë javës me nxënës të shkollave të ndryshme, përfshirë edhe nxënës me nevoja të veçanta dhe nxënës të minoriteteve.

Me qëllim të avancimit dhe ngritjes së Edukimit Financiar në Kosovë, DMJ-ja (në bashkëpunim me EFSE dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës), ka organizuar Takimin e Tretë të Grupit Rajonal të Punës për edukim financiar të rinjve dhe përfshirjen financiare për Evropën Juglindore, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga 24 institucione vendore e ndërkombëtare. Në kuadër të kësaj Konference Ndërkombëtare, janë prezantuar të arriturat dhe zhvillimet në fushën e edukimit financiar nga 10 shtete të rajonit dhe më gjerë. Në mënyrë që të ngritën informatat dhe njohuritë rreth kësaj fushe, BQK-ja ka ftuar edhe pjesëmarrës nga institucionet kryesore financiare në vend. BQK-ja gjatë kësaj konference ka lansuar Qendrën e Trajnimit dhe Edukimit Financiar në Prizren, e cila është vizituar nga pjesëmarrësit e konferencës. Kjo Qendër do të ketë ndikim të rëndësishëm në organizimin e aktiviteteve edukative me institucione vendore por edhe ndërkombëtare.

Në kuadër të edukimit financiar DMJ-ja ka organizuar Ditën Botërore të Kursimeve, me realizimin e një ekspozite të parasë në BQK dhe ka ftuar nxënës të shkollave fillore për të vizituar këtë ekspozitë, ku janë realizuar edhe lojëra e aktivitete edukative, në përputhshmëri me moshën e nxënësve pjesëmarrës në këto aktivitete.

Gjatë vitit 2017, DMJ-ja ka pritur vizita nga studentë e nxënës të institucioneve arsimore, universitete, shkolla të mesme e fillore të cilët janë informuar për së afërmi me rolin dhe funksionet e BQK-së.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe DMJ-ja ka përgatitur broshura dhe material edukativ, të cilat u janë dhuruar nxënësve apo studentëve në ngjarje e aktivitete të ndryshme të organizuara nga BQK-ja.

### 7.3. Asistenca teknike

BQK-ja ka vazhduar të përfitojë nga asistenca teknike gjatë vitit 2017, e ofruar nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët e ndryshëm.

Kryesisht mbështetja është ofruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Thesari Amerikan, USAID, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, GIZ dhe Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE).

Këto institucione kanë vazhduar përkrahjen në implementimin e projekteve, me theks të veçantë në ngritjen e kapaciteteve të BQK-së, avancimin dhe hartimin e kornizës rregullative në pajtueshmëri me direktivat evropiane. Thesari Amerikan ka vazhduar mbështetjen e BQK-së me ekspertizë në politikat zhvillimore të sektorit financiar, fushën e makroprudencës dhe qeverisjen korporative.

Mbështetje është ofruar në fushën e makroprudencës dhe statistikave me këtë rast institucioni i BQK-së është ndihmuar në implementimin e Kornizës së Makroprudencës dhe avancimit të statistikave nga ekspertët e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Gjithashtu edhe në sferën e mbikëqyrjes së kompanive të sigurimeve është dhënë mbështetje nga Misioni i Asistencës Teknike të FMN-së. Gjatë vitit 2017 është siguruar asistenca nga BERZH-i për hartimin e kornizës rregullative të faktoringut, si dhe për hartimin e kornizës rregullative për likuidimin e bankave për të siguruar pajtueshmëri me direktivat e BE-së.

BQK-ja gjatë vitit 2017, më konkretisht Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve gjatë muajit shtator ishte nikoqir i një misioni të Asistencës teknike të FMN-së që kishte për qëllim përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2016. Ky mision i njohur si “Asistencë Teknike – Misioni për



Rishikim Diagnostik të Mbikëqyrjes dhe Kuadrit Rregullues të Sektorit të Sigurimeve”, ka qëndruar në BQK gjatë periudhës 19-26 shtator 2017. Një mision i Departamentit të Statistikave të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), ka vizituar Prishtinën gjatë periudhës 6-13 prill 2017 për të ndihmuar autoritetet në implementimin e Sistemit të Avancuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme (e-GDDS), i cili u miratua nga Bordi Ekzekutiv në maj të vitit 2015. Misioni mbështeti përmirësimin e faqes aktuale kombëtare të të dhënave (NSDP). Prej muajit maj të vitit 2017 versioni i ri vazhdon të postohet në faqen e internetit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, duke prezantuar të dhënat kryesore makroekonomike përmes standardit të kërkuar nga FMN, SDMX. Faqja e NSDP-së përmban lidhje me statistikat e publikuara nga prodhuesit zyrtarë të të dhënave, përkatësisht Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Financave e Kosovës.

Ndërsa Divizioni për Parandalimin e Pastrimit të Parave ka përfituar në dy projekte në kuadër të fondeve të instrumentit të paraanëtarësimit IPA, ku është pjesë së bashku edhe me institucione tjera të Kosovës. Këto projekte janë 1) “Projekti Kundër Krimit Ekonomik”, i financuar nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkimit Evropian, 2) “Projekti për Mbështetjen e mëtutjeshme të institucioneve të Kosovës në luftë kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm”. Përfitimi nga këto projekte ka qenë kryesisht në trajnim dhe vetëdijesim, si dhe në hartimin e legjislacionit të fushës përkatëse.

Gjatë vitit të kaluar Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë është mbështetur nga EFSE për organizimin e aktiviteteve dhe zhvillimin e programit të edukimit financiar. Bazuar në këto përkrahje BQK-ja me qëllim të avancimit të funksionit të edukimit financiar me përkrahjen e Fondit Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeastern Europe – EFSE), dhe përkrahjen e donatorëve tjerë, në vazhdimësi do të angazhohet në ngritjen e kapaciteteve tutje për zhvillimin e kësaj komponente të rëndësishme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në vazhdimësi do të mbetet e përkushtuar dhe mirënjohëse për tërë përkrahjen, e cila i ofrohet nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët e ndryshëm.

#### **7.4. Integrimet Evropiane**

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë gjithë vitit ka raportuar në institucionet me të cilat bashkëpunon në sferën e raportimit që ndërlidhën me proceset e fushës së integrameve. Rol të rëndësishëm në këtë fushë ka bashkëpunimi me Ministrinë e Integrameve Evropiane, e cila është bartëse e procesit të integrimin evropian. Gjithashtu nuk ka munguar bashkëpunimi as me ministrinë tjera siç janë, Ministria e Financave dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Zyrën e BE-së në Prishtinë.

Gjatë vitit 2017 është raportuar për inputin e parë të institucioneve të Republikës së Kosovës, si një formë e re e raportimit (ish-raporti i progresit) dhe vlen të theksohet se këtë vit për herë të parë është raportuar nëpërmjet pyetësorit për vendin duke përdorur këtë qasje universale të raportimit ngjashëm sikurse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo formë e raportimit është realizuar dy herë gjatë vitit 2017.

BQK-ja ka marrë pjesë në procesin e Screening-ut të legjislacionit me qëllim të finalizimit të tabelës së Rishqyrtimit të Legjislacionit në projektin e organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Kryeministrit. Po ashtu është raportuar edhe në nënkomitetet e Komisionit Evropian, ku BQK-ja merr pjesë aktive në dy nënkomitete: nënkomiteti për ekonomi, çështje financiare dhe statistika, si dhe nënkomiteti për tregun e brendshëm, konkurrencën dhe mbrojtjen e konsumatorit (të dy këto takime raportuese janë zhvilluar në

Bruksel). Në vazhdimësi BQK-ja ka përmbushur detyrat e saj që si rrjedhojë kanë sjellë shkallë të lartë të realizimit të PKZMSA-së.

Në fund të vitit 2017 është bërë edhe rishikimi i PKZMSA-së për vitin 2018, ku janë planifikuar masat afatshkurtra legjislative dhe zbatuese që do të realizohen përgjatë vitit 2018.

Ndër detyrat dhe obligimet bazë që rrjedhin nga MSA për BQK-në, janë si në vijim:

Titulli V Themelimi, ofrimi i shërbimeve dhe kapitali;

Kapitulli I - Themelimi, Kapitulli II - Ofrimi i shërbimeve, Kapitulli IV - Pagesat rrjedhëse dhe lëvizja e kapitalit, Kapitulli i V - Dispozitat e përgjithshme;

Titulli VI - Përafrimi i ligjit të Kosovës me Acquis të BE-së, zbatimi i ligjit dhe rregullat e konkurrencës (neni 81 Mbrojtja e konsumatorit);

Titulli VII - Liria, siguria dhe drejtësia, neni 89 Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit;

Titulli VIII - Politikat e bashkëpunimit;

Titulli IX - Bashkëpunimi financiar (Shtojca VI neni 50 Shërbimet financiare);

Shtojca IV neni 50.

## 8. Pasqyrat financiare të BQK-së





## **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

### **Pasqyrat Financiare**

**më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	3-4
Pasqyra e gjendjes financiare	5
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	6
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	7
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	8
Shënime për pasqyrat financiare	9 - 45

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për Menaxhmentin e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave tjera gjithëpërfshirës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin në përfundim, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2017, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin në përfundim në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### Bazat për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit tonë për përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Etikës të Kontabilistëve për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

#### Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe e personave të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për një kontroll të tillë që konsiderohet e nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar me tutje, duke shpalosur, nëse e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e biznesit dhe përdorë parimin e vazhdimësisë së biznesit, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuideojë bankën ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimi jonë është marrja e sigurisë së arsyeshme që pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve dhe lëshimit të një raporti të auditorëve i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA, do të detektojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të lindin nga mashtrimet ose gabimet dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm i cili është i rëndësishëm për auditimin në mënyrë që të dizajnohen procedura të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit lidhur me efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosje të ngjashme të bëra nga menaxhmenti.
- Bazuar në evidencën e siguruar, vendosim mbi përshtatshmërinë e shfrytëzimit të parimit të vazhdimësisë së biznesit dhe nëse një pasiguri materiale egziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të vënë në dyshim aftësinë e Bankës për të vazhduar me tutje. Nëse ne konkludojmë se një pasiguri materiale egziston, jemi të detyruar të tërheqim vëmendje në raportin tonë lidhur me këtë shpalosje në pasqyrat financiare, ose nëse shpalosjet e tilla nuk janë të duhurat, të modifikohet opinionin jonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të mbledhur deri me datën e raportit financiar. Sidoqoftë, kushtet ose ngjarjet në të ardhmen, mund të shkaktojnë që Banka të ndërprejë vijueshmërinë e biznesit.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, mes tjerash, fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollat e brendshme të cilat i identifikojmë gjatë auditimit.

*Deloitte Kosova sh.p.k.*

Deloitte Kosova sh.p.k.  
Rr. Lidhja e Pejës, Nr. 177  
Prishtina, Republika e Kosovës  
Nr. i regjistrimit: 80452632  
30 prill 2018



# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës


## Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Shënim</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
<b>Aktivët</b>			
Paraja e gatshme	7	188,547	154,800
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	422,009	207,742
Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione Qeveritare)	9	592,712	572,375
Depozita me bankat e huaja	10	68,178	195,049
Mjetet e ndërlidhura me FMN	11	325,764	275,561
Prona dhe pajisjet	12	5,329	4,484
Aktive të paprekshme	13	2,065	2,271
Aktive tjera	14	9,101	1,284
<b>Gjithsej aktivët</b>		<b>1,613,705</b>	<b>1,413,566</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj bankave komerciale në vend	15	331,826	296,399
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në	16	318,616	283,009
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	811,341	718,435
Detyrime ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	95,807	58,867
Detyrime nga huamarrja/et	19	2,266	2,133
Detyrime të tjera	20	2,047	2,040
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>1,561,903</b>	<b>1,360,883</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali i autorizuar	21	30,000	30,000
Fondi i rezervave	21a	22,683	21,023
Rezerva nga rivlerësimi		-	-
Neto rezultati (fitimet e mbajtura)		(881)	1,660
<b>Gjithsej kapitali dhe rezervat</b>		<b>51,802</b>	<b>52,683</b>
<b>Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat</b>		<b>1,613,705</b>	<b>1,413,566</b>

Këto pasqyra financiare të shpalosura në faqet 5 deri në 45 janë miratuar nga menaxhmenti i BQK-së më 30.Prill.2018 dhe është nënshkruar në emër të tij nga:

  
Fehmi Mehmeti  
Guvernator

  
Faton Ahmetaj  
Drejtore për Planifikim dhe  
raportim financiar

Shënimet nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Shënim</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
<b>Të ardhurat nga interesi</b>			
Të ardhurat nga interesi		2,002	1,640
Shpenzimet nga interesi		(1,036)	(362)
<b>Të ardhurat neto nga interesi</b>	22	<b>966</b>	<b>1,278</b>
<b>Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat</b>			
Të ardhurat nga tarifat dhe ndalesat		2,101	1,962
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		(370)	(294)
<b>Të ardhurat neto nga tarifat dhe ndalesat</b>	23	<b>1,731</b>	<b>1,668</b>
<b>Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ dhe të ardhurat tjera operative</b>			
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ	24	4,178	4,046
Të ardhurat nga grantet	25	106	80
Të ardhurat tjera operative	26	6	517
Fitimi / (humbja) nga kursi i këmbimit	29	(1,225) <sup>1</sup>	(22)
<b>Të hyrat operative</b>		<b>5,762</b>	<b>7,567</b>
<b>Shpenzimet administrative (operative)</b>			
Shpenzimet personelit	27	(4,453)	(3,991)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(978)	(713)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	28	(1,212)	(1,203)
<b>Shpenzimet administrative (operative)</b>		<b>(6,643)</b>	<b>(5,907)</b>
		<b>(881)<sup>1</sup></b>	<b>1,660</b>
<b>Fitimi / (Humbja) vjetore</b>			
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(881)</b>	<b>1,660</b>

Shënimet nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

<sup>1</sup> **Fitimi / (humbja) vjetore për vitin 2017**, nëse e përjashtojmë efektin e humbjes nga ndryshimi në kursin e këmbimit valutor (përkatësisht shumën 1,225 mijë euro) është **344 mijë euro**. Kjo njëherit paraqet edhe fitimin operativ faktik për vitin 2017.

Humbja nga ndryshimi i "kursit të këmbimit" është pozicioni i përkohshëm jo-operativ i rrjedhë nga zërat në valutë jo euro (USD dhe DVT-SDR), të cilët me datën e raportimit duhet të raportohen në shumën euro ekuivalente të tyre, sipas kursit valutor në datën e raportimit. Me ndryshimin e kursit të këmbimit valutor rrjedhin edhe diferenca (qoftë fitim ose humbje), që si të tilla vetëm barazojnë zërat bilancor-vlerat ekuivalente, por që nuk janë realizime faktike (në rastin tonë humbje/shpenzimi jo-faktikë për vitin 2017 është shuma prej 1,225 mijë euro). Një shpalosje me analitike do të pasqyrohet të **shënim 29** në faqe 43.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura (Neto Rezultatati/et)	Gjithsej
<i>Në mijë Euro</i>					
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>30,000</b>	<b>21,023</b>	-	<b>1,660</b>	<b>52,683</b>
Transferimi në fondin rezervë	-	1,660	-	(1,660)	-
<b>Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj</b>	-	<b>1,660</b>	-	<b>(1,660)</b>	-
Fitimi për vitin	-	-	-	(881)	(881)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
<b>Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	<b>(881)</b>	<b>(881)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>30,000</b>	<b>22,683</b>	-	<b>(881)</b>	<b>51,802</b>
<hr/>					
<b>Gjendja më 1 janar 2016</b>	<b>30,000</b>	<b>20,171</b>	<b>164</b>	<b>688</b>	<b>51,023</b>
Transferimi në fondin rezervë	-	852	(164)	(688)	-
<b>Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj</b>	-	<b>852</b>	<b>(164)</b>	<b>(688)</b>	-
Fitimi për vitin	-	-	-	1,660	1,660
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
<b>Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	<b>1,660</b>	<b>1,660</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>30,000</b>	<b>21,023</b>	-	<b>1,660</b>	<b>52,683</b>

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Pasqyra e rrjedhjes së parashë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

<i>Në mijë Euro</i>	<b>Shënim</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
<b>Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale</b>			
Fitimi vjetor		(881)	1,660
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimin	12	615	464
Amortizimin	13	363	249
Të ardhurat nga grantet	25	(106)	(80)
Fitimi nga shitja e pajisjeve		-	-
Të ardhurat nga interesi	22	(2,002)	(1,640)
Shpenzimet nga interesi	22	1,036	362
		<b>(975)</b>	<b>1,015</b>
Ndryshime në bono thesari		(25,441)	(438,693)
Ndryshime në depozita me bankat e huaja		135,000	610,027
Ndryshime në mjetet e ndërlidhura me FMN		(49,880)	(7,255)
Ndryshime në aktive të tjera		(7,817)	(387)
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave komerciale në vend		35,427	(20,007)
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të të ndërlidhura me FMN-në		35,288	9,084
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		92,905	(17,309)
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale		36,941	(23,782)
Ndryshime në huamarrja/et		133	1,453
Ndryshime në detyrimet e tjera vendore		109	171
		<b>251,690</b>	<b>114,317</b>
Interesa të marra		(2,344)	1,787
Interesa të paguara		(717)	(331)
<b>Paraja neto e gjeneruar nga/(përdorur në) aktivitetet operacionale</b>		<b>248,629</b>	<b>115,773</b>
<b>Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese</b>			
Të hyrat nga shitja e pajisjeve		-	-
Blerja e pajisjeve	12	(1,461)	(2,576)
Blerja e aktiveve të paprekshme	13	(157)	(968)
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>		<b>(1,618)</b>	<b>(3,544)</b>
<b>Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese</b>			
Të hyrat nga grantet		5	149
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese</b>		<b>5</b>	<b>149</b>
<b>Rritja/(zbritja) neto në para dhe ekuivalentet e saj</b>		<b>247,016</b>	<b>112,378</b>
Efkti i normë së këmbimit		-	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		<b>371,711</b>	<b>259,333</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor</b>	<b>30</b>	<b>619,728</b>	<b>371,711</b>

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 1. Subjekti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK" ose "Banka"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Banka vepron në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për "Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" të cilit tash e tutje i referohemi si ("Ligji për BQK-në"). Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë dhe të mbajë një sistem të qëndrueshëm financiar, duke përfshirë një sistem të sigurt, të shëndetshëm dhe efikas të pagesave.
- të kontribuojë në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të brendshëm të çmimeve.
- të mbështes politikatat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë.

Siç është përshkruar në ligj, BQK duhet të veprojë në përputhje me parimet e një tregu të hapur me një konkurrencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efikase të resurseve.

BQK vepron nga zyrat e saj që gjenden në Prishtinë. Adresa e regjistruar e zyrës së BQK-së është si më poshtë:

Rr. Garibaldi nr. 33

Prishtinë, Kosovë.

### Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori

Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Sipas nenit 34, paragrafit 2, si dhe dispozitës së përkohshme të nenit 79, paragraf 2, të Ligjit për BQK-në, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga Guvernatori, dhe katër<sup>2</sup> anëtar jo-ekzekutiv dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 dhjetor 2017, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

- Bedri Peci – Kryetar i Bordit (jo ekzekutivë)
- Fehmi Mehmeti – u.d.Guvernator
- Behxhet Brajshori – Anëtar (jo ekzekutivë)
- Nuhi Ahmeti – Anëtar (jo ekzekutivë)

Bordi Ekzekutiv me 31 dhjetor 2017 përbëhet nga Guvernatori, i cili është Kryesues dhe dy Zëvendësguvernatorët dhe është përgjegjës për implementimin e politikave të BQK-së dhe të operacioneve të saj.

### 2. Baza e përgatitjes

#### a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar nga SNRF-ja për secilin lloj të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë shpalosur më në detaje në politikatat kontabël në shënimin 3 më poshtë.

---

<sup>2</sup> Një anëtar jo ekzekutiv është pozitë e lirë për t'u plotësuar.

# Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

## Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

---

### 2. Baza e përgatitjes (në vazhdim)

#### c) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro ("EUR"), e cila është valuta funksionale e BQK-së, përveq nëse është specifikuar ndryshe në ndonjë shënim analitik. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është rrumbullakësuar në mijëshen më të afërt.

#### d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informatat në lidhje me fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe vendimeve të rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të konsiderueshëm në shumat e pranuar në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë në shënimin 5.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

### 3. Politikat e rëndësishme kontabël

#### a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj vlerësohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së transaksioneve. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga valutat e huaja për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë rivlerësohen në monedhë funksionale në kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar ajo vlerë e drejtë. Diferencat nga valutat e huaja që rrjedhin nga rivlerësimi njihen si fitim ose humbje.

#### b) Interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen si fitim apo humbje bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që zbrit pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma e interesit efektiv përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitetit ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumat e paguara apo kostot e transaksioneve të pranuar dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejt për blerjen, emetimin apo largimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje apo fitim përfshijnë interesat nga aktivitetet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

# **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

## **Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)*

---
